

# MERITOKRACIA NË KARRIERAT GJYQËSORE

## MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

---

Ngritja në detyrë në pozicionin e kryetarit  
të Gjykatës dhe në Gjykatat e Apelit të juridiksionit  
të përgjithshëm dhe administrativ

### Manual 1

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by  
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361592

## SHKURTIME

<b>GjK</b>	Gjykata Kushtetuese
<b>GjL</b>	Gjykata e Lartë
<b>GjAA</b>	Gjykata Administrative e Apelit
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>DNJF</b>	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>KL Gj</b>	Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>KLP</b>	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
<b>ILD</b>	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
<b>ShM</b>	Shkolla e Magjistraturës
<b>K.Pr.C.</b>	Kodi i Procedurës Civile
<b>K.Pr.P.</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>OJF</b>	Organizata jofitimprurëse



## Pasqyra e lëndës

SHKURTIME .....	3
HYRJE .....	7
OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QË SYNOHEN TË ARRIHEN .....	9
STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE .....	11
PLANI I TRAJNIMIT .....	13

### MODULI I

INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV .....	15
A) Listimi i kriterëve ligjorë për emërimin e gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative .....	15
a) Përvoja profesionale .....	17
b) Vlerësimi i performancës .....	20
c) Mungesa e masave disiplinore .....	21
ç) Afati i largimit nga KLGj-ja .....	23
d) Vlerësimi i pasurisë dhe i figurës .....	23
i) Kriteri i pasurisë .....	24
ii) Kriteri i figurës .....	25
e) Papajtueshmëritë .....	27
B) Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjorë .....	29
a) Kushtet ligjorë .....	29
b) Metodatat për mbledhjen e të dhënave .....	31
c) Metoda e mbledhjes së të dhënave shtesë .....	34
ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjorë .....	34

### MODULI II

INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV .....	37
A) Procedura e emërimit të gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative .....	37
a) Veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes dhe përjashtimi i tij .....	43
b) Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes .....	43
c) Procedura e verifikimit të pasurisë së gjyqtarit .....	45
ç) Procedura e verifikimit të figurës dhe integritetit të gjyqtarit .....	52
d) Procedura e verifikimit të kushteve të tjera ligjorë të kandidimit .....	57
dh) Vijimi i procedurës .....	58

e)	Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Komisioni .....	59
ë)	Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga KLGj-ja .....	60
f)	Vendimi i verifikimit.....	61
B)	Objekti i monitorimit për zbatimin e procedurave .....	62
a)	Hapat e procedurës.....	62
b)	Metoda e mbledhjes së të dhënave për monitorimin e procedurave .....	63
c)	Metoda e mbledhjes së të dhënave shtesë .....	65
ç)	Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurën ligjore .....	68

### MODULI III

#### INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI VLERËSIMIN DHE RENDITJEN E GJYQTARËVE QË KANDIDOJNË PËR NGRITJE NË DETYRË NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ

TË APELIT ADMINISTRATIV .....	69	
A)	Procedura e vlerësimit dhe renditjes së gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative .....	69
a)	Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit ....	69
b)	Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit.....	70
c)	Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim .....	71
ç)	Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së gjyqtarëve.....	71
d)	Shqyrtimi dhe miratimi nga KLGj-ja i projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim.....	74
dh)	Vendimi për renditjen e gjyqtarëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërimin .....	75
e)	Vendimi për ngritjen në detyrë.....	75
B)	Objektivat e monitorimit në lidhje me kushtet procedurale.....	75
a)	Metoda e mbledhjes së të dhënave për renditjen e kandidatëve .....	75
b)	Metoda për mbledhjen e të dhënave shtesë.....	77
c)	Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurën e renditjes së kandidatëve. ....	77

### MODULI IV .....

#### INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT PËR PROCEDURAT ANKIMORE PËR RASTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV.....

A)	Ankimi gjyqësor.....	78
B)	Monitorimi i indikatorëve të shqyrtimit të ankimeve gjyqësore .....	83

### RASTE STUDIMORE .....

#### EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI .....

#### BIBLIOGRAFIA .....

## HYRJE

Në vitin 2016 Shqipëria ndërmori një reformë të thellë të sistemit të drejtësisë. Në fokusin e kësaj reforme ishte, midis të tjerash, forcimi i meritokracisë në karrierat gjyqësore, e cila konsiderohet një parakusht për rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të gjyqtarëve.

Në këtë kuadër zhvillimesh të vrullshme ligjore dhe institucionale, Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadrin e programit Shoqëria Civile dhe Media 2021 nën IPA III/2022/441-466, ka zhvilluar, ndër të tjera, një metodologji për matjen e meritokracisë në karrierat gjyqësore.

Manuali i Trajnimit mbi “Ngritjen në detyrë në pozicione në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative” vjen si një vijimësi e Metodologjisë “Meritokracia në karrierat gjyqësore” (“**Metodologji/a**”), synimi i së cilës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile për monitorimin e procedurave që kryhen nga KLGj për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, nëpërmjet:

- Thjeshtëzimit dhe lehtësimit të procesit të monitorimit nga shoqëria civile të këtyre procedurave, duke synuar të identifikojë situata dhe siguruar rekomandime të përshtatshme në funksion të rritjes së meritokracisë në promovimin e gjyqtarëve dhe të përgjegjshmërisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve;
- Ofrimit të një kuadri të përgjithshëm monitorimi për aktorët e shoqërisë civile (*organizatat, mediat, studentët e drejtësisë, etj*), me një përmbajtje efektive, të thjeshtë dhe praktike, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizohen nismat e tyre të monitorimit të procedurave për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve.

Në vijim të treguesve dhe të faktorëve të përcaktuar në Metodologji, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet që duhet të zbatohen për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, në procedurën e emërimit të tyre, duke u ndalur në tri kategori kryesore:

1. kriteret ligjore për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me kriteret ligjore;
2. procedurat e emërimit të gjyqtarëve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me procedurën e emërimit;

3. kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me këto kriteret.

Manuali do të ndahet në 4 module, ku secili modul do të strukturohet me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë tri kategoritë e mësipërme:

- A. **Moduli i parë** do të përmbajë një analizë të detajuar të kriterëve ligjorë për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, duke përfshirë, por pa u kufizuar, listimin e kriterëve ligjorë (*përfshirë identifikimin e dispozitave përkatëse ligjore*), objektivat e monitorimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.
- B. **Moduli i dytë** do të përmbajë një analizë të detajuar të procedurës së emërimit të gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, duke përfshirë, por pa u kufizuar, një prezantim të shkurtër mbi elemente të përgjithshme të procedurës së emërimit, objektivat e monitorimit së procedurës së emërimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave mbi procedurën e emërimit.
- C. **Moduli i tretë** do të përmbajë një analizë të detajuar të vlerësimit dhe renditjes të gjyqtarëve që kanë aplikuar në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, duke përfshirë, por pa u kufizuar, listimin e kriterëve për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (*përfshirë identifikimin e dispozitave përkatëse ligjore*), objektivat e monitorimit të renditjes së kandidatëve dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave mbi procedurën e emërimit.
- D. **Moduli i katërt** do të përmbajë një analizë të procedurave ankimore që ndiqen në Gjykatën Administrative të Apelit dhe eventualisht në Gjykatën e Lartë, nga gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritjen në detyrë dhe që kanë pasur ankesa për procesin e ndjekur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.



## OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Duke marrë në konsideratë që:

(i) synimi final i Metodologjisë "Meritokracia në karrierat gjyqësore" është realizimi i një presioni pozitiv mbi KLGj-në, me qëllim që ky i fundit të garantojë inkuadrimin e meritokracisë si një gjendje të qëndrueshme ku gjyqtarët caktohen sistematikisht në pozicionet e karrierës,

dhe se

(ii) ky synim pritet të arrihet përmes monitorimit të jashtëm, të pavarur dhe profesional të karrierave gjyqësore nga shoqëria civile,

ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit dhe thëllimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, me fokus specifik zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve.

Rrjedhimisht, Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë informacion dhe njohuri mbi kushtet e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në pozicionet e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit kusht të zgjedhshmërisë dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme;
- Të ofrojë informacion dhe njohuri mbi procedurën e emërimit të gjyqtarëve në pozicionet e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit hap të procedurës së emërimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme;
- Të ofrojë informacion dhe njohuri mbi procedurën e vlerësimit dhe renditjes sipas meritës të gjyqtarëve në pozicionet e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit kriter të vlerësimit dhe renditjes dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme.

Në përfundim të këtij manuali, aktorët e shoqërisë civile do të kenë njohuritë dhe mekanizmat e duhura për të siguruar:

- ❖ informacion, në kohë reale, lidhur me vakancat në pozicionet e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative;
- ❖ monitorim të pavarur të vlerësimeve të KLGj-së lidhur me përmbushjen ose jo të kushteve ligjore nga kandidatët;
- ❖ monitorim të pavarur të procedurave të emërimit të ndjekura nga KLGj për plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve në pozicionet e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative;
- ❖ monitorim të pavarur të vlerësimeve të KLGj-së lidhur me shkallën e përmbushjes së kushteve dhe të zbatimit të kritereve në vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për gjyqtarët në pozicionet e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative.

duke përmirësuar thelbësisht aftësinë e tyre për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë, për realizimin e meritokracisë së karrierës në gjyqësor, nëpërmjet analizës së thelluar të standardeve të performancës të parashikuara në ligj dhe duke pasqyruar treguesit e realizimit dhe mënyrat e matjes së tyre faktikisht.

Rezultatet e pritshme nga kryerja e monitorimeve në kuadër të Metodologjisë “*Meritokracia në karrierat gjyqësore*”, do të shërbenin:

- (a) për të kuptuar nëse vendimet e KLGj-së për zhvillimin e karrierës në gjyqësor bazohen thjesht dhe vetëm në meritat e kandidatëve (*siç përcaktohen ato nga ligji*) apo në faktorë të paligjshëm si nepotizmi, korrupsioni etj;
- (b) si një referencë për të gjithë politikëbërësit, politikanët, aktorët e shoqërisë civile dhe donatorët që duan të informohen nëse karriera gjyqësore në Shqipëri zhvillohet në bazë të meritokracisë ose të faktorëve të tjerë (*jo të ligjshëm*);
- (c) si i vetmi burim i të dhënave të qëndrueshme (*cilësore dhe sasiore*) dhe të përshtatura për vlerësimin e cilësisë së politikave dhe praktikës së ndjekur nga KLGj lidhur me karrierën e gjyqtarëve;
- (d) si lëndë e parë në procesin e përpilimit të politikave si dhe në vendimmarrjen institucionale në fushën e vlerësimit të karrierës gjyqësore.

## STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE

<b>MODULI 1</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV</b></p> <p><i>A. Kriteret ligjore</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Listimi i kriterëve ligjore për emërimin e gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative;</li> <li>▪ Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjore;</li> <li>▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me kriteret ligjore;</li> <li>▪ Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore.</li> </ul>
<b>MODULI 2</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT</b></p> <p><i>B. Procedura e emërimit të gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Prezantim i shkurtër mbi elemente të përgjithshme të procedurës së emërimit;</li> <li>▪ Objektivat e monitorimit në lidhje me procedurën e emërimit;</li> <li>▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me procedurën e emërimit.</li> </ul>
<b>MODULI 3</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI VLERËSIMIN DHE RENDITJEN E GJYQTARËVE QË KANDIDOJNË PËR NGRITJE NË DETYRË NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV</b></p> <p><i>A. Procedura e vlerësimit dhe renditjes së gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Listimi i kriterëve për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (<i>përfshirë identifikimin e dispozitave përkatëse ligjore</i>);</li> <li>▪ Objektivat e monitorimit mbi renditjen e kandidatëve;</li> <li>▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me renditjen e kandidatëve;</li> <li>▪ Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurën e vlerësimit.</li> </ul>

<b>MODULI 4</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT PËR PROCEDURAT ANKIMORE PËR RASTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQITARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV</b></p> <p><i>A.Ankimi gjyqësor</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkaqet dhe afatet e ankimit;</li> <li>• Procedura dhe vendimmarrja gjyqësore;</li> <li>• Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.</li> </ul>
<b>EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI</b>	
<b>RASTE STUDIMORE</b>	

## PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 2 orë, sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi ngritjen në detyrë në pozicione në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative (Moduli 1)</b></p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me kriteret ligjore që duhet të plotësohen nga gjyqtarët që aplikojnë për ngritje në detyrë me qëllim emërimin në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, objektivat e monitorimit për çdo kriter dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (<i>nëse është rasti</i>)</p>	<p>0.5 orë</p>
<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi ngritjen në detyrë në pozicione në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative (Moduli 2)</b></p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me elementet e procedurës së emërimit për gjyqtarët që aplikojnë për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, objektivat e monitorimit për çdo element të procedurës dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (<i>nëse është rasti</i>)</p>	<p>0.5 orë</p>

<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi vlerësimin dhe renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj të apelit administrativ (Moduli 3)</b></p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me elementet e vlerësimit dhe të renditjes të gjyqtarëve që kanë aplikuar për ngritje në detyrë, me qëllim emërimin në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative, objektivat e monitorimit për renditjen dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>0.5 orë</p>
<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit për procedurat ankimore për rastet e ngritjes detyrë të gjyqtarëve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj të apelit administrativ (Moduli 4)</b></p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me shkaqet, afatet dhe procedurat e ankimit gjyqësor, kundër vendimeve të KLGj-së, nga ana e gjyqtarëve që kanë ankesa mbi këtë vendimmarrje dhe si mund të ndikojë kjo në procesin e ngritjes në detyrë, në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>0.5 orë</p>

## MODULI I

### INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV

#### ***A) Listimi i kriterëve ligjorë për emërimin e gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative***

Parashikimet kushtetuese dhe ligjore, kanë ngritur një sistem të tërë kriteresh të cilat duhet të plotësohen nga shtetasit shqiptarë për t'u bërë gjyqtarë. Normalisht, këta shtetas me plotësimin e kriterëve dhe plotësimin e procedurave ligjore, emërohen si rregull gjyqtarë në gjykatat e shkallës së parë. Por emërimi si gjyqtarë në këtë nivel nuk është fundi i këtij procesi, pasi sistemi juridik në Shqipëri, njeh mundësinë që gjyqtarët të emërohen dhe të ngrihen në detyrë.

Karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera, ku përfshihet dhe karriera, janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre dhe mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim mosçenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë. Statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve.

Duke u fokusuar në objektivin e këtij manuali rezulton se gjyqtarët e shkallës së parë mund të emërohen si gjyqtarë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në gjykatën administrative të apelit.

Baza ligjore për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në këto nivele, buron në radhë të parë nga Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 135 të së cilës parashikohet se pushteti gjyqësor në Shqipëri ushtrohet nga Gjykata e Lartë dhe se gjithashtu me ligj krijohen edhe gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë.

Pra, rezulton se sistemi gjyqësor në Shqipëri, përbëhet nga tri shkallë, ku kemi gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë. Sipas kësaj hierarkie, gjykatat e apelit rregullohen si shkallë e dytë.

Ndërsa nëse i referohemi nenit 135 § 3 të Kushtetutës, rezulton se ligjvënësi ka të drejtë të krijojë dhe gjykata të specializuara. Në këtë rast ligjvënësi e ka shfrytëzuar këtë mundësi, për të krijuar sistemin e gjykatave administrative, ku kemi gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Më tej neni 147/a § 1 germa "a", parashikon se *1. KLGj ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve.* Kjo dispozitë qartësisht përcakton si një ndër kompetencat e KLGj-së dhe mundësinë e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, mundësi e cila duhet që të plotësohet më tej me akte ligjore dhe nënligjore për sa u përket kritereve që gjyqtarët duhet të plotësojnë për t'u ngritur në detyrë dhe që rregullojnë procedurën për emërimin e tyre.

Në mënyrë më të plotë, kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë janë parashikuar në Ligjin nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"*, i ndryshuar. Megjithëse, në dukje ngritja në detyrë, parashikohet në Pjesën III, Kreu V, nenet 47-52 të ligjit, mënyra e formulimit të dispozitave ligjore që të referojnë edhe në norma të tjera, do të thotë që për ngritjen në detyrë, gjejnë zbatim dhe parashikime të tjera ligjore jashtë këtyre dispozitave. Për më tepër këto dispozita plotësohen dhe me akte nënligjore.

Për sa u përket kritereve që duhet të plotësojë një gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë për t'u ngritur në detyrë janë parashikuar nga nenet 6, 32, 47, 48 dhe 105 të Ligjit nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"*, i ndryshuar, si edhe nga neni 6 i Ligjit nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, i ndryshuar.

Me qëllim ruajtjen e një strukture logjike, trajtimi i këtyre dispozitave do të bëhet në mënyrë të tillë që të jenë të kuptueshme dhe jo domosdoshmërisht do të ndjekin renditjen e tyre.

Një prej dispozitave kryesore të ngritjes në detyrë është edhe neni 47 i ligjit nr. 96/2016 që në mënyrë të përmbledhur parashikon se ngritja në detyrë është kalimi nga një pozicion në gjykatë ose prokurori në një pozicion të një niveli më të lartë, ose kalimi nga juridiksioni civil, penal ose administrativ në një pozicion në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe kalimi nga një pozicion i komanduar ose në skemë delegimi në një pozicion më të lartë se sa pozicioni i mbajtur më përpara.

Kjo pikë e kësaj dispozite na jep në thelb kuptimin se çfarë do të kuptojmë me "ngritje në detyrë". Të njëjtin kuptim gjejmë dhe në Vendimin e KLGJ nr. 70, datë 7.2.2020 *"Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve"*, pika 7, germa "dh". Dispozita na jep në këtë rast katër situata të ndryshme, po që për qëllimet e këtij manuali, na intereson vetëm rasti i parashikuar nga germa "a", e cila e konsideron si ngritje në detyrë kalimin



e një gjyqtari të gjykatës së shkallës së parë në një pozicion në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë, në këtë rast në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

### **a) Përvoja profesionale**

Duke vijuar me kriteret ligjore që një gjyqtar duhet të plotësojë për t'u ngritur në detyrë, neni 47 § 4 parashikon se gjyqtari mund të ngrihet në detyrë në gjykatën e apelit nëse ka jo më pak se shtatë vite eksperiencë, ku të paktën pesë prej të cilave duhen në fushën e së drejtës në të cilën është hapur edhe pozicioni i lirë. Pjesë e eksperiencës sipas dispozitës do të llogaritet edhe përvoja si magjistrat i komanduar.

Ky parashikim ligjor na jep një tjetër kriter dhe që lidhet me vjetërsinë në punë. Pra, ngritja në detyrë në një pozicion gjyqtar në një nga gjykatat e apelit, detyrimisht kërkon një përvojë pune më të gjatë, familjarizimin e gjyqtarit me procedurat gjyqësore dhe mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit. Për kriterin e përvojës, dispozita përmend tri elemente të ndryshme, ushtrimin e funksionit *jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë* dhe nga kjo periudhë të paktën 5 vjet të jenë *në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë* duke përfshirë në këtë periudhë *edhe përvojën si magjistrat i komanduar*. Le t'i trajtojmë me radhë.

Kriteri i parë i ushtrimit të profesionit është një kriter i përgjithshëm dhe kërkon që gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë, të kenë ushtruar përvojën e tyre në këtë shkallë gjyqësore për të paktën 7 vjet. Ky afat fillon të ecë nga çasti që ata marrin emërimin nga KLGj-ja si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, në vendin ku janë emëruar. Duke qenë se ligji nr. 96/2016, nuk ka parashikime për mënyrën e përllogaritjes së afateve, atëherë i referohemi parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative ku neni 56 § 3 parashikon se *Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati*. Për rrjedhojë, afati 7-vjeçar në këtë rast, konsiderohet i përmbushur në të njëjtën ditë, të të njëjtit muaj të vitit të shtatë, nga çasti i emërimit të gjyqtarit nga KLGj-ja.

Vendimi i KLGj-së nr. 70, datë 7.2.2020 "*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve*", pika 7, germa "o" e përkufizon këtë afat si "*Vjetërsi si gjyqtar*", nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së gjyqtarit, si gjyqtar, si gjyqtar i komanduar në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor; kjo qasje tregon se gjyqtari mbasi ka marrë emërimin e përhershëm nga KLGj-ja, mund të kryejë edhe funksione të tjera sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, pra të komandohet dhe në pozicione të tjera, por nuk e humbet vjetërsinë dhe përvojën. Në këtë rast afati nuk ndërpritet, por vijon të zbatohet.

Kriteri i dytë përfshihet brenda periudhës 7-vjeçare. Ky kriter kërkon që për pozicionin e lirë, për të cilën gjyqtari është duke aplikuar, të ketë të paktën një përvojë 5-vjeçare në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë. Sipas Vendimit të KLGj-së nr. 70, datë 7.2.2020 "*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve*", pika 7, germa "g": "*Përvojë profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë*", nënkupton përvojën e

*veçantë të punës së gjyqtarit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë të shpallur; Aktualisht sistemi gjyqësor shqiptar njih gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në të cilën gjykohen çështje civile dhe penale, Gjykatën Administrative të Apelit, e cila gjykon çështje administrative, si edhe Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të cilën gjykohen çështje penale.<sup>1</sup>*

Pra, një gjyqtar i shkallës së parë që dëshiron të ngrihet në detyrë në gjykatë apeli të juridiksionit civil, duhet të ketë të paktën 7 vjet përvojë, 5 prej këtyre viteve duhet të ketë pasur përvojë në gjykimin e çështjeve civile, pra të ketë qenë gjyqtar që ka gjykuar çështje civile ose pjesë e seksionit civil në gjykatë, aty ku është rasti. E njëjta gjë vlen edhe për juridiksionin penal dhe atë administrativ.<sup>2</sup>

Ndërkohë që gjyqtarët që janë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm e kanë më të lehtë që të aplikojnë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjyqtarët e gjykatave administrative të shkallës së parë e kanë më të lehtë që të aplikojnë në gjykatën e apelit administrativ, mbetet disi më e vështirë që gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të aplikojnë për pozicione të lira në gjykatën administrative të apelit dhe e anasjella.

Megjithëse një ndarje e tillë ndihmon në profilizimin e gjyqtarëve, përsëri ekziston mundësia që këta gjyqtarë të emërohen dhe në sistem tjetër të gjyqësorit. Në këtë rast përfshihet mundësia e komandimit. Vendimi i KLGj-së nr. 70, datë 7.2.2020 *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”*, pika 7, germa “f” shprehet se *“Përvojë në pozicionet e komanduara”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së gjyqtarit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në KLGj-në e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, sipas pikës 2, të nenit 53,<sup>3</sup> të ligjit për statusin; në çdo pozicion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për interes publik, sipas pikës 7, të nenit 54, të ligjit për statusin; si dhe në çdo pozicion ku është komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara ligjit për statusin, në rastin kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit.*

Siç rezulton nga përkufizimi i mësipërm, komandimi i gjyqtarëve mund të bëhet në disa pozicione, si gjyqtar, por i komanduar në pozicione të tjera, në Gjykatën e Lartë në Gjykatën Kushtetuese, pranë ILD-së, në KLGj, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit dhe

1. Ngritja në detyrë në këtë gjykatë nuk është pjesë e analizës së këtij manuali.

2. Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve–Neni 47 – Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/47>

3. Ligji nr. 96/2016, neni 53 § 2: *“Institucioni në të cilin magjistrati komandohet”, për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, si dhe organizatat ndërkombëtare.”*

në Shkollën e Magjistraturës. Pra, përmenden tetë institucione në total, por lista mbetet e hapur pasi vetë përkufizimi parashikon edhe komandimin *në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, si edhe në organizata ndërkombëtare*. Megjithatë komandimi në këto raste lejohet nga KLGj vetëm *nëse komandimi është në interes publik dhe nuk cenon afatet dhe ushtrimin në mënyrë efëcente të funksioneve*.<sup>4</sup>

Duke qenë se sistemi gjyqësor është në vazhdimësi, pra nuk u krijua me reformën e vitit 2016, atëherë rezulton se shumë anëtarë të trupës gjyqësore e kanë krijuar përvojën e tyre dhe në pozicione të tjera referuar legjislacionit të kohës. Qasja që ka marrë KLGj në këtë rast është pozitive, pasi nuk mohon punën dhe kontributin e gjyqtarëve në pozicione të ndryshme të sistemit.

Por pavarësisht kësaj, nëse i referohemi legjislacionit të mëparshëm, rezulton se ai njihte vetëm mundësinë e transferimit, që si rregull, nuk mund të bëhej pa pëlqimin e gjyqtarëve. Transferimi bëhej detyrues, vetëm kur e kërkonin nevojat për riorganizim. Tjetër rregull ishte edhe ajo e delegimit të gjyqtarëve.<sup>5</sup> Delegimi bëhej në rastet kur një gjykatë nuk kishte mundësi të shqyrtonte një ose disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore. Në atë rast Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me kërkesën e motivuar të kryetarit të gjykatës përkatëse, mund të delegonte gjyqtarë nga gjykata të tjera. Delegimi i gjyqtarëve bëhet vetëm për çështje të caktuara.

Pra, vetëm këto raste mund të shërbejnë si periudhë komandimi, në funksion të legjislacionit aktual. Por duhet pranuar që këto raste nuk ndryshojnë shumë nga rasti kur sipas legjislacionit aktual, gjyqtari përfshihet në skemën e delegimit.

Duke iu kthyer rasteve, përvoja e veçantë të punës së gjyqtarit si gjyqtar i komanduar, mund të sjellë situatën kur është komanduar *në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë*, në këtë rast do të duhet të analizohet nëse është caktuar pranë Kolegjit Administrativ, Kolegjit Civil, apo Kolegjit Penal të kësaj gjykate. Përvoja që gjyqtari merr në këto raste do të klasifikohet sipas të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë. Pra, nëse kjo përvojë lidhet me pozicionin që do të aplikojë, gjyqtarit do t'i konsiderohet si pjesë e plotësimit të kushteve.

Për ta ilustruar me shembuj, nëse një gjyqtar që ka qenë në seksionin civil në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe ka qenë emëruar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, por ka shërbyer pranë Kolegjit Administrativ, dhe kjo përvojë plotësohet me të tjerat komandime, atëherë rezulton se ky gjyqtar mund të emërohet dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. E njëjta gjë mund të thuhet për gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm që kanë shërbyer në dhomën penale dhe ka qenë emëruar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, por ka shërbyer pranë Kolegjit Administrativ. I njëjti shembull vlen nëse gjyqtari ka shërbyer pranë Kolegjit Civil apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, atëherë këta gjyqtarë mund të aplikojnë edhe për këto pozicione në gjykatat e apelit.

4. Ligji nr. 96/2016, neni 54, pika 7.

5. Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor*", i ndryshuar, neni 21.

Për sa i përket komandimit si ndihmësmagjistrat në Gjykatën Kushtetuese, vlerësimi i kësaj përvoje paraqet vështirësinë e saj. Në këtë rast gjyqtari që aplikon për ngritjen në detyrë do të duhet që të justifikojë që puna që ka bërë në Gjykatën Kushtetuese, ka pasur lidhje me fushën e së drejtës civile, penale apo administrative. Zakonisht kjo lidhet me marrjen pjesë në shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor në fushat respektive, por edhe të drejta të tjera, ku për shembull rastet që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës<sup>6</sup> dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike<sup>7</sup> mund të vlerësohen si përvojë në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me komandimin pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, kjo shërben në radhë të parë si përvojë në fushën e së drejtës administrative, por edhe në varësi të çështjeve të inspektuara, mund të konsiderohet dhe si përvojë në fushën penale apo civile.

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për përvojën në Avokaturën e Shtetit, por duke qenë se në pjesën më të madhe ky institucion mbron çështjet pranë gjykatave administrative, përvoja pranë këtij institucioni do të klasifikohet në fushën e së drejtës administrative. I njëjti argument vlen dhe për përvojën pranë KLGj-së dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Në lidhje me përvojën pranë Shkollës së Magjistraturës, kjo mbetet e lidhur me temat që do të trajtohen në programin fillestar dhe/apo vazhdues.

## ***b) Vlerësimi i performancës***

Të gjithë gjyqtarët u nënshtrohen vlerësimeve periodike dhe megjithëse ka qëllime të ndryshme, një ndër to është edhe të informojë KLGj-në në lidhje me vendimet e statusit të magjistratit, në funksion të zhvillimit të karrierës bazuar mbi meritë.<sup>8</sup> Gjithashtu një nga parimet mbi bazën e së cilës zhvillohet procesi i rivlerësimit është parimi i meritokracisë dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së magjistratit kryhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale.<sup>9</sup>

Në këtë proces gjyqtari vlerësohet për aftësitë profesionale, organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si edhe për aftësitë personale.<sup>10</sup>

Procesi i vlerësimit kryhet nga KLGj-ja dhe si rregull një gjyqtar vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar dhe një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.<sup>11</sup>

Në funksion të qëllimit të këtij manuali, rëndësi ka parashikimi i nenit 78 të ligjit nr. 96/2016, i cili përcakton nivelet e vlerësimit dhe më konkretisht parashikon se sistemet e vlerësimit

6. Neni 41 i Kushtetutës.

7. Neni 11 i Kushtetutës.

8. Ligji nr. 96/2016, neni 68, germa “c”.

9. Ligji nr. 96/2016, neni 69, germa “b”.

10. Ligji nr. 96/2016, neni 71.

11. Ligji nr. 96/2016, neni 84, pikat 1 dhe 2.

fillojnë nga “Shkëlqyeshëm” dhe vijojnë në rend zbritës në “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”. Nëpërmjet shtjellimit të detajuar të niveleve të vlerësimit profesional synon të përcaktojë qartë llojet e niveleve të vlerësimit, si dhe mënyrën se si llogaritet dhe përftohet vlerësimi (pikët) i përgjithshëm që i jepet magjistratit në përfundim të procesit të vlerësimit. Renditja e niveleve të ndryshme dhe sqarimi i mënyrës së llogaritjes së vlerësimit e bën procesin e vlerësimit më të parashikueshëm, transparent dhe objektiv se sistemi i mëparshëm jo vetëm për palët e përfshira në këtë proces, por edhe për aktorë të jashtëm.<sup>12</sup>

Referuar kritereve ligjore në këtë rast, që një gjyqtar të ngrihet në detyrë është e nevojshme që ai të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit.

### **c) Mungesa e masave disiplinore**

Një tjetër kriter, i parashikuar nga neni 48 § 8 i Ligjit nr. 96/2016, është që gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë të mos kenë masa disiplinore në fuqi. Si rregull, masat disiplinore janë parashikuar nga neni 105 i Ligjit nr. 96/2016 dhe që janë a) vërejtje konfidenciale; b) vërejtje publike; c) ulje e përkohshme e pagës, e cila mund të jetë deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit; ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar; d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave; dh) shkarkim nga detyra.

Kjo dispozitë ndjek një qëllim të dyfishtë. Nga njëra anë, ai synon të përcaktojë kufijtë e Këshillave në dhënien e masës disiplinore, të cilët janë të detyruar të përzgjedhin vetëm nga lista e caktuar nga ligji. Në këtë mënyrë, neni 105 përmbush parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji. Nga ana tjetër, norma synon të ofrojë një listë prej 6 masash për të mundësuar zbatimin e proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij. Ky synim i dytë përforcohet edhe nga përmbajtja e pikës 2 të nenit 105, që vendos rregulla për caktimin e një mase më të lehtë në rastet kur ndaj magjistratit është caktuar masa administrative e pezullimit të përkohshëm nga detyra për të siguruar mbarëvajtjen e procedimit disiplinor.<sup>13</sup>

Këto masa mbasi jepen qëndrojnë në fuqi për një periudhë të caktuar, kalimi i së cilës (me përjashtim të shkarkimit nga detyra) i fshin ato. Ky kalim i afatit që njihet si “parashkrim” me përjashtim të masës “vërejtje konfidenciale” për të cilën nuk mbahen të dhëna, është: a) dy vjet për “vërejtjen publike”; b) tre vjet për uljen e përkohshme të pagës, për rastet kur paga ulet deri në shumën e pagës mujore; c) katër vjet për uljet e përkohshme të pagës më

12. Aulona Hazbiu, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 78 – Nivelet e vlerësimit”. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/78>

13. Marsida Xhaferllari, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 105 – Masat disiplinore”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/105>



të larta se shuma e pagës mujore dhe uljen në detyrë; ç) pesë vite për pezullimin si masë disiplinore.<sup>14</sup>

Dispozita synon të përcaktojë rregulla të qarta për shuarjen dhe fshirjen nga regjistri të masave disiplinore pas kalimit të afateve sipas specifikës së masës përkatëse. Nga ana tjetër, kjo dispozitë, në funksion të ruajtjes së besimit të publikut të drejtësia, përcakton se masa disiplinore e shkarkimit nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri. Regjistri për çështjet disiplinore (neni 150) si edhe publikimi i vendimeve për çështjet disiplinore dhe ekstrakteve të këtyre vendimeve, sipas nenit 149 të këtij ligji, shërbejnë gjithashtu si bazë të dhënash për kryerjen e analizave dhe të studimeve lidhur me zbatimin e ligjit në këtë fushë, si edhe për hartimin e politikave për rritjen e efektivitetit në zbatimin dhe respektimin e standardeve etike/profesionale nga ana e magjistratëve.<sup>15</sup>

Pra, nëse afatet e mësipërme kanë kaluar atëherë masa disiplinore quhet e shuar dhe nuk shërben më si shkak për të penguar gjyqtarin që të kandidojë për ngritjen në detyrë.

Pavarësisht këtyre parashikimeve, KLGj-ja në praktikën e saj, e konfirmuar dhe nga praktika gjyqësore, ka njohur si masë disiplinore me natyrë penguese dhe masat që kanë marrë organet e rivlerësimit kalimtar. Pra, parashikimet e nenit 48 § 8, të ligjit nr. 96/2016 nuk ngrenë dyshime lidhur me natyrën e masave disiplinore që ushtrojnë efekt pengues në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratit dhe se parashikimet e kësaj dispozite përputhen në mënyrë harmonike me ligjin nr. 84/2016. Instituti i “masave disiplinore” në ngarkim të magjistratit pas ndryshimeve kushtetuese në vitin 2016 ka fituar tashmë status kushtetues. Në nenin “E” të Aneksit Kushtetues, janë parashikuar rastet e dhënies së dy masave disiplinore, në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar të magjistratëve. Në këtë dispozitë, Kushtetuta drejtpërdrejt ka sanksionuar dy masa disiplinore në ngarkim të gjyqtarëve në rast të moskalimit me sukses të procedurës së rivlerësimit, përkatësisht pezullimi nga detyra për një vit, masë kjo e shoqëruar me edukim të detyrueshëm dhe shkarkimin nga detyra. Kushtetuta ka parashikuar gjithashtu se kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji, duke riafirmuar kështu se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, apo Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për shkarkimin nga detyra të magjistratit gëzon statusin e masës disiplinore.

Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës. Ankimi i ushtruar pranë Kolegjit të Apelimit ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra sjell për rrjedhojë pezullimin nga detyra të magjistratit dhe gjatë periudhës së pezullimit ruhet statusi i magjistratit si i tillë, por ruajtja e statusit dhe fakti se vendimi i Komisionit për shkarkimin nga detyra nuk është përfundimtar, nuk do të thotë se vendimi i Komisioni për shkarkim nga detyra nuk

14. Ligj nr.96/2016, neni 150 § 2.

15. Sokol Berberi, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 150 – Regjistri disiplinor”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/150>

përbën masë disiplinore në fuqi për magistratin. Pikërisht për shkak të natyrës së vendimit të Komisionit si një masë disiplinore në fuqi, në rastin e shkarkimit të subjektit nga detyra, ai ndalohet në ushtrimin efektiv të detyrës dhe, për rrjedhojë, edhe promovimi i tij në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016 është i pamundur.<sup>16</sup>

#### ***ç) Afati i largimit nga KLGj-ja***

Një tjetër kriter është edhe fakti që gjyqtarët që kanë qenë anëtarë të KLGj-së nuk mund të kandidojnë për ngritje në detyrë, pa kaluar të paktën 3 vjet nga momenti që u ka mbaruar mandati. Ky ndalim është bërë me qëllim që anëtarët e KLGj-së të mos përdorin pozicionin e tyre për të promovuar veten. Në momentin që një gjyqtar emërohet në KLGj, ai ka një mandat 5-vjeçar. Trupa e anëtarëve që përbëjnë KLGj-në nuk ndryshon menjëherë. Ajo ndryshon me rreth gjysmën e anëtarëve mbas tri viteve dhe pjesa tjetër e anëtarëve ndryshon mbas dy viteve, nga momenti që gjyqtari është emëruar si anëtar i këtij institucioni. Duke vendosur ndalimin për të kandiduar për ngritjen në detyrë për tre vjet mbas mbarimit të mandatit, ligjvënësi është kujdesur që në momentin e aplikimit, asnjë prej anëtarëve të tjerë që kanë qenë njëkohësisht me këtë gjyqtar në KLGj, të jenë përsëri aty.

#### ***d) Vlerësimi i pasurisë dhe i figurës***

Duke vijuar me kriteret e tjera, neni 47 § 3 e Ligjit nr. 96/2016, të referon në ligjin nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar“*, duke kërkuar përmbushjen e disa kriterëve të parashikuara nga ky ligj, që sipas nenit 6 të § 1, germa “a”, parashikon ndër të tjera se kontrolli i verifikimit të pasurisë është një prej kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit.

Kontrolli i pasurisë dhe i figurës e shoqërojnë gjyqtarin në pothuaj çdo çast të karrierës së tij. Kështu, neni 136/a § 1 e Kushtetutës parashikon se gjyqtarët duhet që të kryejnë procesin e verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës.

Pavarësisht se personat e emëruar gjyqtarë të gjykatave të shkallëve të para e kanë bërë një verifikim të tillë të këtyre dy elementeve, kjo nuk do të thotë që ata nuk janë përfshirë më pas në veprimtari të tjera të ndaluara. Pikërisht për të ruajtur sistemin e drejtësisë nga cedime të mëtejshme, ligjvënësi ka parashikuar që verifikimi i pasurisë dhe i figurës të bëhet në çdo procedurë ngritje në detyrë që gjyqtarët aplikojnë.

Me anë të rregullimit, ligjvënësi ka si qëllim kryesor që të promovohen vetëm ata gjyqtarë që përmbushin aftësitë që kërkon Kushtetuta, si në këndvështrimin e formimit të tyre moral, ashtu edhe të formimit profesional. Pra, qëllimi është dhe mbetet që në sistemin e drejtësisë të arrihet të promovohen një kategori e caktuar individësh, të cilët premtojnë për një integritet më të lartë moral e profesional. Nëpërmjet kryerjes me efektivitet të verifikimit të pasurisë dhe të figurës për gjyqtarët për ngritje në detyrë, procesi ligjor që kryhet mbart në vetvete respektimin e parimeve bazë, mbi të cilat mbështetet i gjithë procesi i vlerësimit.

---

16. Vendimi nr. 00-2021-1923, datë 2.12.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë:

Procesi i verifikimit të integritetit realizohet mbi parimet mbi të cilat funksionojnë organet publike, si parimi i bashkëpunimit dhe i ndërveprimit institucional, parimi i informimit, i mbrojtjes së të dhënave dhe të konfidencialitetit, parimi i dhënies së ndihmës aktive, i proporcionalitetit dhe i procesit të rregullt ligjor. I gjithë ky proces vlerësimi për gjyqtarët për ngritje në detyrë synohet të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj. Pra, verifikimi i integritetit si i tillë, kryerja e këtij verifikimi në mënyrë të rregullt dhe efektive, duke i ofruar të gjitha garancitë procedurale gjyqtarit mbetet si qëllimi thelbësor i kësaj dispozite.<sup>17</sup>

### **i) Kriteri i pasurisë**

Për sa i përket kriterit të pasurisë, problemi i parë që shfaqet është çfarë do të kuptojmë me pasuri. Vetë Kushtetuta apo ligji, nuk e përkufizojnë se çdo të kuptojmë me kontrollin e verifikimit të pasurisë, në rastet e ngritjes në detyrë, fakt ky i pranuar dhe nga doktrina.<sup>18</sup>

Një përkufizim na vjen në fakt nga shtojca e Kushtetutës, neni D § 3, sipas së cilës: *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.* Pra, sipas këtij parashikimi, KLGj-ja do të duhet që të verifikojë nëse të ardhurat e realizuara nga gjyqtarët janë deklaruar dhe nëse janë paguar tatimet për to.

Por kjo qasje paraqet dy probleme. E para, vetë norma parashikon që ky kuptim për pasurinë e ligjshme vlen vetëm për rastin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. E dyta, ky proces është i përkohshëm dhe si rregull duhet që të përfundojë në vitin 2026. Pra, shtojca përkatëse e Kushtetutës, bie vetiu nga fuqia me kalimin e këtij afati.

Nga ana tjetër, vetë praktika gjyqësore, në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrimin se të ardhurat konsiderohen të ligjshme nëse *nuk ka rezultuar kryerja e veprimtarisë së paligjshme nga të cilat të jenë gjeneruar këto të ardhura.*<sup>19</sup> Pra, në praktikën gjyqësore, janë pranuar si të ligjshme edhe të ardhurat të cilat megjithëse nuk janë deklaruar apo paguar tatimet, provohet se nuk janë rezultat i veprimtarive të paligjshme.

Vlerësimi në këto raste duhet bazuar në parimin e proporcionalitetit, sipas së cilit veprimtaria administrative e kryer nga organet publike është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: **a) i nevojshëm** për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës, **b) i përshtatshëm** për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj dhe **c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.** Mbi këtë bazë KLGj-ja në vlerësimin e kriterit të pasurisë, duhet që të mbajë në konsideratë zhvillimin historik dhe situatën ekonomike në vendin tonë.<sup>20</sup>

17. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 6.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

18. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

19. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 6.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

20. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 6.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



Lidhur me verifikimin e pasurisë, ligjvënësi i ka parashikuar të tria shkaqet. Vërtetimi i njërit prej tyre e skualifikon kandidatin nga procesi i ngritjes në detyrë dhe më konkretisht kur: “burimet financiare nuk justifikojnë pasuritë e tij”, “nuk ka deklaruar pasuri ose asete”, ose “ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve”. Sipas legjislacionit përkatës, tri shkaqet përjashtuese vlerësohen pas një hetimi të thelluar administrativ që kryen Inspektorati i Lartë për kontrollin dhe deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave (në vijim ILDKPKI), nisur nga justifikimi i burimit të ligjshëm të pasurisë, nga mënyra e përpilimit të deklaratës, si edhe nga motivi i subjektit. Në veçanti, motivi i subjektit lidhet me shkakun përjashtues të fshehjes së pasurisë, nëpërmjet mosdeklarimit, ose të paraqitjes së deklaratës në mënyrë të pasaktë. Vërtetimi i motivit se subjekti, me veprimet e kryera ka “fshehur pasurinë” ose ka bërë një “deklarim të rremë”, është element përcaktues për të konkluduar ILDKPKI, në raportin e vet. Praktika që ndiqet nga ky organ është disavjeçare, por edhe shumë e pasur; për më tepër që jurisprudenca e krijuar nga organet e vetingut që kanë rivlerësuar veprimtarinë e ILDKPKI-së, është bërë tepër e njohur dhe që interpreton të gjitha kriteret mbi të cilat bëhet vlerësimi i pasurisë.<sup>21</sup>

## ii) Kriteri i figurës

Për sa i përket kontrollit të figurës në rastin e Kushtetutës, është parashikimi në shtojcën e saj, ku sipas nenit DH § 1, e përkufizon si *kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar*. Por ky parashikim ka të njëjtat problematika që u përmendën për kontrollin e pasurisë. E para, vetë norma parashikon që ky kuptim për kontrollin e figurës vlen vetëm për rastin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe e dyta, ky proces është i përkohshëm dhe si rregull duhet që të përfundojë në vitin 2026. Pra, shtojca përkatëse e Kushtetutës, bie vetiu nga fuqia me kalimin e këtij afati.

Megjithatë, Ligji nr. 95/2016 ka një shtojcë të tij, ku jepen deklaratat për kontrollin e figurës. Kjo deklaratë në pjesën 6 të saj, ka disa pyetje, nga të cilat mund të nxirren konkluzionet përkatëse se ku duhet të bazohet kontrolli i figurës. Kështu gjyqtari që aplikon për t’u ngritur në detyrë, dhe/apo familjarët e tij nuk duhet të jenë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar, nuk duhet të jenë hetuar dhe/apo akuzuar për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar gjatë 10 viteve të fundit, vetë gjyqtari të mos ketë qenë ndonjëherë i ndaluar, i arrestuar, i dënuar për shkelje ligjore brenda ose jashtë Shqipërisë, të mos ketë pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një telefonate, telekomunikim, takime, aktiviteti, vakti ose raste të tjera, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës, të mos kenë pasur takime, marrëdhënie ose kontakte të papërshtatshme me persona, të cilët në dijeninë e gjyqtarit, kanë qenë ose janë të arrestuar, të dënuar, apo të akuzuar publikisht për përfshirje në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës, të mos ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me

21. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

një person të përfshirë në krimin e organizuar.

Ligjvënësi ka përdorur frazën “lidhje me krimin e organizuar”, por nuk e ka specifikuar llojin e lidhjes. Është e kuptueshme se lidhja me krimin e organizuar duhet të jetë një lidhje e qëllimshme, pra jo e rastësishme dhe që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës. Vlerësimi i anës subjektive është element thelbësor për të bërë një interpretim të plotë dhe për t’i dhënë një kuptim të drejtë kësaj fraze që jep ligji.<sup>22</sup>

Procesi i verifikimit të integritetit realizohet mbi parimet mbi të cilat funksionojnë organet publike, si parimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional, parimi i informimit, i mbrojtjes së të dhënave dhe të konfidencialitetit, parimi i dhënies së ndihmës aktive, i proporcionalitetit dhe i procesit të rregullt ligjor. I gjithë ky proces vlerësimi për kandidatët për magjistratë synohet të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj, “me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm”. Pra, verifikimi i integritetit si i tillë, kryerja e këtij verifikimi në mënyrë të rregullt dhe efektiv, duke i ofruar të gjitha garancitë procedurale kandidatit, mbetet si qëllimi thelbësor i kësaj dispozite.<sup>23</sup>

Cilësitë që kërkohet të ketë një gjyqtar për magjistrat duhet të jenë të kulluara dhe vlerësimi informacioneve në lidhje me sjelljen e gjyqtarit në të shkuarën, shihet në raport me kriterin “verifikim figure” i cili synon të verifikojë cilësitë e nevojshme “morale” të gjyqtarit. Ky nuk është gjykim penal, por administrativ, i cili në vetvete nuk i heq ndonjë të drejtë kandidatit, përderisa nuk është ende gjyqtar apeli, por nuk ia jep një të tillë, bazuar në kritere meritokracie, ku futet edhe vlerësimi i cilësive më të larta morale, në ato raste kur gjyqtari nuk gjendet me figurë morale të përshtatshme, sipas standardeve më të mira etike dhe ligjore që duhet të mishërojë jo vetëm një qytetar shembullor, por edhe një jurist i mirë.

Verifikimi i “figurës” sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, shoqërohet me nevojën për të përzgjedhur dhe lejuar që të vazhdojnë rrugën për t’u promovuar vetëm atyre personave që plotësojnë cilësitë më të larta morale në shoqëri. Ndaj, jo vetëm sjellja që personi mban pasi fiton të drejtën për të qenë gjyqtar për magjistrat, por edhe ajo e mëparshme, i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit. KLGj-ja, nëpërmjet këtij procesi që kryen, vlerëson jo vetëm qenien apo jo i dënuar (si dhe çdo të dhënë që disponojnë organet e ndjekjes penale, pavarësisht fundit të saj procedural), por shkon deri te verifikimi i shkeljeve të mundshme disiplinore në punë që mund të ketë pasur në të shkuarën gjyqtari, të cilat në vetvete mund të duken të shkëputura nga veprimtaria e ardhshme e tij, por që mund të nxjerrin në pah, rrethana që ndikojnë në përshtatshmërinë morale të gjyqtarit për t’u ngritur në detyrë. Ashtu si për magjistratët në detyrë, edhe për gjyqtarët për magjistratë

22. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

23. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

procesi shtrihet si për sjelljet e mbajtura gjatë ushtrimit të detyrave të ndryshme ashtu edhe jashtë tyre, pasi synimi është të mos përfshihen në organet e drejtësisë persona me të cilët nuk garantohet ruajtja dhe forcimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe profesioni ligjor. Natyrisht KLGj-ja, në çdo rast ka për detyrë që në vlerësimin e rasteve individuale të përdorë kujdesin maksimal dhe të mbajë një standard jo vetëm të lartë por edhe të njëjtë vlerësimi, me qëllim që procesi të jetë transparent, i besueshëm dhe shpresësjellës për subjektet e përfshira, por edhe për publikun.<sup>24</sup>

Brenda konceptit të verifikimit të figurës përfshihet edhe kriteri tjetër i parashikuar nga neni 32 për moskualifikimin e kandidatëve kur kanë *“ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”*. Me parashikimin e një rregulli pengues në një nënparagraf të veçantë (shkronja c), duket sikur ligjvënësi kërkon të bëjë një dallim nga shkaqet përjashtuese të sipërcituara. Përdorimi nga ligjvënësi i termave *“tjetër”* dhe *“të njohur”* në formulimin e kësaj fraze, duket se është tej shkaqeve të parashikuara në nenin 28 dhe 32 të ligjit nr. 96/2016. Ky formulim e ka lënë të hapur mundësinë e mospranimit të kandidatit për çdo shkak tjetër ligjor që mund të vërtetohet përpara përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë. Megjithatë, shprehja *“të parashikuar sipas ligjit”*, nuk i jep diskrecion KLGj në këtë drejtim. Kjo nënkupton se vërtetimi i çdo shkakut tjetër skualifikues, në kuptim të parashikueshmërisë dhe sigurisë ligjore, do të ketë të bëjë vetëm me shkaqe përjashtuese, që parashikohen nga ligji dhe që janë të lidhura me integritetin.

Nisur nga kjo analizë, nuk përjashtohet mundësia që një nga kriteret, të cilin kandidati e ka përmbushur në momentin e fillimit të procedurës, të vlerësohet më vonë si një shkak përjashtues, në rast se në momentin e pranimit në formimin fillestar, vërtetohet si i tillë. Si p.sh. dënimi me vendim penal të formës së prerë, apo vërtetimi i një dokumenti si i falsifikuar, mund të përfshihen në këtë koncept. Në rast se vërtetohet një nga shkaqet përjashtuese, pas procesit të verifikimit nga KLGj-ja, por përpara miratimit të renditjes së kandidatëve është e kuptueshme që do të vendoset mospranimi i tij/saj.<sup>25</sup>

### ***e) Papajtueshmëritë***

Duke marrë në konsideratë kriteret ligjore, rezulton se neni 6 i Ligjit nr. 96/2016, ndër të tjera parashikon se funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me veprimtarinë politike qoftë kjo e kryer në kuadër të veprimtarisë së një force politike ose e kryer në mënyrë të pavarur dhe që mund të ndikojë në pavarësinë e tij. Qëllimi i kësaj norme është përcaktimi i papajtueshmërive të magjistratit për shkak të funksionit gjyqësor. Këto funksione i përkasin pushtetit gjyqësor, që është i ndarë nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ. Për këtë shkak, papajtueshmëritë e magjistratit për shkak funksioni lidhen me veprimtarinë politike.<sup>26</sup>

24. Vendimi nr. 00-2022-4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

25. Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”*. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

26. Zyhrada Kongoli, *“Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 6 – Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit”*. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/6>

Shqipëria, sipas nenit 7 të Kushtetutës, është organizuar dhe funksionon në bazë të parimit të ndarjes së pushteteve. Mbi këtë bazë, pushteti gjyqësor është i ndarë nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv. Ky parashikim kushtetues, është plotësuar më tej nga neni 143 i Kushtetutës, i cili e konsideron të papajtueshme qenien gjyqtar me veprimtarinë politike.

Për këtë arsye, ligjvënësi ka synuar nëpërmjet nenit 6 të këtij ligji që të adresojë pikërisht këto parashikime kushtetuese. Ky parashikim ligjor ndalon disa veprime të gjyqtarit të cilat janë:

1. *Pjesëmarrjen në një parti politike.* Sipas këtij ndalimi, një gjyqtar i çdo lloji niveli, nuk duhet të jetë i anëtarësuar në një parti politike. Megjithëse në Shqipëri, listat e anëtarësisë në një parti nuk janë publike, kjo nuk do të thotë që partitë politike nuk kanë regjistra apo të dhëna të tjera të anëtarësisë së tyre. Për rrjedhojë, informacioni për anëtarësinë e një gjyqtari mund të bëhet publik në një moment të caktuar, megjithëse nëse ndodh do të ishte një ngjarje mjaft e rrallë.

2. *Pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;* Ndërkohë që rasti i parë do të ishte një fenomen shumë i rrallë, rasti i dytë mund të jetë më i shpeshtë. Sipas këtij ndalimi, një gjyqtar nuk mund të marrë pjesë në asnjë veprimtari të asnjë force politike. Mënyra si është formuluar kjo dispozitë është mjaft e gjerë dhe përfshin, veprimtari të mbyllura si mbledhje organizative, mbledhje për shkëmbim idesh, por edhe veprimtari të jashtme, si tubime, manifestime, protesta, etj. Ky ndalim shërben edhe në rastet kur partitë politike organizojnë veprimtari që kanë të bëjnë me gjyqësorin, si takime me qëllim diskutimin e problematikave të pushtetit gjyqësor apo promovimin e reformave, ndryshimeve ligjore etj në këtë sektor.

3. *Kryerjen e veprimtarive politike.* Ky ndalim është mjaft i gjerë dhe përfshin jo vetëm veprimtarinë me forca politike, por edhe veprimtari që megjithëse nuk kryhen në bashkëpunim me ndonjë parti politike, përsëri konsiderohen me karakter politik. Një rast i tillë mund të jetë, për shembull, diskutimet politike në media si edhe në rrjetet sociale, shprehja e qëndrimeve të caktuara politike etj.

Një tjetër rast papajtueshmërie është ai i parashikuar nga neni 8 i Ligjit nr. 96/2016 dhe konkretisht papajtueshmëria ambientale. Sipas kësaj dispozite, jemi përpara rastit të papajtueshmërisë ambientale në rastin kur bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, e ushtrojnë funksionin në të njëjtën gjykatë, e ushtrojnë funksionin në të njëjtin seksion, njëri në gjykatën e shkallës së parë dhe tjetri në gjykatën e apelit, ose kur njëri e ushtron në prokurori dhe tjetri në seksionin penal të së njëjtës gjykatë. Gjithashtu dispozita parashikon se dy persona që janë në marrëdhëniet e sipërcituara nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht funksionin në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme.

Synimi kryesor i këtij parashikimi është krijimi i besimit të publiku për sa i përket integritetit dhe imazhit të sistemit gjyqësor, për t'iu përgjigjur interesit publik të miradministrimit të drejtësisë. Në këtë rast, dispozita synon, për aq sa është e mundur të mospasjes së

konfliktit të interesit apo lidhjeve nepotike midis gjyqtarëve të gjykatave të seksioneve, niveleve dhe juridiksioneve të ndryshme.

Për këtë arsye bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërm deri në shkallë të dytë, nuk duhet që të kenë lidhje me gjyqtarë të tjerë me të cilët mund të kontrollojnë vendimet e njëri-tjetrit. Pra, një gjyqtar që kërkon të ngrihet në detyrë, si rregull, nuk mundet që të emërohet në atë gjykatë apeli, qoftë e juridiksionit të përgjithshëm apo të juridiksionit gjyqësor administrativ, nga ku mund të kontrollojë vendimet e të afërmit të tij, që ndodhet i emëruar në një nga gjykatat të shkallës së parë.

Megjithatë ky ndalim nuk është absolut dhe zbatohet për aq sa është e mundur. Dispozita në formatin e vet fillestar, siç ishte miratuar në fillim, ndalonte kategorikisht emërimin e gjyqtarëve në nivele më të larta, kur mund të kontrollojnë vendimet e të afërmit të tyre që shërbenin në gjykatat e shkallës së parë, por ky ndalim kategorik u konsiderua si antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese,<sup>27</sup> pasi kufizonte në mënyrë jopropocionale, karrierën e gjyqtarëve, si një nga privilegjet që ato kanë në bazë të nenit 138 të Kushtetutës.

Rregullimi i ri, është më shumë orientues dhe synon shmangien e kësaj papajtueshmërie për aq sa është e mundur pa cenuar tashmë karrierën e gjyqtarit. Për rrjedhojë, në rast pamundësie, një gjyqtar mund të emërohet në një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, apo gjyqësor administrativ, pavarësisht se të afërmit e tij, mund të shërbejnë në gjykatat e shkallës së parë, veprimtaria e të cilave kontrollohet, mbi baza ankimi nga ana e gjykatave të apeleve.

Në rast se ndodh kjo situatë, atëherë gjyqtari është i detyruar që të heqë dorë në rast se do të ndodhet në trupin gjykues që gjykon një çështje për të cilat i afërmi i tij është shprehur në gjykatën e shkallës së parë si gjyqtar i asaj gjykate, duke zbatuar parashikimet e Kodit të Procedurës Civile dhe të Kodit të Procedurës Penale.

## ***B) Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjore***

### **a) Kushtet ligjore**

Për plotësimin e vendeve vakante në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm të apelit përmes procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në gjykatat civile, penale, administrative ose të posaçme të shkallës së parë, Ligji kërkon që kandidatët të plotësojnë 8 (tetë) kushtet që tregohen në tabelën e mëposhtme<sup>28</sup>:

27. Vendimi nr.34, datë 10.4.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

28. Kandidatët që nuk plotësojnë qoftë edhe 1 nga 8 kushtet e treguara në tabelë përjashtohen nga konkurrimi.

**Tabela 4**

<i>Kandidati është gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë/ kandidati është gjyqtar i komanduar dhe para komandimit ka mbajtur një pozicion në shkallën e parë</i>	<i>Kandidati ka ushtruar funksionin në shkallë të parë për të paktën 7 vjet</i>	<i>Kandidati ka të paktën 5 vjet përvojë në fushën përkatëse të së drejtës</i>	<i>Kandidati është vlerësuar “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit të performancës</i>	<i>Kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi</i>	<i>Kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGj-së në 3 vitet e fundit</i>	<i>Kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë</i>	<i>Kandidati nuk është në situatën e papajtueshmërisë ambientale</i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin (ose jo) e këtyre 8 (tetë) kushteve ligjore.

**TË DHËNA SHITESË:** Përveç monitorimit të kushteve të treguara më sipër, objekti i monitorimit për respektimin (ose jo) e kushteve ligjore për ngritje në detyrë në pozicione në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm të apelit do të përfshijë edhe aspektet e mëposhtme:

- Periudha e monitorimit (p.sh. 1 janar deri 30 mars 2018);
- Numri i vendeve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;
- Pozicionet konkrete të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;
- Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 4 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e gjyqtarëve që kanë kandiduar për pozicionet e lira;
- Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 4 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e pozicioneve të lira;
- Numri i kandidatëve për çdo pozicion;
- Numri i kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë;
- Numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet);
- Rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave.

**Të dhënat shtesë** hidhen në tabelën e mëposhtme:



**Tabela 5**

<i>Periudha e monitorimit</i>	<i>P.sh. 1 janar deri 30 mars 2018</i>
<i>Numri i vendeve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit</i>	<i>P.sh. 23 / 9</i>
<i>Pozicionet konkrete të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit</i>	<i>P.sh. 3 pozicione në apelin e juridiksionit të përgjithshëm – 1 pozicion në apelin e juridiksionit të përgjithshëm</i>
<i>Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 4 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e gjyqtarëve që kanë kandiduar për pozicionet e lira</i>	<i>P.sh. 10 – 50</i>
<i>Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 4 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e pozicioneve të lira</i>	<i>P.sh. 10 – 10 ose 10 – 8</i>
<i>Numri i kandidatëve për çdo pozicion</i>	<i>P.sh.</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>10 për pozicionin në apelin e juridiksionit të përgjithshëm në fushën e të drejtës civile;</i></li> <li>• <i>5 për pozicionin në apelin e juridiksionit të përgjithshëm në fushën e të drejtës penale</i></li> </ul>
<i>Numri i kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë</i>	<i>P.sh. 13</i>
<i>Numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet);</i>	<i>P.sh. 3</i>
<i>Rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave</i>	<i>P.sh. 2 vendime rrëzimi, 1 vendim pranimi</i>

**b) Metodatat për mbledhjen e të dhënave**

Në paragrafët që vijojnë, Metodologjia përcakton metodën konkrete që do të përdoret nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse kushtet e kërkuara nga ligji për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në pozicione në gjykatat civile ose penale të apelit janë respektuar apo jo nga KLGj-ja.

Në vijim, lënda është organizuar në përputhje me katër skenarët e promovimit të parashikuar nga ligji për këtë tip promovimi (shih përkufizimin në faqe 11 të Metodologjisë së Guidës).

**Skenari 1 – Gjyqtari i apelit (administrativ ose i posaçëm) caktohet në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 1, Kushti 1** (kandidati është gjyqtar në një gjykatë apeli) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 1, Kushti 2** (kandidati ka të paktën 1 vit përvojë në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 1, Kushti 3** (kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 1, Kushti 4** (kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGJ në 3 vitet e fundit) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 1, Kushti 5** (kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë) – KËRKESË ZYRTARE PER INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 1, Kushti 6** (kandidati nuk është në situatën e papajtueshmërisë ambientale) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE / FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT.

## **Skenari 2 – Gjyqtari i komanduar caktohet në një pozicion në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 1** (kandidati është gjyqtar i komanduar) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ/ REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 2** (kandidati ka punuar më parë në një gjykatë apeli) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ/ REGJISTRI I GJYQTARËVE DHE KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 3** (kandidati ka të paktën 1 vit përvojë në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 4** (kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 5** (kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGJ-së në 3 vitet e fundit) – KONSULTIM I FAQES SË INTERNETIT dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 6** (kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 2, Kushti 7** (kandidati nuk është në



situatën e papajtueshmërisë ambientale) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE / FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT.

### **Skenari 3 – Gjyqtari në skemën e delegimit caktohet në një pozicion në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 1** (kandidati është gjyqtar në skemën e delegimit) – KONSULTIM I FAQES SË INTERNETIT dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 2** (kandidati ka qenë në skemën e delegimit prej së paku 4 vjetësh) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 3** (kandidati ka punuar të paktën 1 vit në një pozicion në nivel apeli) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 4** (kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 5** (kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGJ në 3 vitet e fundit) – KONSULTIM I FAQES SË INTERNETIT dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 6** (kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 7** (kandidati nuk është në situatën e papajtueshmërisë ambientale) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE / FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT.

### **Skenari 4 – Gjyqtari i shkallës së parë<sup>29</sup> caktohet në një pozicion në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 1** (kandidati është gjyqtar në shkallën e parë/kandidati është gjyqtar i komanduar dhe para komandimit ka mbajtur një pozicion në shkallën e parë/kandidati është në skemën e delegimit por nuk ka punuar të paktën një vit në një pozicion apeli) – KONSULTIM I FAQES SË INTERNETIT dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;

29. Siç është vënë në dukje më sipër, në këtë skenar, me gjyqtarin e shkallës së parë, barazohet edhe gjyqtari i komanduar që para komandimit ka mbajtur një pozicion në shkallën e parë.

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 2** (kandidati ka ushtruar funksionin në shkallë të parë për të paktën 7 vjet) – KONSULTIM I FAQES SË INTERNETIT dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 3** (kandidati ka të paktën 5 vjet përvojë në fushën përkatëse të së drejtës) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 4** (kandidati është vlerësuar “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit të performancës) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 5** (kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 6** (kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGJ-së në 3 vitet e fundit) – KONSULTIM I FAQES SË INTERNETIT dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 7** (kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 4, Kushti 8** (kandidati nuk është në situatën e papajtueshmërisë ambientale) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE / FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT.

### c) Metoda e mbledhjes së të dhënave shtesë

Metodat e përdorura nga monitoruesi për mbledhjen e të dhënave shtesë (shih Tabelën 5 më lart) do të përfshijnë:

- Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së;
- Informacion zyrtar nga KLGj-ja;
- Informacion zyrtar nga gjykata që shqyrton mosmarrëveshjet;
- Intervista eventuale me gjyqtarët që kandidojnë.

### ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore

1. Sa është numri i kandidatëve për t’u ngritur në detyrë, që aplikojnë nga pozita e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
2. Sa është numri i kandidatëve për t’u ngritur në detyrë, në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit

- të përgjithshëm? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
3. Sa është numri i kandidatëve për t'u ngritur në detyrë, në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm që vijnë nga gjykatat administrative të shkallës së parë? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  4. Sa është numri i kandidatëve për t'u ngritur në detyrë, në Gjykatën Administrative të Apelit që vijnë nga gjykatat administrative të shkallës së parë? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  5. Sa është numri i kandidatëve për t'u ngritur në detyrë, në Gjykatën Administrative të Apelit që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  6. Sa është numri i gjyqtarëve të komanduar që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë, në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  7. Sa është numri i gjyqtarëve të komanduar që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë, në Gjykatën Administrative të Apelit? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  8. Sa prej kandidatëve që aplikojnë për ngritje në detyrë, kanë të paktën 2 vlerësime të performancës? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  9. Sa prej kandidatëve që aplikojnë për ngritje në detyrë, kanë më shumë se 2 vlerësime të performancës? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
  10. Sa prej kandidatëve që kanë aplikuar kanë masa disiplinore në fuqi? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve;*
  11. Sa prej kandidatëve që kanë aplikuar kanë masa disiplinore të shuara?
  12. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve;*
  13. Sa prej kandidatëve kanë qenë në të shkuarën anëtar të KLGj-së? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve;*
  14. Sa prej kandidatëve kanë kaluar procesin e vlerësimit të pasurisë? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar ILDKPKI-së dhe KLGj-së;*

15. Sa prej kandidatëve e kanë kaluar procesin e vlerësimit të figurës? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së, BKH-së, AKSIK-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme;*
16. Sa prej kandidatëve rezultojnë të përfshirë në veprimtari politike?
17. Sa prej kandidatëve rezultojnë të përfshirë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGJ/Regjistri i gjyqtarëve/Formulari i vetëdeklarimit të kandidatit;*
18. Sa është numri i pozicioneve civile të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*
19. Sa është numri i pozicioneve penale të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*
20. Sa është numri i pozicioneve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit në Gjykatën Administrative të Apelit? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*
21. Sa është numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë në raport me numrin e pozicioneve të lira. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*
22. Sa është numri i kandidatëve për çdo pozicion të shpallur nga KLGj-ja? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*
23. Sa është numri i kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*
24. Sa është numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet)? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/ Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar GJAA.*
25. Cilat janë rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/ Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar GJAA.*

## MODULI II

### INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV

#### ***A) Procedura e emërimit të gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative***

Vlerësimi i kriterëve të mësipërme kërkon detyrimisht edhe një procedurë përkatëse, e cila rregullohet po nga Ligji nr. 96/2016, si edhe nga Vendimi i KLGj-së nr. 70, datë 07.02.2020 *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”*.

Fillimisht sqarojmë se procedura e plotësimit të vendeve të lira, në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe të gjykatës administrative të apelit plotësohet me procedurën e lëvizjes paralele dhe vetëm nëse nuk është i mundur plotësimi i këtyre vendeve atëherë vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë.<sup>30</sup>

Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, KLGj-ja organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet duhet të plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.<sup>31</sup>

Në këtë rast duhet të specifikojmë se kur një pozicion konsiderohet i lirë. Në vendimin e saj nr. 70, datë 07.02.2020 *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”*, pika 7, germa “h”, KLGj-ja ka përkufizuar pozicion e lirë të përhershëm, si *atë pozicion në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe atë administrativ, për të cilin nuk ka gjyqtar me të drejtën për t’u kthyer në atë pozicion, i shpallur nga KLGj-ja për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë*. Ky përkufizim bëhet për ta dalluar nga rasti i pozicioneve të lira të përkohshme (pika 7, germa “i”) që KLGj-ja e konsideron *atë pozicion në një gjykatë kur gjyqtari që e ka atë në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në këtë pozicion, por që ka të drejtën për t’u kthyer, sipas përcaktimit të bërë në nenin 42, pika 2, fjalia e tretë dhe pika 4, të ligjit për statusin*.

Termi *“pozicion”*, i përdorur nga ligjvënësi, identifikon vendin vakant konkret, të shpallur me vendim të KLGj-së. Pozicioni në sistemin gjyqësor lidhet me vendin e përcaktuar për të

30. Ligji nr. 96/2016, neni 48 § 1.

31. Ligji nr. 96/2016, neni 48 § 2.

ushtruar funksionin dhe nuk lidhet vetëm me ushtrimin e funksionit si gjyqtar, në një nga shkallët e gjykimit. Për këtë arsye, vendet e shpallura vakante konsiderohen secili prej tyre, si një pozicion më vete. Ky konkluzion lidhet edhe me formulimin e pikës 2 të nenit 48 të ligjit, në të cilin përmendet fraza “për çdo pozicion të lirë”, që në rastin në shqyrtim detyron KLGj-në të organizojë një procedurë ngritjeje në detyrë për secilin nga këto pozicione të lira.

Në përmbajtjen e ligjit nr. 96/2016, termi “pozicion” përmendet në disa dispozita ligjore, të cilat në interpretim pajtues me njëra-tjetrën përftojnë konkluzionin se një vend i lirë përkon me konceptin e një pozicioni, pa e lidhur këtë të fundit domosdoshmërisht me kalimin nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë.

Konkretisht, në nenin 39 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet se për caktimin në pozicion të magistratit të emëruar, KLGj-ja shpall “vendet e lira” për të emëruarit, për të vijuar me caktimin “në pozicionet e lira” për gjyqtarët. Përdorimi i togfjalëshit “vendet e lira” është i njëjtë me “pozicionet e lira”.

Pra, shpallja e procedurës për ngritje në detyrë bëhet vetëm për pozicionet e lira të përhershme dhe që KLGj-ja duhet ta shpallë çdo tre muaj. Afati që ka neni 48, konkretisht afati tremujor i organizimit të procedurës së ngritjes në detyrë apo detyrimi për të përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë brenda tre muajve, janë afate organizative dhe orientuese për KLGj-në, në mënyrë që të mos zvarritet në kohë plotësimi i vendeve vakante brenda gjykatave. Kjo do të thotë që kalimi i këtij afati nuk passjell pavlefshmërinë e procedurave.<sup>32</sup>

KLGj-ja shpall procedurën e ngritjes në detyrë dhe bën thirrje që të kandidojë:

- a) gjyqtari që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;
- b) gjyqtari i komanduar ose magistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur.<sup>33</sup>

Shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të KLGj-së dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

- a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës;
- b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
- c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.<sup>34</sup>

Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, gjyqtari mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse gjyqtari kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Gjykatësi që kandidon për

32. Vendimi nr. 00-2021- 15 (4), datë 18.1.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

33. Ligji nr. 96/2016, neni 48 § 3.

34. Ligji nr. 96/2016, neni 43 § 4.



më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.

Kufizimi me ligj, për kandidimin deri në tri pozicione të lira, sipas nenit 48 § 6 të Ligjit nr. 96/2016, është vendosur si për ngritjen në detyrë ashtu edhe për lëvizjen paralele. Kufizimi ligjor i mësipërm nuk shtrihet vetëm në një procedurë të ngritjes në detyrë, ku mund të shpallen një ose më shumë pozicione të lira me vendime të ndryshme. Ky kufizim, për jo më shumë se tri pozicione të shpallura, shtrihet edhe kur pozicionet e lira janë në proces dhe që nuk kanë përfunduar.

Pra, gjyqtari nuk mund të kandidojë në më shumë se tri pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës. Ndryshe nuk do të kishte kuptim kufizimi që ka vendosur ligji, ku parashikohet shprehimisht se pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, gjyqtari ka kufizim për të kandiduar për jo më shumë se tri pozicione të lira, ku përfshihen jo vetëm pozicionet e shpallura të lira, por edhe pozicionet që priten të shpallen të lira nga KLGj-ja. Gjithashtu, kufizimi zbatohet edhe për ato pozicione, të cilat ende nuk janë shpallur si të lira nga KLGj-ja, por që priten të shtojnë numrin e vendeve vakante, brenda procesit të ngritjes në detyrë apo lëvizjes paralele në tërësi. Kufizimi i gjyqtarit për të mos kandiduar në më shumë se tri pozicione të lira, shuhet kur ka përfunduar procesi i ngritjes në detyrë për një pozicion të lirë të caktuar apo për disa pozicione të lira dhe ai nuk është shpallur si gjyqtar fitues. Vetëm në këto kushte gjyqtari ka të drejtën që rishtas të aplikojë për tri pozicione të lira vijuese sipas ligjit.

Siç e përmendëm më sipër, afati tremujor që ka neni 48, për organizimin e procedurës së ngritjes në detyrë apo detyrimi për të përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë brenda tre muajve, janë afate organizative dhe orientuese për KLGj-në, në mënyrë që të mos zvarritet në kohë plotësimi i vendeve vakante brenda gjykatave. Pra, përfundimi i afatit tremujor nuk ka efekte konstitutive apo shuese mbi të drejtat e gjyqtarit për kandidim jo më shumë se në tri pozicione të lira. Edhe pas përfundimit të afatit tremujor nuk shuhet kufizimi, nëse për arsye të ndryshme KLGj-ja nuk e ka respektuar atë dhe procesi i lëvizjes paralele apo i ngritjes në detyrë është ende i papërfunduar.

Ky kufizim lidhet me racionalizimin e numrit të gjyqtarëve në procedurën e ngritjes në detyrë dhe që i shërben miradministrimit të procesit përkatës të vlerësimit që zhvillohet nga KLGj-ja. Gjithashtu, ligji nëpërmjet këtij rregullimi të ri ka synuar të lehtësojë dhe të shpejtojë përfundimin e procedurave të kandidimit për ngritjen në detyrë, duke kufizuar numrin e mundësisë për kandidim të gjyqtarëve dhe duke u kujdesur që të ofrojë një numër mundësish të pranueshëm për kandidim, me qëllim ngritjen në detyrë.

Ky qëllim i ligjit, pra, i mundësisë për kandidim merr vlerë në rastet kur vendet e shpallura vakante janë më shumë se tre dhe se të gjitha eventualitetet e këtij lloji paraqesin një volum pune të shtuar dhe të konsiderueshëm për KLGj-në. Për rrjedhojë, ligji përmes këtij kufizimi ka kërkuar të mos mbingarkojë procedurën e ngritjes në detyrë, ku konkurrimi mund të rezultojë fiktiv, në kushtet e përzgjedhjes së tyre si gjyqtarë në gjykatën më të lartë. Kjo do të

thotë se ligji ka synuar të shmangë situatat e pakufizuara të kandidimeve fiktive, me qëllimin e vetëm për të shtuar mundësitë e suksesit në procedurën e ngritjes në detyrë. Përmes këtij kufizimi, ligji ka dashur të ndërgjegjësojë dhe të bëjë gjyqtarët konkurrues përgjegjës për rëndësinë e vendimmarrjes së tyre në iniciativën e ushtrimit të kërkesës për kandidim në pozicionet e shpallura të lira dhe të hapura për garë nga ana e KLGj-së.

Me këtë kufizim nuk prevalon vetëm interesi i gjyqtarit për t'u ngritur detyrimisht në detyrë, por do të duhet të mbahet në konsideratë edhe interesi publik i miradministrimit të procedurës të ngritjes në detyrë që zhvillon KLGj-ja. Kufizimet ligjore lidhur me kandidimin kanë si qëllim që gjyqtari të vlerësojnë drejtë vullnetin e tij, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat, të cilat mund të ndikojnë në kandidimin, duke analizuar pozicionet ku mund të vlerësojë se ka përparësi në kandidim dhe më pas të materializojnë atë në tri preferenca.<sup>35</sup>

Më pas, nga ana e Këshillit, për gjyqtarët që kanë kandiduar kalohet në verifikimin e tyre duke zbatuar me analogji parashikimet e pikave 2 deri në 7 të nenit 32 të Ligjit nr. 96/2016. Këto parashikime janë në fakt për kandidatët për magistrat që duhet të hyjnë për herë të parë në gjyqësor, por që vetë ligji ka vendosur që i njëjti standard të aplikohet dhe për ngritjen në detyrë.

Procedura e verifikimit rregullohet nga afate që si rregull caktohen në ditë kalendarike.<sup>36</sup> Normalisht dita ku ka ndodhur ngjarja apo veprimi administrativ nuk llogaritet. Kjo do të thotë që afatet fillojnë të llogariten nga e nesërmja.<sup>37</sup>

Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.<sup>38</sup>

Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24 të saj.<sup>39</sup> Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Me përfundimin e afatit të aplikimit, procedura e verifikimit të gjyqtarëve fillon me vendim të KLGj-së, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë.

Në të njëjtën ditë të mbledhjes së KLGj-së zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, të relatorit për secilin gjyqtar. Shorti realizon shpërndarjen rastësore dhe të barabartë, në vijimësi, të ngarkesës së punës, midis anëtarëve të Komisionit. KLGj, për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.<sup>40</sup>

35. Vendimi nr. 00-2021- 15 (4), datë 18.01.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

36. Pika 37 e Vendimit të KLGj-së, nr.70, datë 07.02.2020 "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve".

37. Po aty, pika 38.

38. Po aty, pika 39.

39. Po aty, pika 40.

40. Po aty, pika 24.



Përfshimit, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, KLGj-ja mund të vendosë që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.<sup>41</sup>

Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i KLGj-së, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72,<sup>42</sup> 73,<sup>43</sup> 74<sup>44</sup> dhe 75<sup>45</sup> të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, lidhur me verifikimin e një gjyqtari të caktuar, përpara fillimit të procedurës së shortit për atë gjyqtar apo në çdo kohë kur vjen në dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin e verifikimit, në mbledhjet e Komisionit ose në mbledhjen plenare të KLGj-së për rastin e atij gjyqtari.<sup>46</sup> Për dorëheqjen e çdo anëtari të KLGj-së vendos kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep kryetari i KLGj-së, vendimi merret nga zëvendëskryetari i tij.<sup>47</sup>

Duke qenë se këtë veprimtari, relatori dhe komisioni ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisionit dhe personeli administrativ i KLGj-së, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatitin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit të

---

41. Po aty, pika 25.

42. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhjen e komisionit ose në mbledhjen plenare, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, është i detyruar për sa më poshtë: a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës; b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse; c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

43. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, si në komisionin disiplinor, ashtu dhe në mbledhjen plenare, kur ai ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen që është objekt i procedimit disiplinor për shkak të cilësisë si gjyqtar, prokuror, inspektor, dëshmitar, përfaqësues i palëve, ekspert ose në çdo cilësi tjetër.

44. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin dhe komandimin e një gjyqtari dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, si dhe në çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një gjyqtari ose të funksionarëve të tjerë të sistemit gjyqësor, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli, në qoftë se midis tyre ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme: a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese; b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, unjtë, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehër, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerë.

45. 1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit për shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari, për marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë, transferimin ose komandimin e një gjyqtari dhe as të jetë relator për vlerësimin etik dhe profesional të një gjyqtari, si dhe nga çdo procedim tjetër administrativ që lidhet me statusin e një gjyqtari ose të funksionarëve të tjerë të sistemit gjyqësor, statusi i të cilëve administrohet nga Këshilli, në rastet e mëposhtme: a) kur ai, bashkëshorti/bashkëjetuesi i tij ose fëmijët e tij janë debitorë ose kreditorë në raport me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet ose promovohet, transferohet ose komandohet, ose kanë përfaqësuar interesat e tij në të shkuarën; b) kur mbrojtësi a përfaqësuesi i subjektit të procedimit administrativ është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij; c) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij ose ndonjë të afërmi të tij me subjektin e proceduar ose që duhet të vlerësohet apo promovohet, transferohet ose komandohet; ç) kur ai ose ndonjë nga të afërmit e tij ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të tij është dëmtuar nga veprimet ose aktet e subjektit të procedimit, të cilat janë bërë shkas për fillimin e procedimit disiplinor; d) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit /bashkëjetuesit ka bërë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesën, hetimi i së cilës ka çuar në fillimin e procedimit disiplinor. 2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

46. Pika 26 e Vendimit të KLGj-së, nr.70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”

47. Po aty, pika 28.

çështjes,<sup>48</sup> atëherë edhe mbi personelin e këtyre strukturave gjejnë zbatim dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” mbi paanësinë e administratës publike. Kryetari i KLGj-së është përgjegjës për marrjen e vendimeve për përjashtimin nga vendimmarrja ose konfirmimin e nëpunësve civilë në rast të shfaqjes së konfliktit të interesit.<sup>49</sup>

Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Adresa elektronike e KLGj-së i bëhet e ditur gjyqtarit me njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë. Adresë elektronike e gjyqtarit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit.<sup>50</sup>

Relatori i çështjes kujdeset për zhvillimin e procedimit individual të verifikimit dhe sidomos për sa më poshtë:

- a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga gjyqtari;
- b) përgatitjen e projektaktit administrativ;
- c) koordinimin me kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
- ç) koordinimin me kryetarin e KLGj-së për përgatitjen e mbledhjes plenare të KLGj-së;
- d) njoftimet për gjyqtarin.<sup>51</sup>

Gjyqtari ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe KLGj-ja për verifikimin e tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.<sup>52</sup>

Kryesisht apo mbi kërkesën e KLGj-së, gjyqtari ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.<sup>53</sup>

Gjyqtari ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim KLGj-në. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, KLGj-ja vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të gjyqtarit. Akti i KLGj-së për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë gjyqtarit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të KLGj-së.<sup>54</sup>

Procedura administrative e verifikimit të gjyqtarëve realizohet në katër faza:

---

48. Po aty, pika 48.

49. Po aty, pika 49.

50. Po aty, pikat 41, 42 dhe 43.

51. Ligj 115/2016, neni 63, § 3.

52. Pika 33 e Vendimit të KLGj-së, nr.70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”

53. Po aty, pika 35.

54. Po aty, pika 36.

- a) veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes;
- b) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes;
- c) shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Komisioni;
- ç) shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga KLGj-ja.

#### **a) Veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes dhe përjashtimi i tij**

Pas caktimit me short, relatori i çështjes njofton gjyqtarin për fillimin e procedurës së verifikimit, duke i bërë të ditur të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtari të KLGj-së.<sup>55</sup>

Në rast se gjyqtari paraqet kërkesë për përjashtimin e relatorit të çështjes, KLGj-ja vendos jo më vonë se tri ditë nga depozitimi i saj. Nëse relatori i çështjes përjashtohet, KLGj-ja zhvillon menjëherë procedurat e shortit për caktimin, ndërmjet 2 anëtarëve të tjerë dhe/ose atij zëvendësues të Komisionit, të relatorit të çështjes për atë gjyqtar.<sup>56</sup>

#### **b) Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes**

Procedura e verifikimit të gjyqtarëve fillon dhe zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Relatori i çështjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale dhe verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga gjyqtari.<sup>57</sup>

Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, relatori i çështjes, në varësi të procesit konkret të kandidimit, realizon procedurat standarde si më poshtë:

- i dërgon gjyqtarit, në rrugë elektronike, sipas rastit, formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e gjyqtarit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” ose formularin “Deklaratë e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit” sipas kërkesave të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- i dërgon gjyqtarit, në rrugë elektronike, formularin e “Vetëdeklarimit” sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- i dërgon, në rrugë elektronike, gjyqtarit të vitlindjes më të hershme se korrik 1977, formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015;
- i dërgon gjyqtarit, në rrugë elektronike, formularin për dhënien e miratimit për

55. Kreu VI, germa “A” pika 1, e Vendimit të KLGj-së, nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë”, i ndryshuar.

56. Po aty, Kreu VI, germa “A”, pika 2.

57. Po aty, Kreu VI, germa “B”, pikat 1 dhe 2.

përpunimin e të dhënave personale dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga gjyqtari, këtë formular;

- i dërgon gjyqtarit, në rrugë elektronike, formularin autorizues për verifikimin, në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga gjyqtari, këtë formular;
- i dërgon gjyqtarit, në rrugë elektronike, formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të gjyqtarit dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar prej tij, këtë formular;
- dërgon shkresat standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga gjyqtari, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.<sup>58</sup>

Në rastin e gjyqtarit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga KLGj-ja, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme.<sup>59</sup>

Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga gjyqtari, relatori i çështjes konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, njofton menjëherë gjyqtarin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës përkatëse të KLGj-së. Kur i vlerëson të justifikuarat motivet e paraqitura nga gjyqtari për mospërmbushjen e detyrimit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 5-ditor, relatori i çështjes i cakton një afat të ri të arsyeshëm.<sup>60</sup>

Pas realizimit të procedurave të parashikuara më sipër, relatori i çështjes procedon me dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga gjyqtari, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.<sup>61</sup>

Në procedurën e verifikimit, relatori i çështjes shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga gjyqtari, formularët e deklarimeve të plotësuar, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të gjyqtarit, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e KLGj-së apo që relatori i çështjes vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore për kandidim.<sup>62</sup>

---

58. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 6.

59. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 7.

60. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 9.

61. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 10.

62. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 11.

### c) Procedura e verifikimit të pasurisë së gjyqtarit

Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, gjyqtarit i dërgohen, në rrugë elektronike, formulari “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të gjyqtarit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, si edhe informacioni mbi lidhjen elektronike zyrtare të ILDKPKI-së, në të cilën gjyqtari mund të marrë dhe të plotësojë në rrugë elektronike këtë Deklaratë, përfshirë udhëzimin përkatës për mënyrën e plotësimit të saj.<sup>63</sup>

Njëkohësisht, gjyqtarit i dërgohen, në rrugë elektronike, edhe formularët e autorizimeve për KLGj-në që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit të statusit, të kryejë verifikimin dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion, nga institucioni kompetent për verifikimin e pasurisë, ILDKPKI-ja, si dhe nga organet e administratës tatimore dhe doganore, me të dhëna mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të gjyqtarit dhe personave të lidhur. Autorizimet, të nënshkruara rregullisht nga gjyqtari dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të KLGj-së, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.<sup>64</sup>

Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e KLGj-së për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga KLGj-ja në kërkesën e tyre.

Jo më vonë se 5 ditë nga ajo e nënshkrimit dhe e dorëzimit nga gjyqtarët dhe personat e lidhur të autorizimeve, KLGj-ja i dërgon ILDKPKI-së listën e gjyqtarëve që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore sipas ligjit.

Relatori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkimit, nga organet e administratës tatimore dhe doganore, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të gjyqtarit dhe personave të lidhur.

Jo më vonë se 21 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularit të deklarimit të pasurisë, gjyqtari e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPKI-së,<sup>65</sup> e cila njofton menjëherë KLGj-në në rastin kur gjyqtari nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë.<sup>66</sup>

ILDKPKI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në Deklaratën e pasurisë dhe interesave private të gjyqtarit brenda 2 muajve nga paraqitja e kësaj Deklarate pranë ILDKPKI-së.

Nëse gjatë 180 ditëve para asaj të paraqitjes së Deklaratës, gjyqtari i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë, atëherë kontrolli konsiderohet

63. Po aty, Kreu IX, germa “A”, pika 1.

64. Po aty, Kreu IX, germa “A”, pika 2.

65. Po aty, Kreu IX, germa “A”, pika 4.

66. Po aty, Kreu IX, germa “A”, pika 5.

i kryer. ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë KLGj-së kopjen e deklaramit të bërë nga gjyqtari, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni nga procedura e mëparshme e kontrollit të plotë të deklaramit.<sup>67</sup>

Por nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të gjyqtarit, relatori vjen në dijeni, mbi informacionet dhe dokumentacionin e marrë nga burime të ligjshme (organet e administratës tatimore dhe doganore), për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklaramin e pasurisë së gjyqtarit, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklaramit të gjyqtarit.<sup>68</sup>

Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë KLGj-së raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të gjyqtarit dhe personave të lidhur.<sup>69</sup>

Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të gjyqtarit dhe personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike sipas kërkesës së KLGj-së.<sup>70</sup>

Përmendja në mënyrë specifike e ILDKPKI-së, prej të cilave KLGj-së merr raportet, mbi të cilat vlerësohen çështjet që lidhen me pasurinë, duket sikur i jep një rol vendimtar këtij organi të specializuar, gjatë këtij procesi.

Por asnjë organ vendimmarrës nuk mund të jetë i pakontrollueshëm për mënyrën se si e ushtron veprimtarinë hetimore administrative dhe për vlefshmërinë e veprimeve që kryen. I gjithë ky proces që përfundon me vendimmarrjen e KLGj-së është një verifikim, nga e para, që i bëhet pasurisë dhe figurës së gjyqtarit. Për shkak të qenies së këtij procesi verifikues, është e kuptueshme që ILDKPKI merr një rol të rëndësishëm mbi verifikimin e pasurisë së gjyqtarit, por vendimmarrja e saj nuk mund të jetë e pavlerësueshme nga KLGj-ja, që është i ngarkuar nga ligji për të vendosur përfundimisht mbi këtë çështje.

KLGj-ja është organ i parashikuar nga Kushtetuta, i ngarkuar për të hetuar, shqyrtuar dhe për të gjykuar përfundimisht mbi pasurinë e një gjyqtari. Përderisa, KLGj-ja kryen hetimin administrativ për gjyqtarin, kërkon informacion shtesë nga institucionet e specializuara, apo edhe mund të thërrasë një ekspert të fushës, kur lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaramet e gjyqtarit, nga gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga organet e administratës tatimore dhe doganore, nuk përjashtohet dhënia prej tyre e një vlerësimi të ndryshëm nga konkluzionet e organeve ekzekutive të specializuara.

Ky raport bashkëpunimi ndërinstytucional duket sikur krijon një problematikë, për sa i përket respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve, në aspektin e rrezikut për një ndërhyrje të institucioneve të pushtetit ekzekutiv ndaj organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

67. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 7.

68. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 8.

69. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 9.

70. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 10.



Por, parimi i ndarjes dhe i balancimit ndërmjet pushteteve është i garantuar përderisa KLGj-ja, sipas nenit 32 të ligjit 96/2016, do të kenë kontrollin e plotë të këtij procesi dhe, nëse është e nevojshme, mundësinë të përcaktojnë edhe modalitete të tjera të bashkëpunimit me organet ekzistuese, rast pas rasti. Neni 32 i jep shprehimisht KLGj-së kompetenca të gjera për t'i hetuar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas fjalisë së fundit të pikës 2 të kësaj dispozite ligjore, është KLGj-ja ajo që kur e çmon të nevojshme, mund *“të kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.”* Edhe detyrimi i organeve ekzekutive për të përmbushur kërkesat e KLGj-së, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 32 është në këtë linjë të arsyetimit se bashkëpunimi institucional mbetet synimi kryesor për përmbushjen e misionit për të cilin janë ngarkuar nga ligji, por pa cenuar vendimmarrjen përfundimtare që i mbetet KLGj-së si organe kushtetuese.

Edhe në procedurën administrative të verifikimit të pasurisë ka një set të gjerë kompetencash që i janë dhënë KLGj-së, në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë për verifikimin e pasurisë së gjyqtarëve që kërkojnë ngritjen në detyrë. Rregullat e parashikuara nga KPA për zhvillimin e procedurës administrative plotësohen në mënyrë harmonike me parashikimet ligjore të ligjit nr. 96/2016, ligjit nr. 115/2016, si dhe të vendimit nr. 75/2019 të KLGj-së. Kështu, neni 97 § 3 i ligjit nr. 115/2016 parashikon se *“Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”*, ndërsa vendimi nr. 75/2016 i KLGj-së, parashikon se ky vendim interpretohet dhe zbatohet në përputhje me KPA. Rëndësia e ndjekjes së standardeve të procesit të rregullt ligjor gjatë veprimtarisë administrative shfaqet që në nenin 1 të KPA-së, ku parashikohet se *“Ky kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.”*

Që në nisjen e procedurës administrative organi publik u kërkon subjekteve të interesuara kryerjen e të gjitha veprimeve të domosdoshme që nevojiten për të garantuar efikasitetin e procesit. Gjatë zhvillimit të procedurës administrative, organi publik ka për detyrë të sigurojë që të gjitha palët e përfshira në proces *“të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”* (neni 10 i KPA).

Me qëllim garantimin e zhvillimit të një hetimi të plotë, në referim të KPA-së, KLGj-ja ka autoritet të plotë në funksion të kerkimit të provës. Neni 80 i KPA-së ka parashikuar se, *“1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët; b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira. 2. Dispozitat e parashikuara për ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.*

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.” Neni 80/2 i KPA-së referon te ligji nr. 49/2012 për provat dhe mjetet e provës, të lejuara në procedurën administrative dhe, si rrjedhojë, në mënyrë komplementare (në referim të nenit 1 § 2 të ligjit) edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, mbi burimet e provës, për aq sa është e mundur. Në këtë linjë arsyetimi është edhe parashikimi i pikës 12, të kreut IV të vendimit nr. 75/2019 të KLGj-së (siç u theksua më lart), për thirrjen e ekspertit nga ana e KLGj-së, për të dhënë shpjegime në mbledhjen e KLGj-së.

Në procedurën administrative të verifikimit të pasurisë që ndjek KLGj-ja, raporti i ILDKPKI është vetëm një ndër instrumentet ndihmëse të KLGj-së, në funksion të realizimit të procedurës administrative të vlerësimit. ILDKPKI është një organ i specializuar, në funksion të kontrollit të pasurisë së funksionarëve publikë, raporti përfundimtar i të cilit, vlerësohet nga KLGj-ja së bashku me të gjitha provat e tjera, të marra gjatë procedurës administrative, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, si më sipër. Përfundimet e këtij raporti nuk kanë vlerë të paracaktuar në procesin e të provuarit dhe as prevalencë në raport me provat e tjera, të marra gjatë procedurës administrative nga ana e KLGj-së.

Ligji ka autorizuar një organ kushtetues, KLGj-në, si i vetmi organ përgjegjës, me kapacitetin e duhur profesional dhe me integritetin e nevojshëm, i pajisur me të gjitha mjetet ligjore, në kuadër të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të thelluar të pasurisë për të vlerësuar në mënyrë të drejtë, harmonike, të pavarur dhe diskrecionare të gjitha provat e mbledhura gjatë procedimit administrativ dhe për të konkluduar në mënyrë përfundimtare në funksion të verifikimit të pasurisë së gjyqtarit.<sup>71</sup>

Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, relatori mund të kërkojë:

- a) informacione shtesë nga ILDKPKI-ja, si dhe nga organet e administratës tatimore dhe doganore;
- b) shpjegime me shkrim nga gjyqtari, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijani, duhet të paraqesë këto shpjegime dhe dokumente mbështetëse drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të KLGj-së. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, gjyqtari njofton menjëherë KLGj-në. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton gjyqtarit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.<sup>72</sup>

Në rastin kur në procedurën e verifikimit të pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e gjyqtarit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga organet e administratës tatimore

71. Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

72. Kreu VI, germa “A” pika 11, e Vendimit të KLGj-së, nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë”, i ndryshuar.



dhe doganore, relatori mund të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse.<sup>73</sup>

Ekspertët përzgjidhen nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuara për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara.<sup>74</sup>

Ekspertët caktohen nga Komisioni, mbi propozimet e parashtruara nga relatori i çështjes. Shpenzimet e ekspertit përballohen nga buxheti i KLGj-së.<sup>75</sup>

Gjyqtari që verifikohet njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga KLGj-ja. Jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijani, gjyqtari njofton KLGj-në, duke parashtruar me shkrim edhe motivet konkrete përkatëse, nëse pretendon gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Lidhur me pretendimet e gjyqtarit, KLGj-ja disponon sipas ligjit.<sup>76</sup>

Përpara fillimit të detyrës, eksperti nënshkruan formulën e betimit. Pas veprimit të betimit, sipas udhëzimeve të relatorit, eksperti ka detyrimin të shqyrtojë aktet, të përgatitë, sipas rastit, raport financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.<sup>77</sup>

Kur e vlerëson, KLGj-ja mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e KLGj-së. Në vendimin e arsyetuar të KLGj-së për kualifikimin ose skualifikimin e gjyqtarit, trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti.<sup>78</sup>

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga organet e administratës tatimore dhe doganore, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga gjyqtari, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.<sup>79</sup>

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga organet e administratës tatimore dhe doganore, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga gjyqtari, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e KLGj-së.<sup>80</sup>

Procedura e mësipërme ngarkon me barrën e provës gjyqtarin që kandidon për ngritje në detyrë, i cili duhet të ketë parasysh parashikimet e ligjit nr. 96/2016, konkretisht neni 32 i

73. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 12.

74. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 13.

75. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 14.

76. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 15.

77. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 16.

78. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 17.

79. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 18.

80. Po aty, Kreu IX, germa "A", pika 19.

tij, mbi kontrollin e pasurisë, ku gjyqtari i nënshtrohet verifikimit të plotë të pasurisë dhe është i detyruar të deklarojë të gjitha veprimet juridike të kryera prej tij që kanë lidhje me pasurinë duke argumentuar çdo transaksion financiar me qëllim fitimi, si dhe burimin e krijimit të të ardhurave që kanë lidhje me këto transaksione, pa asnjë kufizim në kohë.<sup>81</sup>

Megjithëse në procesin e vlerësimit të pasurisë, gjyqtari që ka kandiduar për ngritjen në detyrë ka barrën e provës gjatë procedurave administrative dhe gjyqësore për të provuar pretendimet e saj, nga ana tjetër, KLGj-ja ka detyrimin për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, nëpërmjet kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me synim respektimin e parimit të kontradiktoritetit, parimit të barazisë së mjeteve dhe pasjes së një arsytimi për vendimmarrjen.<sup>82</sup>

Pra, rregulli i mësipërm mbi barrën e provës nuk e shmang KLGj-në nga detyrimi për të zhvilluar një hetim të pavarur, në kuadër të vlerësimit të pasurisë, për sa kohë gjyqtari përmbush detyrimet për bashkëpunim me KLGj-në. Ligjvënësi i ka dhënë KLGj-së autoritetin e nevojshëm që në procedurën administrative të verifikimit të pasurisë të kryejë hetime administrative të pavarura, në funksion të verifikimit të plotë të situatës faktike të pasurisë së gjyqtarit, përveç rasteve kur vetë kërkuesi refuzon të plotësojë ose të depozitojë pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaratës së pasurisë ose nëse refuzohet prej tij nënshkrimi dhe depozitimi i autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë. Ligji nr. 96/2016 e ka ngarkuar KLGj-në me detyrimin për të hetuar në mënyrë të plotë dhe të pavarur për provat që paraqiten prej palës kërkuese gjatë procedurës administrative.<sup>83</sup>

Në këtë rast KLGj-ja duhet të marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret mbi kuptimin që ka parimi i proporcionalitetit. Zbatimi i këtij parimi nuk është gjë tjetër veçse një diskrecion (mundësi) që i njihet KLGj-së në marrjen e vendimit përfundimtar për rastin konkret, pa u kufizuar në gjetjet e organeve të specializuara.

Tashmë praktika është konsoliduar në lidhje me këtë parim, sipas së cilit veprimtaria administrative e kryer nga organet publike është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: **a) i nevojshëm** për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës, **b) i përshtatshëm** për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj dhe **c) në përpjesëtim** të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. Në këtë procedurë KLGj-ja duhet të mbajë në konsideratë edhe zhvillimin historik dhe situatën ekonomike që ka ekzistuar në vendin tonë.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit derivon paligjshmërinë e aktit administrativ referuar përcaktimeve të nenit 109, shkronja "e" të Kodit të Procedurës Administrative që sanksionon se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse... nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit."*<sup>84</sup>

81. Vendimi nr. 00-2022-4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

82. Vendimi nr.00-2021-1435, datë 23.9.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

83. Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

84. Vendimi nr. 00-2021-1435, datë 23.09.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Skualifikimi i gjyqtarit vendoset nga KLGj-ja, duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete të rastit dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, në rastet kur të dhënat e marra nga burime të ligjshme tregojnë se:

- a) burimet financiare të gjyqtarit nuk justifikojnë pasuritë e tij;
- b) gjyqtari nuk ka deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;
- c) gjyqtari ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- ç) gjyqtari gjendet në situatën e konfliktit të interesit.<sup>85</sup>

Skualifikimi i gjyqtarit vendoset edhe në rastet kur gjyqtari:

- a) nuk ka plotësuar ose depozituar pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.<sup>86</sup>

Duke qenë se të gjithë gjyqtarët kanë kaluar ose po kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, gjyqtarët, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij akteve të KLGj-së, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i KLGj-së mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit.<sup>87</sup>

Për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, KLGj-ja kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta gjyqtarë fillon verifikimi i pasurisë dhe i figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*. Procedura e verifikimit përmbillet në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar.<sup>88</sup>

Në çdo rast marrja e masës disiplinore, sipas neneve 60 dhe 61, të ligjit *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”* përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve subjekt rivlerësimi kalimtar.<sup>89</sup>

---

85. Ligj 96/2016, neni 32 § 4/1.

86. Kreu VI, germa “A” pika 21, e Vendimit të KLGj-së, nr.75, datë 23.05.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”*, i ndryshuar.

87. Po aty, Kreu X, germa “B”, pika 1.

88. Po aty, Kreu X, germa “B”, pika 2.

89. Po aty, Kreu X, germa “B”, pika 3.

### **ç) Procedura e verifikimit të figurës dhe integritetit të gjyqtarit**

Paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë, nga KLGj, vijohet edhe me procedurën e verifikimit të figurës dhe të integritetit të gjyqtarit. Kështu, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, gjyqtarit i dërgohet në rrugë elektronike:

- a) formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- b) formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, sipas ligjit nr. 45/2015;
- c) informacion mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të KLGj-së, në të cilën gjyqtari mund të marrë dhe të plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, formularët sipas shkronjave “a” dhe “b” si më lart;
- ç) formulari i autorizimit për KLGj-në që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për statusin, të kryejë verifikimin dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për verifikimin e figurës Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së gjyqtarit, me të dhëna mbi figurën dhe integritetin e tij.<sup>90</sup>

Jo më vonë se 5 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularëve të parashikuar në pikën 1 të këtij seksioni, gjyqtari i dorëzon ato të plotësuara në zyrën e posaçme të KLGj-së.

Gjyqtarët që kanë marrë certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.09.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, nuk mbartin detyrimin për plotësimin dhe dorëzimin e formularit të aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015, por duhet të dorëzojnë në zyrën e posaçme të KLGj-së, certifikatën si më lart të pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse. Vetëdeklarimi i gjyqtarit sipas ligjit nr. 138/2015 bëhet publik në faqen zyrtare të KLGj-së.<sup>91</sup>

Struktura e posaçme pranë KLGj-së kryen verifikimet e rastit për të dhënat e deklaruara nga gjyqtari dhe, kur është rasti, kryetari i KLGj-së përcjell formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga gjyqtari, në Prokurorinë e Përgjithshme.<sup>92</sup>

---

90. Kreu IX, germa “B” pika 1, e Vendimit të KLGj-së, nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar.

91. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 2.

92. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 5.

Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit nr. 138/2015 dhe, mundësisht brenda 2 muajve nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni, i dërgon KLGj-së raportin përkatës me përfundimet e procesit të verifikimit. Mosdërgimi në këtë afat i këtij raporti nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk përbën shkak pengues të procedurës së verifikimit të kushteve të emërimit/riemërimit/ngritjes në detyrë, si dhe të pasurisë dhe figurës së atij gjyqtari.<sup>93</sup>

Relatori i çështjes, jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i vetëdeklarimit të gjyqtarit, të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015, në zyrën e posaçme të KLGj-së, kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore nga Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror.<sup>94</sup>

Formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas nenit 29 të ligjit nr. 45/2015, i plotësuar vetëm nga gjyqtari i vitlindjes më të hershme se korrik 1977, i dërgohet menjëherë për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Mosdërgimi i informacionit nga ky Autoritet gjatë kohës së vazhdimit të procedurës së verifikimit të gjyqtarit nga KLGj-ja, nuk përbën shkak pengues për vijimin e verifikimit të kushteve të emërimit/riemërimit/ngritjes në detyrë, si dhe të pasurisë dhe figurës për atë gjyqtar.<sup>95</sup>

Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të figurës dhe integritetit të gjyqtarit, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë seksion;

b) shpjegime me shkrim nga gjyqtari, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijani, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të KLGj-së, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetëse. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, gjyqtari njofton menjëherë KLGj-në. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton gjyqtarit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.<sup>96</sup>

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të figurës dhe integritetit të gjyqtarit.<sup>97</sup>

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen e relacionit

---

93. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 6.

94. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 7.

95. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 8.

96. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 9.

97. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 10.

mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e KLGj-së.<sup>98</sup>

Skualifikimi i gjyqtarit vendoset nga KLGj-ja në rastet kur nga raportet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të institucioneve të tjera të përmendura në këtë seksion, tregohet se gjyqtari:

- ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;
- ka qenë ose është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- nuk ka plotësuar ose depozituar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 dhe/ose formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015;
- ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruar, autorizimin për KLGj që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij.<sup>99</sup>

Edhe në këtë rast përmendja në mënyrë specifike e disa organeve të specializuara, prej të cilave KLGj-ja merr informacionin e domosdoshëm, dokumentacionin e nevojshëm për verifikim, si edhe raportet, mbi të cilat vlerësohen çështjet që lidhen me figurën e gjyqtarit, sipas drejtimeve ligjore që secili organ mbulon, duket sikur i jep rol vendimtar organeve të specializuara, gjatë këtij procesi.

Por asnjë organ vendimmarrës nuk mund të jetë i pakontrollueshëm për mënyrën se si e ushtron veprimtarinë hetimore administrative dhe për vlefshmërinë e veprimeve që kryen. I gjithë ky proces që përfundon me vendimmarrjen e KLGj-së është një verifikim, nga e para, që i bëhet figurës së gjyqtarit. Për shkak të qenies së këtij procesi verifikues, është e kuptueshme që organet ekzekutive të specializuara marrin një rol të rëndësishëm mbi verifikimin e pasurisë dhe të figurës së gjyqtarit, por vendimmarrja e tyre nuk mund të jetë e pavlerësueshme nga KLGj-ja, të cilat janë ngarkuar nga ligji për të vendosur përfundimisht mbi këtë çështje.

KLGj-ja është organ i parashikuar nga Kushtetuta, i ngarkuar për të hetuar, për të shqyrtuar dhe për të gjykuar përfundimisht mbi pasurinë dhe figurën e një gjyqtari. Përderisa, KLGj-ja kryen hetimin administrativ për gjyqtarin, kërkon informacion shtesë nga institucionet e specializuara, apo edhe të thërrasë një ekspert të fushës, kur lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e

98. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 11.

99. Po aty, Kreu IX, germa “B”, pika 2.



gjqtarit, nga gjetjet dhe përfundimet e organeve të specializuara, nuk përjashtohet dhënia prej tyre e një vlerësimi të ndryshëm nga konkluzionet e organeve ekzekutive të specializuara. Pushteti i KLGj-së për të vlerësuar raportet e organeve shtetërore të specializuara si BKH apo SHISH dhe për të vendosur përfundimisht mbi pasurinë dhe figurën e gjyqtarit evidentohet edhe nga vetë rregullimi që gjendet në aktet normative të nxjerra nga KLGj-ja. Pikërisht, marrja në konsideratë e rrethanave të rastit konkret mbi kuptimin që ka parimi i proporcionalitetit, nuk është gjë tjetër veçse një diskrecion që i njihet KLGj-së në marrjen e vendimit përfundimtar për rastin në shqyrtim, pa u kufizuar vetëm në gjetjet e organeve të specializuara.

Ky raport bashkëpunimi ndërinstytucional duket sikur krijon një problematikë, për sa i përket respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve, në aspektin e rrezikut për një ndërhyrje të institucioneve të pushtetit ekzekutiv ndaj organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Parimi i ndarjes dhe i balancimit ndërmjet pushteteve është i garantuar përderisa KLGj-ja, sipas nenit 32 të ligjit 96/2016, do të ketë kontrollin e plotë të këtij procesi dhe, nëse është e nevojshme, mundësinë të përcaktojë edhe modalitete të tjera të bashkëpunimit me organet ekzistuese, rast pas rasti. Neni 32 i jep shprehimisht KLGj-së kompetenca të gjera për t'i hetuar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas fjalisë së fundit të pikës 2 të kësaj dispozite ligjore, është KLGj-ja ajo që kur e çmon të nevojshme, mund "të kërkojë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë." Edhe detyrimi i organeve ekzekutive për të përmbushur kërkesat e KLGj-së, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 32 është në këtë linjë të arsyetimit se, bashkëpunimi institucional mbetet synimi kryesor për përmbushjen e misionit për të cilin janë ngarkuar nga ligji, por pa cenuar vendimmarrjen përfundimtare që i mbetet KLGj-së si organ kushtetues.<sup>100</sup>

Në rastin e kontrollit të figurës cilësitë që kërkohet të ketë një gjyqtar duhet të jenë të kulluara dhe vlerësimi i informacioneve në lidhje me sjelljen e gjyqtarit në të shkuarën, shihet në raport me kriterin "verifikim figure" sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, i cili synon të verifikojë cilësitë e nevojshme "morale" të gjyqtarit. Ky nuk është gjykim penal, por administrativ, i cili në vetvete nuk i heq ndonjë të drejtë gjyqtarit që kandidon për t'u ngritur në detyrë, por nuk ia jep një të tillë (bazuar në kritere meritokracie, ku futet edhe vlerësimi i cilësive më të larta morale), në ato raste kur gjyqtari nuk gjendet me figurë morale të përshtatshme, sipas standardeve më të mira etike dhe ligjore që duhet të mishërojë jo vetëm një qytetar shembullor, por edhe një jurist i mirë.

Në lidhje me këtë, rezulton se verifikimi i "figurës" sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, shoqërohet me nevojën për të përzgjedhur dhe lejuar që të vazhdojnë rrugën për t'u ngritur në detyrë vetëm atyre personave që plotësojnë cilësitë më të larta morale në shoqëri. Ndaj, jo vetëm sjellja që personi mban pasi fiton të drejtën për t'u ngritur në detyrë, por edhe ajo e mëparshmja, i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit. KLGj-ja nëpërmjet këtij procesi që kryen, vlerëson jo vetëm qenien apo jo i dënuar (si dhe çdo të dhënë që disponojnë organet e ndjekjes penale, pavarësisht fundit të saj procedural) por shkon deri te verifikimi

100. Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

i shkeljeve të mundshme disiplinore në punë që mund të ketë pasur në të shkuarën gjyqtari, të cilat në vetvete mund të duken të shkëputura nga veprimtaria e ardhshme e tij, por që mund të nxjerrin në pah, rrethana që ndikojnë në përshtatshmërinë morale të gjyqtarit që kërkon të ngrihet në detyrë. Ky verifikim shtrihet si për sjelljet e mbajtura gjatë ushtrimit të detyrave të ndryshme ashtu edhe jashtë tyre, pasi synimi është të mos përfshihen në organet e drejtësisë persona me të cilët nuk garantohet ruajtja dhe forcimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe profesioni ligjor. Natyrisht KLGj-ja, në çdo rast, ka për detyrë që në vlerësimin e rasteve individuale të përdorë kujdesin maksimal dhe të mbajë një standard jo vetëm të lartë por edhe të njëjtë vlerësimi, me qëllim që procesi të jetë transparent, i besueshëm dhe shpresësjellës për subjektet e përfshira, por edhe për publikun.

Shpeshherë ndaj gjyqtarëve në detyrë bëhen kallëzime penale dhe ankesa pranë ILD-së. Këto veprime në vetvete nuk paragjykojnë pozitën e gjyqtarit, pasi askush nuk mund të kontrollojë veprimet e të tjerëve që mund të zgjedhin të paraqesin kallëzim apo ankesë, porse në kuadër të vlerësimit moral të cilësive të nevojshme për t'u ngritur në detyrë, të lidhura edhe me kriterin e pasurisë, mund ta çojnë KLGj-në që të vlerësojë papërshtatshmërinë e gjyqtarit për t'u ngritur në detyrë. Pra, fakti se këto kallëzime penale janë pushuar (ose vendosur mosfillim) nga prokuroria apo gjykata, apo ankesat janë pushuar nga ILD-ja nuk janë përcaktues për çështjen. Kjo sepse këto materiale shihen në raport me rastet e evidentuara gjatë verifikimit të figurës së gjyqtarit, që lidhen me veprimet e gjyqtarit ndaj të tretëve dhe që mund të konsistojnë në kërcënimet e pretenduara verbale, kërcënime këto të bëra për motive të dobëta dhe aspak të ligjshme, të cilat tregojnë për sjellje në kundërshtim të hapur me normat e moralit shoqëror dhe, aq më tepër, me standardet etike dhe morale të gjyqtarëve.

Në këto raste nuk mund të ngrihen pretendimet se cenohet parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi integriteti dhe morali i gjyqtarit nuk kanë nevojë për vendim penal të formës së prerë, apo procedim disiplinor nga ILD, për t'u provuar, por provohet nga fakte dhe rrethana të cilat kanë ndodhur dhe të cilat në rastin konkrete provohen nga aktet zyrtare të institucioneve.<sup>101</sup>

Gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i KLGj-së mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit.<sup>102</sup>

Për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, KLGj-ja kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta gjyqtarë fillon verifikimi i figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe

101. Vendimi nr. 00-2022-4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

102. Kreu X, germa “B”, pika 1, e Vendimit të KLGj-së, nr.75, datë 23.05.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë”*, i ndryshuar.



të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*. Procedura e verifikimit përmbillet mbas dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar.<sup>103</sup>

Marrja e masës disiplinore, sipas neneve 60 dhe 61, të ligjit *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”* përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve subjekt rivlerësimi kalimtar.<sup>104</sup>

#### **d) Procedura e verifikimit të kushteve të tjera ligjore të kandidimit**

Siç e përmendëm te kriteret e kandidimit, një tjetër kriter është pajtueshmëria politike e gjyqtarëve. Në lidhje me këtë kriter, jo më vonë se tri ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, gjyqtarit i dërgohet, në rrugë elektronike, formulari i autorizimit për KLGj që, të kryejë verifikimin e të dhënave që lidhen me plotësimin e kushteve të pajtueshmërisë sipas nenit 6 të ligjit për statusin, nga kryetari i gjykatës përkatëse ku gjyqtari ka ushtruar funksionet. Autorizimi, i nënshkruar rregullisht nga gjyqtari, depozitohet pranë zyrës së posaçme të KLGj-së, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.<sup>105</sup> Ky kontroll zbatohet edhe në rast se gjyqtari ka qenë i komanduar në pozicione si ILD, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë e të tjera dhe verifikohet nëse ka marrë masa të tjera disiplinore, në këto organe dhe që janë në fuqi.

Relatori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga gjyqtari për të vlerësuar nëse, për efekt të verifikimit të kushteve dhe të kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë dhe nuk gjenden elemente që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij.<sup>106</sup>

Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerëson se të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, përmbajnë pasaktësi ose edhe elemente që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, relatori mund të kërkojë shpjegime me shkrim nga gjyqtari, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijani, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të KLGj-së, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetëse. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, gjyqtari njofton menjëherë KLGj-në. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton gjyqtarit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.<sup>107</sup>

Nëse nga gjetjet e procesit të verifikimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.<sup>108</sup>

---

103. Po aty, Kreu X, germa “B”, pika 2.

104. Po aty, Kreu X, germa “B”, pika 3.

105. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 1.

106. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 2.

107. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 3.

108. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 4.

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga gjyqtari, si edhe nga gjetjet e përfundimet e nxjerra nga shqyrtimi i shkresave të dërguara nga subjektet publike dhe private, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e KLGj-së.<sup>109</sup>

Skualifikimi i gjyqtarit vendoset nga KLGj-ja në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga gjyqtari, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike apo private, rezulton se gjyqtari nuk plotëson ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të parashikuara, përkatësisht, nga neni 6 të ligjit nr. 96/2016, apo ka masa disiplinore në fuqi, në kohën që ka qenë i komanduar.<sup>110</sup>

Skualifikimi i gjyqtarit vendoset edhe kur gjyqtari ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për KLGj-në që të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, sa u përket të dhënave që lidhen me plotësimin e kushteve dhe të kritereve të tjera ligjore të kandidimit.<sup>111</sup>

Në çdo rast KLGj-ja çmon, sipas bindjes së saj, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

#### **dh) Vijimi i procedurës**

Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e kualifikimit ose të skualifikimit të gjyqtarit, pasi vë në dijeni Komisionin, me vendim të këtij të fundit, relatori i çështjes njofton gjyqtarin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

- brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës përkatëse të KLGj-së ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të gjyqtarit;
- të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjese të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kritereve përkatëse ligjore, për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit.<sup>112</sup>

Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, gjyqtari njofton menjëherë KLGj-në, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i çështjes i cakton

---

109. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 5.

110. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 6.

111. Po aty, Kreu IX, germa “Ç”, pika 7.

112. Po aty, Kreu VI, germa “B”, pika 12.

gjqtarit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.<sup>113</sup>

Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve, gjyqtari nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të KLGj-së, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit.<sup>114</sup>

Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori i çështjes vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e gjyqtarit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit. Komisioni, nëse verifikimet janë të plota, vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e KLGj-së.<sup>115</sup>

Nëse vlerëson që gjyqtari nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit, pa qenë e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore. Komisioni vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e KLGj-së.<sup>116</sup>

Kur gjyqtari njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të gjyqtarit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e KLGj-së.<sup>117</sup>

#### **e) Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Komisioni**

Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e njoftimit të kryetarit të Komisionit.

Në mbledhjen e Komisionit, kryetari fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore nga gjyqtari i verifikuar.

Komisioni, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në KLGj nëse procedurat e verifikimit janë të plota ose i kërkon relatorit të çështjes vijimin e procedurës së verifikimit, duke evidentuar edhe

---

113. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 13.

114. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 14.

115. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 15.

116. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 16.

117. Po aty, Kreu VI, germa "B", pika 17.

çështjet që kanë nevojë të verifikohen më tej.

Relatori i çështjes ka detyrimin të kryejë verifikimet e evidentuara nga Komisioni, në përfundim të të cilave njofton kryetarin e Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim.<sup>118</sup>

### **ë) Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga KLGj-ja**

Kryetari i KLGj-së, menjëherë pas njoftimit nga kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e KLGj-së, duke u dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga ajo e njoftimit të kryetarit të Komisionit.

Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së KLGj-së, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, i njoftohet gjyqtarit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të KLGj-së.

Në mbledhjen e KLGj-së, kryetari i KLGj-së fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga gjyqtari i verifikuar.

Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të çështjes, nëse vlerësojnë, anëtarët e KLGj-së mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

Nëse anëtarët e KLGj-së nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, KLGj-ja deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit.

KLGj-ja, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për të gjitha çështjet që parashtrohen në relacionin e përgatitur prej tij ose që vlerësohen nga anëtarët.

Në përfundim të bisedimeve, për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, me tej anëtarët e tjerë të KLGj-së dhe në fund kryetari i KLGj-së. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit të KLGj-së është përcaktuese. Në çdo rast, vendimi i KLGj-së arsyetohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e shpalljes. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KLGj-së që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën "kundër" dhe nënshkruan vendimin. Përveç rastit kur ka mbetur në pakicë, arsyetimi i vendimit të KLGj-së bëhet nga relatori i çështjes. Anëtari që ka mbetur në pakicë, arsyeton qëndrimin e tij, i cili i bashkohet vendimit.<sup>119</sup>

Në rastin kur, pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e gjyqtarit të verifikuar, KLGj-ja vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, por në atë çështje nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara më

---

118. Po aty, Kreu VI, germa "C", pikat 1-4.

119. Po aty, Kreu VI, germa "Ç", pikat 1-10.

sipër, shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Gjyqtarit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Gjyqtari ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetëse, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e ardhjes në dijëni të materialit të dërguar nga KLGj-ja.<sup>120</sup>

Pas bisedimit dhe votimit të çështjes, KLGj-ja vendos kualifikimin e gjyqtarit dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë ose skualifikimin e gjyqtarit gjyqtar dhe përjashtimin e tij nga procedura e ngritjes në detyrë.<sup>121</sup>

KL Gj-ja vendos skualifikimin e gjyqtarit nëse ai nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

- a) deklaratimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë gjyqtari;
- b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të gjyqtarit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të KLGj-së.<sup>122</sup>

KL Gj-ja vendos skualifikimin e gjyqtarit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të KLGj-së, gjatë procedurës së verifikimit, gjyqtari përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, të autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.<sup>123</sup>

## **f) Vendimi i verifikimit**

Vendimi i verifikimit arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ. Vendimi i verifikimit njoftohet sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit të statusit dhe bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të KLGj-së, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve.<sup>124</sup>

Në faqen zyrtare të KLGj-së publikohen edhe:

- a) lista e gjyqtarëve për të cilët është vendosur kualifikimi në procedurën përkatëse për ngritje në detyrë për një pozicion të lirë;
- b) lista e gjyqtarëve për të cilët është vendosur skualifikimi në procedurën përkatëse për ngritje në detyrë për një pozicion të lirë.<sup>125</sup>

---

120. Po aty, Kreu VI, germa “Ç”, pika 11.

121. Po aty, Kreu VI, germa “Ç”, pika 12, shkronja “ç”.

122. Po aty, Kreu VI, germa “Ç”, pika 13.

123. Po aty, Kreu VI, germa “Ç”, pika 14.

124. Po aty, Kreu VII, pikat 1-2.

125. Po aty, Kreu VI, germa “Ç”, pika 2.

## B) Objekti i monitorimit për zbatimin e procedurave

### a) Hapat e procedurës

Në këtë seksion, në Metodologji do të shpjegohet procedura ligjore për ngritjen në detyrë në pozicione në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe do të tregohet se çfarë konkretisht duhet monitoruar për të kuptuar nëse respektohet apo jo procedura e kërkuar nga ligji (dhe nëse kryhen verifikimet e duhura) për plotësimin e vendeve vakante në këtë gjykatë.

**Skenari 1:** Për plotësimin e vendeve vakante në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm përmes procedurës së lëvizjes paralele, Ligji kërkon të kryhen 7 (shtatë) hapat e procedurës dhe verifikimet që tregohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 6**

<i>KL Gj-ja shpall vakancat çdo 3 muaj</i>	<i>Vakancat shpallen të paktën në faqen zyrtare të KL Gj-së</i>	<i>Shpallja e vakancës përmban informacionin e kërkuar nga ligji<sup>126</sup></i>	<i>Afati për kandidimin është të paktën 2 javë nga data e shpalljes së vakancës</i>	<i>Numri i kandidimeve është i barabartë ose më i madh se numri i vakancave të shpallur<sup>a127</sup></i>	<i>KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga kandidimi</i>	<i>KL Gj-ja verifikon plotësimin e kushteve dhe shpall listën e kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm<sup>m128</sup></i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për kryerjen (ose jo) të këtyre 7 (shtatë) hapave proceduralë dhe verifikimeve.

**Skenari 2:** Për plotësimin e vendeve vakante në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm përmes procedurës së ngritjes në detyrë, Ligji kërkon të kryhen 7 (shtatë) hapat e procedurës dhe verifikimet që tregohen në tabelën e mëposhtme:

126. Neni 43/4 i Ligjit Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve urdhëron që shpallja të përcaktojë qartë: (i) afatin e kandidimit; (ii) dokumentacionin që kandidati duhet t'ia bashkëngjisë aplikimit; (iii) procedurën e kandidimit dhe (iv) vendin ku duhet dorëzuar aplikimi. Në qoftëse shpalljes i mungon qoftë edhe një nga këto elemente, vlerësimi i monitoruesit për këtë pikë do të jetë negativ.

127. Në rast se numri i kandidimeve përmes procedurës së lëvizjes paralele është më i vogël se numri i vakancave të shpallura, KL Gj-ja shpall procedurën e ngritjes në detyrë.

128. Ligji nuk parashikon shprehimisht një afat brenda të cilit KL Gj-ja duhet të kryejë verifikimin nëse kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore për ngritje në detyrë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se procesi i verifikimit përfshin komunikimin shkresor me ILDKPKIKI-në për verifikimin e pasurisë së kandidatit, me Byronë Kombëtare të Hetimit (ose Shërbimin Informativ Shtetëror) për verifikimin e figurës së kandidatit (shih nenet 48/7 dhe 32/2-7 të ligjit të statusit) dhe çdo organ tjetër që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit në të shkuarën, si dhe duke pasur parasysh se afati maksimal ligjor për plotësimin e pozicionit vakant është 3 muaj nga data e shpalljes së vakancës (shih nenin 48/2 të Ligjit për Statusin), për qëllimet e kësaj Metodologjie do të konsiderohet afati i arsyeshëm për verifikimin e kushteve të kandidimit 30 ditë nga data e dorëzimit të dosjes së kandidimit.



**Tabela 7**

<i>KL Gj-ja shpall vakancat çdo 3 muaj</i>	<i>Shpallja përmban edhe vakancat në gjykatat civile, dhe penale të apelit<sup>129</sup></i>	<i>Vakancat shpallen të paktën në faqen zyrtare të KLGj-së</i>	<i>Shpallja e vakancës përmban informacionin e kërkuar nga ligji<sup>130</sup></i>	<i>Afati për kandidimin është të paktën 2 javë nga data e shpalljes së vakancës</i>	<i>KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga kandidimi</i>	<i>KL Gj-ja verifikon plotësimin e kushteve dhe shpall listën e kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm<sup>131</sup></i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për kryerjen (ose jo) të këtyre 7 (shtatë) hapave proceduralë dhe verifikimeve.

**TË DHËNA SHITESË:** Përveç monitorimit të hapave proceduralë dhe verifikimeve të treguara në skenarët e mësipërm të ngritjes në detyrë (tabelat nr. 6 dhe 7), objekti i monitorimit për kryerjen (ose jo) e hapave proceduralë dhe verifikimeve për ngritje në detyrë në pozicione në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm do të përfshijë edhe aspektet e mëposhtme:

- Numrin e pozicioneve për të cilat kandidon secili kandidat<sup>132</sup>;
- Numrin e kandidatëve që ngrihen në detyrë në pozicionin që ishte zgjedhja e tyre e parë;
- Numrin e kandidatëve për çdo pozicion.

## **b) Metoda e mbledhjes së të dhënave për monitorimin e procedurave**

Në paragrafët që vijojnë, në Metodologji do të përcaktohet metoda konkrete që do të përdoret nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse KL Gj-ja ka kryer procedurat dhe verifikimet e kërkuara nga ligji për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në pozicione në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Në vijim, lënda është organizuar në përputhje me dy skenarët / procedurat e promovimit

129. Shpallja për plotësimin e vendeve vakante në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm përmes procedurës së ngritjes në detyrë lejohet vetëm nëse numri i kandidimeve përmes procedurës së lëvizjes paralele ka qenë më i vogël se numri i vakancave të shpallura.

130. Neni 43/4 i ligjit Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve urdhëron që shpallja të përcaktojë qartë: (i) afatin e kandidimit; (ii) dokumentacionin që kandidati duhet t’ia bashkëngjisë aplikimit; (iii) procedurën e kandidimit dhe (iv) vendin ku duhet dorëzuar aplikimi. Në qoftë se shpalljes i mungon qoftë edhe një nga këto elemente vlerësimi i monitoruesit për këtë pikë do të jetë negative.

131. Ligji nuk parashikon shprehimisht një afat brenda të cilit KL Gj-ja duhet të kryejë verifikimin nëse kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore për ngritje në detyrë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se procesi i verifikimit përfshin komunikimin shkresor me ILDKPKIKI-në për verifikimin e pasurisë së kandidatit, dhe me Byronë Kombëtare të Hetimit (ose Shërbimin Informativ Shtetëror) për verifikimin e figurës së kandidatit (shih nenet 48/7 dhe 32/2-7 të ligjit të statusit), si dhe duke pasur parasysh se afati maksimal ligjor për plotësimin e pozicionit vakant është 3 muaj nga data e shpalljes së vakancës (shih nenin 48/2 të ligjit të statusit), për qëllimet e kësaj Metodologjie do të konsiderohet afat i arsyeshëm për verifikimin e kushteve të kandidimit 30 ditë nga data e dorëzimit të dosjes së kandidimit.

132. Në bazë të nenit 48/6 të ligjit Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira. Në këtë rast kandidati bën renditjen e tyre sipas preferencës.



të parashikuar nga ligji për këtë tip pozicionesh (*shih* shpjegimin për 2 skenarët / procedurat në faqen 18 të kësaj Metodologjie).

### **Skenari 1 – Gjyqtari caktohet në një pozicion në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm përmes procedurës së lëvizjes paralele**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 1** (*KL Gj-ja shpall vakancat çdo 3 muaj*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 2** (*vakancat shpallen të paktën në faqen zyrtare të KLGj-së*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 3** (*shpallja e vakancës përmban informacionin e kërkuar nga ligji*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 4** (*kandidatëve iu jepet të paktën 2 javë kohë për të përgatitur aplikimin*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 5** (*numri i kandidatëve është i barabartë ose më i madh se numri i vakancave të shpallura*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 6** (*KL Gj kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga kandidimi*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 1, Procedura/Verifikimi 7** (*KL Gj-ja verifikon plotësimin e kushteve nga kandidatët dhe shpall listën e kandidatëve të kualifikuar brenda një afati të arsyeshëm*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ dhe KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

### **Skenari 2 – Gjyqtari caktohet në një pozicion në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm përmes procedurës së ngritjes në detyrë**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 1** (*KL Gj-ja shpall vakancat çdo 3 muaj*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 2** (*shpallja përmban vakanca në gjykatat civile ose penale të apelit*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 3** (*vakancat shpallen të paktën në faqen zyrtare të KLGj-së*) – KONSULTIM PERIODIK I

FAQES ZYRTARE TË KLGJ;

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 4** (*shpallja e vakancës përmban informacionin e kërkuar nga ligji*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 5** (*kandidatëve iu jepet të paktën 2 javë kohë për të përgatitur aplikimin*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 6** (*KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga kandidimi*) – KËRKESË ZYRTARE PER INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Procedura/Verifikimi 7** (*KL Gj-ja verifikon plotësimin e kushteve nga kandidatët dhe shpall listën e kandidatëve të kualifikuar brenda një afati të arsyeshëm*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ dhe KËRKESË ZYRTARE PER INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

**c) Metoda e mbledhjes së të dhënave shtesë**

Metodat e përdorura nga monitoruesi për mbledhjen e të dhënave shtesë (shih më lart) do të përfshijnë:

- Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së;
- Informacion zyrtar nga KLGj-ja;
- Intervista eventuale me gjyqtarët që kandidojnë.

**Tabela 8**

<i>Emri</i>	<i>Rezultati i vlerësimit të fundit profesional të kandidatit</i>	<i>Rezultati i vlerësimit të parafundit profesional të kandidatit</i>	<i>Magjistrati ka përvojë në pozicionet e komanduar</i>	<i>Kohëzgjatja e periudhës së komandimit në vite (n.q.s. ka)</i>	<i>Magjistrati ka përvojë në skemën e delegimit</i>	<i>Magjistrati ka përvojë si anëtar i KLGj-së</i>
<i>Pikët</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkëlqyeshëm;</li> <li>• Shumë mirë<sup>133</sup></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkëlqyeshëm;</li> <li>• Shumë mirë<sup>134</sup></li> </ul>	<i>PO / JO</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• &lt;1</li> <li>• 1-3</li> <li>• 4-6</li> <li>• 7-10<sup>135</sup></li> </ul>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave dhe renditjes së tyre sipas kritereve të treguara në tabelën nr 8, KLGj-ja ngre në detyrë gjyqtarin sipas rregullave të përcaktuara për fazën e parë, në faqen 24 të kësaj metodologjie.

133. Monitoruesi rrethon / shënon alternativën sipas rastit.

134. Monitoruesi rrethon / shënon alternativën sipas rastit.

135. Monitoruesi rrethon / shënon alternativën sipas rastit.

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të ketë në konsideratë që ngritja në detyrë është e bazuar në një përparësi kriteresh. Kriteri që ka përparësinë kryesore është vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Vetëm në rast të barazisë së kriterëve, kalohet në përparësinë tjetër, të një rëndësie më të ulët. Si shembull, në rast se një kandidat ka dy vlerësime shkëlqyeshëm, por nuk ka eksperiencë si gjyqtar i komanduar, ndërkohë që një kandidat tjetër ka një vlerësim shkëlqyeshëm dhe një vlerësim shumë mirë, por njëkohësisht ka edhe 5 vite eksperiencë si magjistrat i komanduar, përzgjidhet kandidati që ka dy vlerësime shkëlqyeshëm, pavarësisht se nuk ka eksperiencën si gjyqtar i komanduar. Sidoqoftë, kujdes i veçantë i duhet kushtuar kriterit të përvojës së mëparshme si anëtar i KLGj-së, i cili nuk duhet ngatërruar me kushtin skualifikues të kandidatëve. Diferenca qëndron në faktin që kjo përvojë pune konsiderohet si kriter avantazhues vetëm nëse përvoja e mëparshme si anëtar i Këshillit ka përfunduar të paktën 3 vjet më parë nga kandidimi për ngritjen në detyrë.<sup>136</sup>

**Faza 2:** Në qoftë se në përfundim të fazës së parë të shqyrtimit dhe renditjes së kandidaturave, ka më shumë se një gjyqtar me pikët më të larta (p.sh. 2 gjyqtarët që renditen të parët kanë pikë të barabarta nga 100 secili) KLGj-ja shqyrton dhe rendit më tej kandidaturat sipas kriterit të përvojës profesionale specifike sipas tabelës që vijon:

**Tabela 9**

<i>Emri</i>	<i>Pikët pas fazës së parë të vlerësimit</i>	<i>Kohëzgjatja (në vite) e përvojës profesionale specifike</i>
<i>Kandidati 1</i>	<i>P.sh. 100</i>	<i>P.sh. 7 vjet</i>
<i>Kandidati 2</i>	<i>P.sh. 100</i>	<i>P.sh. 5 vjet<sup>137</sup></i>

Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave dhe renditjes së tyre sipas kriterit të përvojës profesionale specifike (shih tabelën nr 9 më lart) KLGj-ja ngre në detyrë gjyqtarin që ka marrë numrin më të madh të pikëve (në këtë rast kandidatin 1 që ka përvojë specifike profesionale më të madhe).

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin e kriterit të përvojës profesionale specifike dhe për saktësinë e pikëzimit të kandidatëve nga KLGj-ja.

136. Shënim i rëndësishëm: Kushtet dhe kriteret e përmendura në këtë Metodologji (dhe të parashikuara nga ligji) për promovimin e gjyqtarëve vlejnjë vetëm për ato raste kur pozicionet vakante plotësohen përmes procedurës së lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë. Ky është skenari standard i plotësimit të vendeve vakante në gjykatat e apelit. Ky skenar nuk zbatohet në rastet e parashikuara nga Neni 42/3 i ligjit “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”. Në fakt, ky nen parashikon rastet e jashtëzakonshme kur vendet vakante në gjykatat e apelit plotësohen jo përmes procedurës së zakonshme (lëvizje paralele ose ngritje në detyrë), por për shkak se magjistratët që kanë të drejtën (ligjore) për t’u caktuar në një pozicion apeli (p.sh., një ish Prokuror i Përgjithshëm të cilit i ka mbaruar mandati, ose një ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë të cilit i ka mbaruar mandati caktohet në një pozicion në një gjykatë apeli me përparësi dhe pa konkurrim) ose kur vendi i punës së një gjyqtari të apelit suprimohet për shkak të mbylljes të gjykatës së apelit ku ai punonte. Vetëm në ato raste kur nuk ka kandidatë të tillë (prioritarë) zbatohen kushtet dhe kriteret e promovimit të parashikuara nga kjo Metodologji.

137.

**Faza 3:** Në qoftë se në përfundim të fazës së dytë të shqyrtimit dhe renditjes së kandidaturave, ka më shumë se një gjyqtar me pikët më të larta (p.sh. 2 gjyqtarët që renditen të parët kanë pikë të barabarta nga 120 secili) KLGj-ja shqyrton dhe rendit më tej kandidaturat sipas kriterit të vjetërsisë si magjistrat sipas tabelës që vijon:

**Tabela 10**

<i>Emri</i>	<i>Pikët pas fazës së dytë të vlerësimit</i>	<i>Vjetërsia (në vite) si magjistrat</i>
<i>Kandidati 1</i>	<i>P.sh. 120</i>	<i>P.sh. 20 vjet</i>
<i>Kandidati 2</i>	<i>P.sh. 120</i>	<i>P.sh. 15 vjet</i>

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi zhvillimi i karrierës si gjyqtar. Kandidati me karrierë më të zhvilluar, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave dhe renditjes së tyre sipas kriterit të vjetërsisë si magjistrat KLGj-ja ngre në detyrë gjyqtarin që ka (a) vjetërsinë më të madhe si magjistrati; në rast të vjetërsisë së barabartë, (b) gjyqtarin që ka karrierë më të zhvilluar; dhe në rast të karrierës së zhvilluar të barabartë, (c) gjyqtarin me vjetërsinë më të madhe si jurist.

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin e kriterit të vjetërsisë si magjistrat dhe për saktësinë e vlerësimit të kandidatëve nga KLGj-ja.

**TË DHËNA SHITESË:** Përveç monitorimit të të dhënave të treguara në tabelat nr. 7, 8 dhe 9, objekti i monitorimit për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në pozicione në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm do të përfshijë edhe aspektet e mëposhtme:

- Respektimi i radhës së përparësisë të kandidatëve të caktuar nga ligji (Neni 42/3 i ligjit Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve);
- Renditja e kandidatit në çdo pozicion që ai ka kandiduar dhe arsyet e diferencës në renditje, nëse ka<sup>138</sup>;
- Arsyet e diferencimit të kandidatëve, të cilët kanë rezultuar me pikë të barabarta, duke përfshirë edhe ndryshime të fundit të akteve nënligjore të Këshillit, nëse ka pasur ndryshime.

138. Në bazë të nenit 48/6 të ligjit Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira. Në këtë rast kandidati bën renditjen e tyre sipas preferencës.

### **ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurën ligjore**

1. Janë shpallur vakancat çdo tre muaj gjatë periudhës së monitorimit. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*
2. Sa vakanca janë shpallur për të gjithë periudhën e monitorimit? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*
3. Janë publikuar shpalljet në faqen zyrtare të Internetit të KLGj-së. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*
4. Janë publikuar shpalljet sipas kërkesave ligjore. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*
5. A ka respektuar shpallja afatin 2-javor, nga momenti i publikimit deri në momentin e mbylljes së afateve të aplikimit? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*
6. Numri i kandidimeve është i barabartë apo më i madh se numri i vakancave të shpallura? *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
7. KLGj-ja ka dërguar kërkesat për informacion brenda afatit 1-javor nga momenti i mbylljes së aplikimeve për ngritje në detyrë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
8. KLGj-ja ka verifikuar plotësimin e kushteve dhe ka shpallur listën e kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm. *Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së.*

## MODULI III

### INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI VLERËSIMIN DHE RENDITJEN E GJYQTARËVE QË KANDIDOJNË PËR NGRITJE NË DETYRË NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV

#### ***A) Procedura e vlerësimit dhe renditjes së gjyqtarëve në pozicionet në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe asaj administrative***

Për gjyqtarët që kanë kaluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, KLGj-ja merr vendimin e kualifikimit. Më pas KLGj-ja vijon me procedurën e renditjes së gjyqtarëve sipas një shkalle të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

#### **a) Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit**

KL Gj-ja, jo më vonë se 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një gjyqtari, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, KLGj-ja mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.<sup>139</sup>

Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, KLGj-ja mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, në një ose disa procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i KLGj-së, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75, të ligjit për qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i KLGj-së, që më herët ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar në një procedurë verifikimi të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për një nga gjyqtarët që konkurron për pozicionin e lirë për të cilin zhvillohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, nuk mund të marrë pjesë në këtë

---

139. Pika 24 e Vendimit të KLGj-së, nr.70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”

procedurë në rast se konflikti i interesit ose pengesa ligjore për shkak të të cilit ai ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar, vijon të ekzistojë.

Për dorëheqjen e çdo anëtari të KLGj-së vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i KLGj-së, vendimi merret nga zëvendëskryetari i tij.<sup>140</sup>

Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i KLGj-së, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatitin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të KLGj-së.<sup>141</sup>

Kur në një gjykatë, për të njëjtën fushë të së drejtës, ka më shumë se një pozicion të lirë, KLGj-ja kryen vetëm një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë.<sup>142</sup>

## **b) Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit**

Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë zhvillohet paralelisht me procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit për gjyqtarët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë, të cilët kanë qenë të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tyre etik dhe profesional.<sup>143</sup>

Vetëm gjyqtarët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.<sup>144</sup>

Relatori kujdeset për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së gjyqtarëve për ngritjen në detyrë dhe në veçanti, për:

- a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të gjyqtarëve, që gjenden në dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes;
- b) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e veprimeve të kryera dhe të dokumenteve të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për renditjen e gjyqtarëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;
- c) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim;
- ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

140. Po aty, pikat 25-28.

141. Po aty, pikat 48 dhe 49.

142. Po aty, pika 29.

143. Po aty, pika 45.

144. Po aty, pika 46.



- d) koordinimin me Kryetarin e KLGj-së për përgatitjen e mbledhjes plenare të KLGj-së;
- dh) njoftimet për gjyqtarët.<sup>145</sup>

Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale, relatori i çështjes vlerëson se ka mangësi, njofton menjëherë gjyqtarin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë, për të dhënë sqarime ose për të plotësuar mangësitë. Mungesa e përgjigjes së gjyqtarit nuk pengon vijimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.<sup>146</sup>

Kur është rasti, relatori mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, sqarime, të dhëna ose kopje të dokumenteve të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.<sup>147</sup>

Në përfundim të veprimeve për të gjithë gjyqtarët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e gjyqtarëve.<sup>148</sup>

### **c) Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim**

Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke marrë masa për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes.

Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve.

Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe dokumentacioni përkatës i gjyqtarëve është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e procedurës apo të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet procedurale dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësisimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.<sup>149</sup>

### **ç) Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së gjyqtarëve**

#### **Të përgjithshme**

Renditja e gjyqtarëve bëhet me qëllim përzgjedhjen e gjyqtarit më të mirë për pozicionin e lirë. Për renditjen e gjyqtarëve ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura

145. Po aty, pika 47.

146. Po aty, pika 50.

147. Po aty, pika 51.

148. Po aty, pika 52.

149. Po aty, pikat 53-55.

në nenin 48 § 9, të ligjit për statusin.

Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e gjyqtarëve me rezultate të njëjta më të larta. Hapi i dytë i renditjes ndiqet vetëm kur për pozicionin e lirë kërkohet përvojë profesionale specifike.<sup>150</sup>

### **Hapi i parë, kriteret dhe përparësitë e renditjes së gjyqtarëve**

Renditja e gjyqtarëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etik dhe profesionale. Gjyqtari me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.

Në rastin e gjyqtarit të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, niveli i vlerësimit etik dhe profesional nga ky institucion, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të këtij vendimi, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast nivelet e vlerësimit sipas ligjit të posaçëm të institucionit të sistemit të drejtësisë dhe nivelet e vlerësimit sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Në rastin kur gjyqtarit të komanduar nuk i është bërë vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë, atëherë ai vlerësohet për aftësitë profesionale si gjyqtari jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit të statusit dhe vendimeve të KLGj-së të Lartë Gjyqësor, vendimit nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, të pikëzimit dhe të renditjes së gjyqtarëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe vendimit nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e gjyqtarëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”. Në këtë rast, nivelet e vlerësimit sipas pikëve janë si më poshtë:

<b>Niveli i vlerësimit</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	90-100
Shumë mirë	70-89
Mirë	50-69
Mjaftueshëm	30-49
I pamjaftueshëm	1-29

Në rast se ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, për renditjen e gjyqtarëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

- a) “niveli i vlerësimit të fundit” - sipas kësaj përparësie, gjyqtari me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;
- b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i KLGj-së” - sipas kësaj përparësie, gjyqtari që ka një nga këto përvoja, renditet më lart.

150. Po aty, pikat 9-11.

- c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i KLGj-së” - sipas kësaj përparësie, gjyqtari me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;
- ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i KLGj-së” - sipas kësaj përparësie, gjyqtari që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart;

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive nga më sipër ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, renditja e gjyqtarëve me rezultatet më të larta bazohet në skemën e pikëve të miratuar nga KLGj-ja me:

- a) vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; ose
- b) vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së gjyqtarëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e gjyqtarëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

Në rastin e një gjyqtari me rezultate më të larta, për të cilin zbatohet skema e pikëve sipas vendimit nr. 102/2019, pikët sipas kësaj skeme konvertohen në raportin një me katër me ato të skemës sipas vendimit nr. 263/2019

Sipas kriterit të renditjes të parashikuar më sipër, të këtij vendimi, gjyqtari me totalin më të lartë të pikëve në dy vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale, renditet më lart.<sup>151</sup>

### **Hapi i dytë, kriteri dhe përparësitë e renditjes së gjyqtarëve**

Në rast se pas vlerësimit të bërë më sipër, ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, renditja e gjyqtarëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë. Gjyqtari që ka përvojë profesionale specifike, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, për renditjen e gjyqtarëve me rezultatet më të larta merr përparësi kohëzgjatja e përvojës profesionale specifike. Gjyqtari me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart.<sup>152</sup>

### **Hapi i tretë, kriteret dhe përparësitë e renditjes së gjyqtarëve**

Në rast se pas vlerësimit të bërë më sipër ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, renditja e gjyqtarëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Gjyqtari me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

151. Po aty, pikat 12-18.

152. Po aty, pikat 19-20.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, për renditjen e gjyqtarëve me rezultatet më të larta merr përparësi zhvillimi i karrierës si gjyqtar. Gjyqtari me karrierë më të zhvilluar, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një gjyqtar me rezultate të njëjta, renditja e gjyqtarëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si jurist. Gjyqtari me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.<sup>153</sup>

#### **d) Shqyrtimi dhe miratimi nga KLGj-ja i projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim**

Kryetari i KLGj-së, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e KLGj-së, duke iu dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.

Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së KLGj-së, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, iu njoftohet gjyqtarëve.

Në mbledhjen e KLGj-së, kryetari i KLGj-së fton relatorin të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve për atë pozicion të lirë.

Në përfundim të parashtrimeve të relatorit, nëse vlerësojnë, anëtarët e KLGj-së mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

Më pas KLGj-ja kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) plotësinë e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori dhe plotësinë e dokumentacionit të nevojshëm për renditjen e gjyqtarëve;
- b) miratimin e projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime sipas propozimeve të çdo anëtari.

Nëse gjatë bisedimeve KLGj-ja vlerëson dhe vendos që veprimet procedurale të kryera nga relatori dhe/ose dokumentacioni i nevojshëm për renditjen e gjyqtarëve nuk është i plotë, atëherë nuk vijon me bisedimin e projektvendimit të renditjes së gjyqtarëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim, por cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, KLGj-ja ngarkon relatorin të marrë masa për plotësimin sa më parë të mangësive të evidentuara. Në seancën e radhës, që caktohet jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i relatorit, ky i fundit paraqet para KLGj-së aktet shtesë. Në këtë rast, KLGj-ja vijon bisedimet dhe vendos për çështjet e renditura në pikën 60 të këtij vendimi.

Në përfundim të bisedimeve, KLGj-ja voton projektvendimin e renditjes së gjyqtarëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim. Anëtarët votojnë në të njëjtën kohë. Në përfundim të votimit, kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të

---

153. Po aty, pikat 21-23.

barabartë, vota e kryetarit të KLGj-së është përcaktuese.<sup>154</sup>

#### **dh) Vendimi për renditjen e gjyqtarëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërimin**

Vendimi i KLGj-së për renditjen e gjyqtarëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim arsyetohen nga relatori, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtarëve të KLGj-së. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KLGj-së që kanë marrë pjesë në votim. Vendimi i arsyetuar i KLGj-së iu njoftohet gjyqtarëve.<sup>155</sup>

#### **e) Vendimi për ngritjen në detyrë**

Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e gjyqtarëve në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori i asaj procedure, KLGj-ja merr vendim për ngritjen në detyrë në atë pozicion të lirë të gjyqtarit të renditur më lart. Në rastin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një gjykatë, për më shumë se një pozicion të lirë në të njëjtën fushë të së drejtës, KLGj-ja merr vendim për ngritjen në detyrë në ato pozicione të lira të gjyqtarëve të renditur më lart.

Vendimi i KLGj-së për ngritjen në detyrë i njoftohet gjyqtarit të ngritur në detyrë, gjykatave respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të KLGj-së.<sup>156</sup>

### ***B) Objektivat e monitorimit në lidhje me kushtet procedurale***

#### **a) Metoda e mbledhjes së të dhënave për renditjen e kandidatëve**

Në paragrafët që vijojnë, në Metodologji do të përcaktohet metoda konkrete që do të përdoret nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse KLGj-ja ka zbatuar kriteret e parashikuara nga ligji për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për pozicione në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Në vijim, lënda është organizuar në përputhje me tri fazat e shqyrtimit dhe të renditjes së kandidatëve, siç tregohet në tabelat 8, 9 dhe 10 të kësaj Metodologjie.

#### **Faza I – KLGj-ja shqyrton dhe rendit kandidaturat sipas kriterëve të përparësisë të sipërpërmendur**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Përparësia e parë** (*rezultatet e dy vlerësimeve të fundit të kandidatëve*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;

154. Po aty, ff. 56-62.

155. Po aty, pikat 63-64.

156. Po aty, ff. 68-69.

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Përparësia e dytë** (*rezultatet e vlerësimit të fundit të kandidatëve*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Përparësia e tretë** (*gjqytari ka përvojë në pozicione të komanduara, në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Përparësia e katërt** (*kohëzgjatja e periudhës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Përparësia e pestë** (*shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Përparësia e gjashtë** (*pikëzimi që ka marrë gjyqtari me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

## **Faza II – KLGj-ja shqyrton dhe rendit kandidaturat sipas kriterit të përvojës profesionale specifike (treguar në tabelën 9)**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 2, Kriteri 1** (*rezultatet e kandidatëve pas përfundimit të fazës së parë janë të barabarta*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 2, Kriteri 2** (*kohëzgjatja në vite e përvojës profesionale specifike*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

## **Faza III – KLGj-ja shqyrton dhe rendit kandidaturat sipas kriterit të përvojës vjetërsisë si gjyqtar**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 3, Kriteri 1** (*rezultatet e kandidatëve pas përfundimit të fazës së dytë janë të barabarta*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 3, Kriteri 2** (*vjetërsia si gjyqtar*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 3, Kriteri 3** (*zhvillimi i karrierës si gjyqtar*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 3, Kriteri 4** (*vjetërsia si jurist*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

## **b) Metoda për mbledhjen e të dhënave shtesë**

Metodat e përdorura nga monitoruesi për mbledhjen e të dhënave shtesë (shih më lart) do të përfshijnë:

- Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së;
- Informacion zyrtar nga KLGj-ja;
- Intervista eventuale me gjyqtarët që kandidojnë.

## **c) Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurën e renditjes së kandidatëve.**

1. Ka pasur pozicione të lira që janë mbyllur që me përdorimin e kritereve të fazës I, përparësisë së parë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
2. Ka pasur pozicione të lira që janë mbyllur që me përdorimin e kritereve të fazës I, përparësisë së dytë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
3. Ka pasur pozicione të lira që janë mbyllur që me përdorimin e kritereve të fazës I, përparësisë së tretë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
4. Ka pasur pozicione të lira që janë mbyllur që me përdorimin e kritereve të fazës I, përparësisë së katërt. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
5. Ka pasur pozicione të lira që janë mbyllur që me përdorimin e kritereve të fazës I, përparësisë së pestë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
6. Ka pasur pozicione të lira që janë mbyllur që me përdorimin e kritereve të fazës I, përparësisë së gjashtë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
7. Ka pasur kandidatë që në fazën I kanë qenë me pikë të barabarta. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
8. Si janë vlerësuar kandidatët bazuar në vitet e përvojës profesionale specifike? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
9. Ka pasur kandidatë që në fazën III kanë qenë me pikë të barabarta. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*
10. Si janë vlerësuar kandidatët bazuar në vjetërsinë e tyre si gjyqtar? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së.*



## MODULI IV

# INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT PËR PROCEDURAT ANKIMORE PËR RASTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË GJYKATAT E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE ASAJ TË APELIT ADMINISTRATIV

### A) Ankimi gjyqësor

Në fazat e ndryshme të shqyrtimit të procedurës së ngritjes në detyrë, gjyqtari që mendon se është penalizuar nga vendimmarrja e KLGj-së, ka të drejtë që të ankohet gjyqësisht.

Faza ankimore mund të jetë e ndryshme. Kështu nëse gjyqtari është skualifikuar nga KLGj-ja për shkak se nuk e ka kaluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe/apo të figurës, në bazë të nenit 100 § 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka të drejtë që të ankohet në Gjykatën Administrative të Apelit e cila ka juridiksion fillestar.

Në këtë rast gjen zbatim parashikimi i nenit 32 § 6 të ligjit nr. 96/2016, titulluar, “Verifikimi i pasurisë dhe figurës”, e cila parashikon procedurën që ndjek KLGj-ja dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimmarrje së saj. Me ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.05.2021, neni 32 ka ndryshuar në pikën 6 të tij me formulimin se “Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. **Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë.**”

Pra, në këtë rast, krahas qenies së vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit të formës së prerë, ligjvënësi ka përcaktuar që është dhe përfundimtar. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, më së tepërmi, përafron me një vendim me forcë ekzekutive se sa me një vendim, i cili ka fituar statusin e gjësë së gjykuar. Një vendim gjyqësor i formës së prerë, në çdo rast, është një vendim gjyqësor me fuqi ekzekutive, por jo domosdoshmërisht konsiderohet si një vendim përfundimtar, sepse ligji ka parashikuar formën e prerë të vendimeve të gjykatave të apelit, pavarësisht se ato mund të rekursohen në rrugë të zakonshme ankimi pranë Gjykatës së Lartë, e cila brenda juridiksionit të saj ligjor eventualisht edhe mund të ndryshojë vendimmarrjen, ndonëse tashmë të ekzekutuar. Kjo do të thotë që në këto raste, vendimi

përfundimtar (final) është vendimi i kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë (në rastet kur ushtrohet ankimi) dhe jo vendimi i gjykatës së apelit, i cili është bërë i ekzekutueshëm.

I ndryshëm paraqitet rasti kur një vendim gjyqësor i është dhënë statusi i një vendimi “përfundimtar dhe të formës së prerë”. Sidoqoftë, një vendim gjyqësor është final kur ka natyrën e një vendimi përfundimtar dhe, për rrjedhojë, ka fituar fuqinë e *res judicata*, sipas nenit 451/a të KPC. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar këto mjete ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa ushtruar ankim.

Në praktikën gjyqësore është konsoliduar qëndrimi, se një vendim gjyqësor i formës së prerë është menjëherë i ekzekutueshëm, por jo domosdoshmërisht ka efektet e gjësë së gjykuar (*res judicata*). Përkundrazi, në rastet kur një vendim gjyqësor është “i formës së prerë” dhe i shtohet gjithashtu edhe termi “përfundimtar”, kjo do të thotë se ky vendim, jo vetëm është menjëherë i ekzekutueshëm, por se ndaj tij nuk ka asnjë mjet të zakonshëm ankimi, për arsye se natyra e tij finale/përfundimtare pengon gjykimin nga një gjykatë më e lartë, përveç rishikimit të vendimit. Pikërisht, natyra tepër e veçantë e çështjeve apo rasteve, për të cilat ligjvënësi ka parashikuar se “vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë”, është në funksion të shmangies së gjendjes së pasigurisë, e cila nuk mund të vijojë pafundësisht.

Kjo qasje e ligjvënësit lidhet edhe me faktin se veprimtaria administrative e ushtruar nga KLGJ është *quasi gjyqësore* dhe ankimi i ushtruar në juridiksion fillestar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda shkaqeve strikte ligjore, si edhe afateve tepër të shkurtra, përmbillet me një vendim final dhe të paankimueshëm në rrugë të zakonshme ankimi gjyqësor. Për rrjedhojë kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, në këto raste nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.<sup>157</sup>

Afati ankimor në këtë lloj gjykimi është 5-ditor. Pra brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të KLGJ-së, gjyqtari që është skualifikuar për moskalimin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës, nëse nuk është dakord duhet të paraqesë padi në Gjykatën Administrative të Apelit. Afati 5-ditor për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit të këshillit për caktimin në pozicion sipas nenit 39 dhe 40 mungonte në variantin e parë të ligjit nr. 96/2016 dhe u shtua me ligjin nr. 48/2019, i cili e plotësoi dhe e ndryshoi atë si pasojë e vendimmarrjes së GjK-së, që shfuqizoi disa dispozita të ligjit nr. 96/2016. Afatet e njëjta të vendosura si për shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe për rishikimin e vendimit nga këshilli kur ankimi pranohet nga gjykata, premtojnë për një proces të shpejtë dhe të efektshëm. Ky afat fillon nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës.<sup>158</sup>

Rregullat procedurale që ndjek Gjykata Administrative e Apelit në këtë rast, janë të njëjta me gjykimin administrativ në shkallë të parë, por çështja shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Ajo që duhet theksuar është se gjyqtari mund të paraqesë prova

157. Vendimi nr. 00 – 2022 – 656, datë 11.04.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

158. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 41 – Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/41>

të tjera edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht se nuk i ka paraqitur ato më parë gjatë procedurës administrative në KLGj. Kjo do të thotë që e drejta e gjyqtarit për të paraqitur prova dokumentare në favorin e tij nuk bien në dekadencë nëse nuk i paraqet gjatë shqyrtimit administrativ. Kjo qasje lidhet me argumentin se vetë KLGj-ja do të duhej të bënte një hetim administrativ më të thelluar dhe të kërkonte vetë nga institucionet publike dhe private çdo informacion të domosdoshëm, me qëllim sqarimin përfundimtar të të gjithë problematikave për të cilat kishte dyshime.<sup>159</sup> Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit.

Në rastin kur gjyqtari që kandidon nuk është dakord me vlerësimin e tij të performancës si gjyqtar, Ligji nr. 96/2016, në nenin 95, pika 7 të tij parashikon se *Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit, në gjykatën kompetente, brenda 15-ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.*

Pra, gjyqtari që nuk është dakord me vlerësimin e tij, nuk ka të drejtë që të ankohet për thelbin e vlerësimit, por vetëm nëse në procesin e vlerësimit që ka bërë KLGj-ja ka pasur shkelje procedurale.

Ky kufizim i kësaj të drejte lidhet me faktin se neni 147/a i Kushtetutës nuk përmban rregullim ose delegim të shprehur për ligjëvendimin lidhur me ushtrimin e kompetencave që ushtron KLGj-ja për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve. Kushtetuta e përcakton vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve si kompetencë ekskluzive të KLGj-së, duke mos e deleguar atë tek asnjë organ tjetër, qoftë edhe ai gjyqësor.

Referuar bazës kushtetuese dhe ligjore, rezultojnë se KLGj-ja përmbush të gjitha kërkesat që të klasifikohet si një organ *quasi gjyqësor*. Sipas nenit 147 § 2, të Kushtetutës, KLGj-ja përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor, ndërsa 5 i zgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, anëtari i KLGj-së ka statusin e magjistratit, sipas rregullave të parashikuara nga ligji nr. 96/2016 dhe gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Të gjithë anëtarët e KLGj-së u nënshtrohen kritereve të përzgjedhjes, të përcaktuara në mënyrë të hollësishme në ligjin nr. 115/2016.

Pra, KLGj-ja është organ i parashikuar nga Kushtetuta, që synon të sigurojë pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, ndërkohë që në nenin 147/a të saj, janë përcaktuar kompetencat e këtij organi.

Në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këtyre organeve, sipas Kushtetutës anëtarët e KLGj-së e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhje.<sup>160</sup> Në nenet 147/b dhe 147/c të Kushtetutës parashikohen rastet e mbarimit të mandatit të anëtarit të KLGj-së dhe ato të përgjegjësisë disiplinore. Më konkretisht, sipas nenit 147/c të Kushtetutës, anëtarët e KLGj-së shkarkohen nga detyra, në rast të kryerjes së shkeljeve të rënda disiplinore, me vendim të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa në periudhën tranzitore kjo

159. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 06.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

160. Neni 147 § 10 e Kushtetutës.

është kompetencë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.<sup>161</sup>

Për rrjedhojë, duke pasur në konsideratë kriteret e emërimit të anëtarëve të KLGj-së, parashikimin e shkaqeve të shkarkimit dhe përcaktimin e procedurës së shkarkimit në Kushtetutë dhe në ligj, si dhe garancitë objektive në ushtrimin e veprimtarisë së tyre me pavarësi të plotë, përforcojnë sigurinë e palëvizshmërisë së tyre gjatë mandatit 5-vjeçar. Pra, qartazi KLGj-ja plotëson standardet e pavarësisë për të ushtruar këtë kompetencë, atë të vlerësimit të gjyqtarëve.

Sa më lart, parimet nga të cilat udhëhiqet procesi i vlerësimit të gjyqtarit, zhvillimi i procedurës së vlerësimit dhe garancitë e hollësishme që i njihen gjyqtarit gjatë kësaj procedure, si mundësia që të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe të mbrohet në respektim të parimit të barazisë së mjeteve dhe kontradiktoritetit, dhe në përfundim të kësaj procedure të ketë të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar, ofrojnë garancitë e nevojshme që kërkon drejta për proces të rregullt ligjor.

Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme se vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarëve në aspektin substancial është parashikuar nga Kushtetuta në nenin 147/a si kompetencë ekskluzive e KLGj-së dhe se ky organ si *quasi gjyqësor* gjatë këtij procesi ndjek një procedurë *quasi gjyqësore*, rezulton se ushtrimi i kontrollit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve nga gjykata e apelit administrativ vetëm për shkelje të rënda procedurale, është një kufizim i arsyeshëm dhe nuk bie ndesh me dispozitat kushtetuese.<sup>162</sup>

Për sa i përket renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë, në pozicionin e Kryetarit të Gjykatës, Ligji nr. 96/2016, në nenin 48 § 10, fjalia e dytë të saj parashikon se: *Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.*

Norma në nenin 41 të ligjit nr. 96/2016 është përcaktuar si "*Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit*" (ndryshuar në vitin 2019). Pika e dytë e në vijim e dispozitës së mësipërme përcakton se, i emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë. Vendimi i Këshillit për caktimin e të emëruarit në pozicion, në përputhje me këtë nen, merr formë të prerë kur: a) nuk është depozituar ankimi brenda afateve të ankimit; b) është depozituar ankimi sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ose rrëzimin e ankimit; c) është depozituar ankimi sipas afateve dhe mbi bazën e tij është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruarit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.<sup>163</sup>

Në thelb neni 41, pika 2 dhe 3 i ligjit nr. 96/2016, është një dispozitë "kuadër" që zbatohet për emërimin e gjyqtarëve, procedurat e ngritjes në detyrë, lëvizjeve paralele, si dhe në raste të

161. Neni 179 § 7 e Kushtetutës.

162. Vendimi nr. 133 datë 22.11.2021 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

163. Ligji nr. 96/2016, neni 41, pikat 2-4.

tjera të parashikuara shprehimisht prej ligjit.

E drejta e ankimit, si pjesë esenciale e një procesi të rregullt ligjor duhet të jetë sanksionuar në mënyrë të shprehur në ligj. Në nenin 41, pika 2-4 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet vetëm se vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë dhe jo se është një vendim i formës së prerë dhe i paankimueshëm/i parekursueshëm dhe/ose përfundimtar. Në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile (neni 451 dhe 451/a), si edhe me praktikën e Kolegjit Administrativ, kuptimi i përdorimit në ligj të togfjalëshit “formë e prerë” nuk mund të barazohet me vendimin përfundimtar/të parekursueshëm, për sa kohë kufizimi i rekursit nuk rezulton i shprehur qartë në ligj. Nuk mund të interpretohet në mënyrë teologjike dhe pa ekuivok se ligjvënësi ka pasur për qëllim kufizimin e të drejtës së ankimit (rekursit); për rrjedhojë aksesit në juridiksionin e Gjykatës së Lartë për këtë kategori vendimmarrjesh nuk mund të ndalohej. Një interpretim i kundërt i dispozitës, do të kufizonte në mënyrë joproportionale dhe të pacaktuar me ligj të drejtën e rekursit, mbi një mori vendimmarrjesh të tjera që lidhen me statusin e gjyqtarit.<sup>164</sup>

Pra, ndryshe nga rastet e kontrollit të pasurisë dhe të figurës, ku vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe përfundimtar, që do të thotë që nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, në rastin e renditjes së gjyqtarëve, kandidatë për ngritje në detyrë, lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë.

Megjithatë në rast ankimimi duhet theksuar se gjyqtari që kandidon për t’u ngritur në detyrë ka të drejtën të ankohet vetëm për vlerësimin dhe renditjen e tij dhe jo të gjyqtarëve të tjerë që kandidojnë në të njëjtën procedurë.

Kjo do të thotë që për vendimet e KLGj-së ku disponohet s’kualifikimi i kandidatit për plotësimin e pozicionit të lirë në një gjykatë apeli, legjitimohet të ankohet dhe të ngrëjë padi në gjykatë vetëm gjyqtari ndaj të cilit KLGj-ja ka dhënë vendimin për s’kualifikimin nga procedura e ngritjes në detyrë. Pra, kandidatët e tjerë në konkurrim, për plotësimin e të njëjtit pozicion të lirë, si në fazën e verifikimit të kandidaturave, ashtu edhe në atë të vlerësimit finalizuar me vendimin për renditjen e kandidatëve të kualifikuar dhe vlerësuar, nuk legjitimohen të ankohen në gjykatë për vendimet e kualifikimit apo të s’kualifikimit të kandidatëve të tjerë, apo t’i kërkojnë gjykatës që edhe në procesin e gjykimit të padisë për kundërshtimin e renditjes së kandidatëve, të konstatojë pavlefshmëri të vendimeve për kualifikimin e kandidatëve të tjerë. Padia për kundërshtimin e vendimit të renditjes dhe propozimit të emërimit të njërit prej kandidatëve (i renditur i pari), mund të motivohet si për shkaqe të lidhura me zbatimin e së drejtës procedurale, ashtu edhe materiale.

Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, KLGj, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim, bëhen publik në faqen zyrtare të internetit të KLGj-së.<sup>165</sup>

164. Vendimi nr. 00-2022-2178, datë 06.10.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

165. Pikat 66 dhe 67 të Vendimit të KLGj-së nr.70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

## **B) Monitorimi i indikatorëve të shqyrtimit të ankimeve gjyqësore**

1. Sa ankime janë paraqitur në GjAA, kundër vendimeve të KLGj-së për periudhën e monitorimit? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*
2. I ka shqyrtuar GjAA-ja, ankimet brenda periudhës 2-javore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*
3. Sa prej vendimeve të KLGj-së janë lënë në fuqi, apo janë shfuqizuar nga GjAA-ja? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*
4. Si ka vepruar KLGj-ja për zbatimin e vendimeve të GjAA-së? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*
5. Vendimet e KLGj-së për zbatimin e vendimeve të GjAA-së, janë ankimuar përsëri në gjykatë. *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*
6. Si ka vendosur GjAA-ja në rastin e kundërshtimit për së dyti të vendimeve të KLGj-së? *Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së.*



## RASTE STUDIMORE

### *Rasti I*

Gjyqtari Gj.B. është magistrat dhe ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, që prej muajit dhjetor të vitit 2009.

Më datë 26.02.2023, KLGj-ja ka marrë vendimet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 dhe nr. 7, për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Më konkretisht, KLGj-ja ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve, respektivisht për tri pozicione të lira në fushën e së drejtës civile (vendimet nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4) dhe për tri pozicione në fushën e së drejtës administrative (vendimet nr. 6, nr. 6 dhe nr. 7)

Për procedurat e mësipërme të ngritjes në detyrë, KLGj-ja ka njoftuar edhe afatet përkatëse të kandidimit nga momenti i publikimit të vendimeve në faqen zyrtare. Vendimet e mësipërme janë shpallur në faqen zyrtare të KLGj-së më datë 28.02.2023.

Brenda afateve të përcaktuara nga KLGj-ja, më datë 09.03.2023, gjyqtari Gj.B. ka paraqitur dy kërkesa, përmes të cilave ka shprehur interesin për të kandiduar për ngritjen në detyrë si në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu edhe në Gjykatën administrative të Apelit, duke u shprehur se renditjen e tyre e bën sipas renditjes së shqyrtimit që bën KLGj-ja.

Më datë 06.05.2023 KLGj-ja ka filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve për pozicionet e lira të shpallura më datë 26.02.2020, me vendimet nr. 2 (për fushën e së drejtës civile) dhe nr. 5 (për fushën e së drejtës administrative), ku rezulton të jetë përfshirë edhe kandidati, Gj.B.. KLGj-ja ka vlerësuar se edhe në kushtet kur ky kandidat nuk ka përcaktuar procedurat e ngritjes në detyrë, sipas numrave përkatëse të vendimeve, ku do të kandidojë, kërkesat e tij rezultojnë të jenë paraqitur brenda afatit të kandidimit për dy pozicionet e para të lira për dy fushat respektive të së drejtës, të evidentuara më sipër.

Në vijim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pranë KLGj-së ka vlerësuar të sqarojë se për cilin pozicion të tretë të lirë do të kandidonte Gj.B., referuar pikës 6 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Si rrjedhojë, kandidati u ftua përmes e-mailit të datës 11.05.2023 të jepte shpjegimet e nevojshme për konkretizimin e pozicioneve ku do të kandidonte.

Me e-mailin e datës 12.05.2023, gjyqtari, Gj.B., ka kthyer përgjigje se ka kandiduar për ngritjen



në detyrë, për një pozicion në gjykatat e apelit, në kuptim të nenit 47 të Ligjit nr. 96/2016. Sipas sqarimeve të kandidatit, me termin “*pozicion*”, për efekt të kufizimit të kandidimit, në procedurën e ngritjes në detyrë, nuk do të nënkuptohen vendet vakante brenda të njëjtës gjykatës, por do të nënkuptohen pozicionet e lira në gjykata të ndryshme apo në shkallë të ndryshme të sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër, sipas tij, nuk mund të konsiderohet si pozicion i ndryshëm, “*fusha e një të drejte*” e të njëjtës gjykatë. Në këtë rast, kandidimi mbetet një, për secilën procedurë të ngritjes në detyrë në një nga gjykatat e apelit dhe pozicioni është një. Në këtë rast, sipas tij, nuk zbatohet kufizimi i parashikuar në nenin 48/6 të Ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit kandidati mund të kandidojë, për jo më shumë se tri pozicione të lira.

Në vijim, kandidati, Gj.B., më datë 18.05.2023 ka depozituar pranë KLGj-së edhe 4 kërkesa, përmes të cilave ka shprehur interesin për ngritjen në detyrë, duke identifikuar edhe pozicionet e lira, sipas numrave të vendimeve të KLGj-së për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë për këto pozicione, konkretisht sipas vendimeve nr. 3, nr. 4, nr. 6 dhe nr. 7, datë 26.02.2023.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, më datë 26.05.2023, KLGj-ja ka vijuar me procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, për pozicionet e lira të shpallura me datë 26.02.2020, me vendimet nr. 3 dhe nr. 6. Më datë 04.06.2023, KLGj-ja ka vendosur të ftojë sërish kandidatin, Gj.B., për të përcaktuar pozicionin e tretë të lirë për të cilin kandidonte; pra njërin nga katër pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 3, nr. 4, nr. 6 dhe nr. 7, datë 26.02.2023.

Me e-mailin e datës 05.06.2020, Gj.B. ka kthyer të njëjtën përgjigje, sikurse ajo me e-mailin e datës 12.05.2020.

Pas këtij komunikimi, **Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 1/4, datë 11.06.2023** ka vendosur:

*“Mospërfshirjen e aplikuesit, Gj.B. në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 4, nr. 6 dhe nr. 7, datë 26.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tri pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.”*

Në marrjen e këtij vendimi, KLGj-ja ka arsyetuar se neni 48 § 6 i Ligjit nr. 96/2016, në mënyrë të qartë, kufizon të drejtën e kandidimit për ngritjen në detyrë, deri në tri pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira, qofshin këto pozicione në të njëjtën gjykatë apo edhe në të njëjtën fushë të së drejtës. Kjo dispozitë ka parashikuar se pozicionet e lira, plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, ndërkohë që për çdo pozicion të lirë organizohet një procedurë ngritjeje në detyrë, e cila finalizohet me zgjedhjen e kandidatit të renditur më lart për shkak të pikëzimit. Pra, ligji përcakton qartësisht organizimin e një procedure të pavarur ngritjeje në detyrë për çdo pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.

KLGj-ja ka vlerësuar se me termin “*pozicion*”, sipas nenit 47/1 të Ligjit nr. 96/2016, Ligjvënësi ka pasur si qëllim të japë kuptimin e ngritjes në detyrë, por kjo dispozitë nuk nënkupton

se gjykata më e lartë ka vetëm një pozicion apo se të gjitha pozicionet e kësaj gjykate në kuadrin e ngritjes në detyrë, nënkuptojnë një të vetëm. Sipas këtij Ligji, çdo gjyqtar ka pozicionin e tij në sistemin gjyqësor. Nga ana tjetër, ngritja në detyrë e gjyqtarit mund të ndodhë përmes kandidimit jo për çdo pozicion, por vetëm për një pozicion të lirë, për të cilin shpallet procedura përkatëse e ngritjes në detyrë, duke u identifikuar ky pozicion sipas fushës përkatëse të së drejtës së përshtatshme për të.

Sa më sipër, KLGj-ja vlerësoi se në kushtet kur kandidati Gj.B. kishte aplikuar njëherazi për më shumë se tri pozicione të lira dhe në kushtet kur nuk përcaktoi pozicionin e tretë të lirë për të cilin do të kandidonte, atëherë do të konsiderohej si i tillë pozicioni i lirë i hapur i pari në radhë, në raport me kandidimet e mëpasshme; konkretisht ai i shpallur me vendimin nr. 3, datë 26.02.2023.

### **Referuar rastit të mësipërm:**

1. Në sa pozicione ka të drejtë që të kandidojë gjyqtari Gj.B?
2. Ka respektuar KLGJ, kërkesat ligjore në lidhje me afatet e shpalljes dhe të shqyrtimit të kandidaturave, për ngritje në detyrë?

### ***Rasti 2***

Gjyqtarja I.N., pas përfundimit të studimeve në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008 në profilin gjyqtar, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. KLGj-ja ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, duke miratuar vendimin nr. 23, datë 26.01.2023, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe vendimin nr. 24, datë 29.05.2023, për një pozicion të lirë në fushën te drejtës penale.

Gjyqtarja I.N. brenda afateve ka paraqitur kërkesë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e KLGj-së nr. 23, datë 26.01.2023 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e KLGj-së nr. 24, datë 29.05.2023.

KLgj-ja ka nisur procedurën për verifikimin e kritereve ligjore të kandidates dhe me vendimin nr. 68, datë 07.06.2023 ka vendosur: *“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet 26.01.2023 (ne fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet..... nr. 24 datë 29.05.2023 ... nr. 23, datë të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, duke caktuar dhe relatoren ... për kandidaten znj. I.N....”*

Gjyqtarja është njoftuar në rrugë elektronike për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për caktimin e anëtarit relator të kësaj procedure verifikimi, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të KLGj-së, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Pas

përfundimit të procedurës së verifikim paraprak për të tre kriteret formale të kandidimit, me vendimin nr. 69, datë 17.07.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“1. Verifikimin e plotësisë nga kandidatja znj. I.N., në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të lartë Gjyqësor nr. 23, datë 26.01.2023 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 24, date 29.05.2023, të kriterëve të përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 23, datë 26.01.2023 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 24, datë 29.05.2023”.* Ky vendim i është komunikuar paditëses elektronikisht më date 22.07.2023.

Në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve, me vendimin nr. 43, datë 01.08.2023 Komisioni i Pavaruar i Kuaifikimit ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. I.N., si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier”.* Me shkresën e datës 03.08.2023 është njoftuar KLGj-ja për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për paditësen si subjekt rivlerësimi *“ex officio”* sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.*

Me ardhjen në dijeni të kësaj shkrese, KLGj-ja, pasi ka shqyrtuar relacionin përkatës të relatores së çështjes, si dhe materialet e grumbulluara gjatë verifikimit, në datën 24.08.2023, në rrugë elektronike, i ka komunikuar paditëses njoftimin për gjetjen e procedurës së verifikimit në lidhje me një prej kriterëve të kandidimit për emërim/ngritje në detyrën e gjyqtarit, pikërisht atë të pasjes së masës disiplinore në fuqi, duke e njoftuar për të drejtën për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit. Gjyqtarja me datë 01.09.2023, elektronikisht ka dërguar shpjegimet e saj në lidhje me gjetjen e procedurës së verifikimit.

Me vendimin nr. 87, datë 05.09.2023 *“Për skualifikimin e kandidatës znj. I.N. dhe përjashtimin e saj nga procedurat e ngritjes në detyrë”,* KLGj-ja ka vendosur: *“1. Shfuqizimin e vendimit 69, datë 17.07.2023,, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin plotësisë nga kandidatja znj. I.N., të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23 datë 26.01.2023 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 24 datë 29.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”; 2. Skualifikimin e kandidatës znj. I.N. dhe përjashtimin e saj nga procedurat e ngritjes në detyrë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 23, datë 26.01.2023 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 24, datë 29.05.2023...”.*

Vendimi i arsyetuar i është komunikuar elektronikisht paditëses më datë 09.09.2023. Në datë 12.03.2021, gjyqtarja I.N. nëpërmjet shërbimit postar i është drejtuar Gjykatës

Administrative të Apelit me padi, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 87, datë 05.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo padi është regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 16.09.2023. Gjyqtarja I.N. pretendon se:

- Interpretimi i masave disiplinore në tejkalim të parashikimeve kushtetuese nuk është i parashikuar në ligj: Në nenin F, paragrafët 5 dhe 6 të Aneks Kushtetutës “Kolegji i Apelimit” parashikohet se: *“5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 për qind të pagës. Nëse Kolegji pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 për qind e pagës i paguhet subjektit për të gjithë periudhën e ndërprerjes. Vendimi përfundimtar që urdhëron shkarkimin nga detyra, hyn në fuqi menjëherë. 6. Kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji.”* -Pra, sipas përmbajtjes së këtij neni vendimi përfundimtar është ai i Kolegjit të Apelimit, i cili ekzekutohet menjëherë. Në rast se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendos shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, subjekti pezullohet deri në marrjen e vendimit nga Kolegji, në rast se ka paraqitur ankim.

- Në nenin 48/8 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”* parashikon se: *“Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe të figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.”* Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, janë dy kushte kumulative të ndryshme që parashikohen nga ligji, *“kalimi i verifikimit të pasurisë dhe figurës”* si dhe *“mospasja e masës disiplinore në fuqi”*. Pra, neni 48 § 8 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”* nuk barazon moskalimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës me masë disiplinore, pasi dispozita nuk do të kishte nevojë për të parashikuar të njëjtin shkak dy herë.

### **Referuar rastit të mësipërm:**

A konsiderohet vendimit i KPK-së si masë disiplinore? Edhe nëse ai është ankimuar?

A mundet KLGj-ja të shprehet për ekzistencën e një mase disiplinore kur ka mbajtur qëndrim më parë që nuk ka pasur?

## EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

### *Kushtetuta e Shqipërisë*

#### Neni 135

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.
3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.
4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

#### Neni 138

Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.

Neni 147/a

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve.

### ***Ligj nr 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"***

#### **Neni 6 - Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit**

1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me:

a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;

b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.

2. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshime të bazuara, për të besuar se një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk i përmbush kërkesat e kësaj dispozite.

#### **Neni 32 - Verifikimi i pasurisë dhe i figurës**

1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe të figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31 të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast Këshillat çmojnë, sipas bindjes së tyre, se cilat fakte konsiderohen të provuara



bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës kur:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë.

6/1. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor rishikon vendimin në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

#### **Neni 41 - Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit**

...

2. I emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i



formës së prerë.

3. Vendimi i Këshillit për caktimin e të emëruarit në pozicion, në përputhje me këtë nen, merr formë të prerë kur:

a) nuk është depozituar ankim brenda afateve të ankimit;

b) është depozituar ankim sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ose rrëzimin e ankimit;

c) është depozituar ankim sipas afateve dhe mbi bazën e tij është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë.

4. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruarit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

#### **Neni 45 - Magjistratët në skemën e delegimit**

1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t'u caktuar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.

2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet.

3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t'u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.

4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie:

a) në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat;

b) në një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurori të Posaçme, nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47, të këtij ligji.

c) për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori, për të cilën magjistrati përmbush kërkesat. Në rastet kur caktohet për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të përmbushë kriteret, si dhe të japë pëlqimin sipas nenit 47 të këtij ligji. Delegimi për një çështje të veçantë kryhet kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.

5. Në pritje për t'u caktuar pranë një gjykate ose prokurorie, sipas parashikimeve të këtij neni, magjistrati në skemën e delegimit shërben në strukturat administrative të Këshillave.

6. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit caktimin për një çështje ose për një periudhë të caktuar të magjistratit nga skema e delegimit në gjykatën ose prokurorinë përkatëse, duke paraqitur arsyet e nevojës për caktimin e magjistratit dhe të periudhës kohore të kërkuar.

7. Këshilli vlerëson kërkesën brenda 3 ditëve nga marrja e saj. Nëse Këshilli vlerëson se ka nevojë në gjykatën ose prokurorinë respektive, cakton magjistratin nga skema e delegimit, duke vlerësuar njëkohësisht:

a) plotësimin e kërkesave për pozicionin respektiv;

b) disponueshmërinë;

c) përvojën e veçantë profesionale të magjistratëve;

ç) caktimin në mënyrë të barabartë të magjistratëve në skemën e delegimit, në gjykatat apo prokuroritë e largëta.

8. Çdo Këshill miraton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve, si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit.

#### **Neni 47 - Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë**

1. "Ngritja në detyrë" është kalimi nga:

a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;

b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;

c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie;

ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale:

a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose

si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse:

a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si:

i) përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit;

ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë;

iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

#### **Neni 48 - Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara**

1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme dhe gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.

3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë:

a) magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;

b) magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;

c) juristi i spikatur, sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.

4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

5. Në zbatim të pikës 3, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës;

b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;

c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.

7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:

i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;

ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të

kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga këshillat;

b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës “b”, të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.

10. Këshillat vendosin të ngrenë në detyrë kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta të arritura, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14, të këtij neni. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për atë që sa gjejnë zbatim.

11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kriterëve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni.

12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për atë që sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare. Vendimi i këshillave për mosaktimin në detyrë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme është i formës së prerë.

13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës.

14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;

ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

### **Neni 53 - Parimet e komandimit të magjistratëve**

1. “Komandim” është lëvizja e magjistratit në një pozicion jomagjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë ose organizatë ndërkombëtare, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.

2. “Institucioni në të cilin magjistrati komandohet”, për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykatata e Lartë, Gjykatata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë

është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, si dhe organizatat ndërkombëtare.

3. Me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të sapoemëruarve, magjistratët mund të komandohen vetëm me pëlqimin e tyre.

4. Magjistrati i komanduar ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo magjistrat tjetër, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

5. Magjistrati nuk lejohet të komandohet në ato raste kur:

a) është në një pozicion me mandat të kufizuar;

b) është i komanduar.

6. Periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj.

7. Magjistrati duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas përfundimit të periudhës së komandimit.

8. Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij.

8/1. Magjistrati që komandohet në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në atë organizatë, gëzon të njëjtin status me diplomatët, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

9. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria e shkallës së parë në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, llogaritet përvojë në profesion në shkallë të parë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria në shkallë të dytë, institucioni në të cilin magjistrati komandohet llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të dytë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magjistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese.

10. Magjistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për anëtarët e tjerë të këtij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimi njihen si nivele vlerësimi në kuptim të këtij ligji.

11. Magjistratit, të cilit nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, ka të drejtën të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidat jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim, me qëllim që të konkurrojnë në kushte të njëjta me magjistratët e tjerë për pozicionet e lira.

12. Magjistrati, gjatë komandimit, ka përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes te Këshilli. Në këtë rast Këshilli shqyrton çështjen dhe zbaton procedurën disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji. Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

13. Nëse çështja nuk është referuar në Këshill, institucioni në të cilin është komanduar magjistrati informon Këshillin për çdo vendim të ndërmarrë prej tij ndaj magjistratit të komanduar. Ankimi në gjykatë i vendimit për masë disiplinore të institucionit në të cilin është komanduar magjistrati pezullon zbatimin e vendimit.

### Neni 78 - Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i magjistratit kryhet sipas këtyre niveleve:

- a) “Shkëlqyeshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
- b) “Shumë mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;
- c) “Mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
- ç) “Mjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren.
- d) “I pamjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “mirë” për dy kriteret dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore ose të prokurorisë” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” duhet të vlerësohen të paktën “shumë mirë”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste:

- a) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;
- b) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit



dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera.

#### Neni 105 - **Masat disiplinore**

1. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore:

a) vërejtje konfidenciale;

b) vërejtje publike;

c) ulje e përkohshme e pagës;

i) deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit;

ii) në rastin e magistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës;

ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;

d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;

dh) shkarkim nga detyra.

2. Në caktimin e masës disiplinore, Këshilli mund të vlerësojë çdo lloj pezullimi të mëparshëm sipas kreut V të kësaj pjese, që është vendosur gjatë procedurës përkatëse disiplinore, dhe mund të vendosë në mënyrë të përshtatshme një masë disiplinore më të lehtë ose që pezullimi është masa e përshtatshme dhe e mjaftueshme për shkeljen e kryer.

#### Neni 150 - **Regjistri disiplinor**

1. Këshilli mban një regjistër për çështjet disiplinore të filluara ndaj magistratëve, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime.

2. Këshilli mban të dhëna për të gjitha masat disiplinore në fuqi, përveç “vërejtjes konfidenciale”. Masat e tjera disiplinore shuhen dhe fshihen nga regjistri pas kalimit të afateve të mëposhtme nga data e hyrjes në fuqi të masës disiplinore:

a) dy vjet për “vërejtjen publike” dhe trajnimin si masë disiplinore plotësuese;

b) tre vjet për uljen e përkohshme të pagës, për rastet kur paga ulet deri në shumën e pagës mujore;

c) katër vjet për uljet e përkohshme të pagës më të larta se shuma e pagës mujore dhe uljen në detyrë;

ç) pesë vite për pezullimin si masë disiplinore.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri.

## BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Shqipërisë
- Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor”*, i ndryshuar.
- Ligji nr.45/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative”*.
- Ligji nr.95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*.
- Ligji nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”*, i ndryshuar.
- Ligji nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 70, datë 7.2.2020 *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”*.
- Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.5.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë”*, i ndryshuar.
- Zyhrada Kongoli, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 6 – Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit”*. Marrë nga adresa e internetit:  
<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/6>
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”*. Marrë nga adresa e internetit:  
<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 41 – Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/41>
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 47 – Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë”*. Marrë nga adresa e internetit:  
<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/47>
- Aulona Hazbiu, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 78 – Nivelet e vlerësimit”*. Marrë nga adresa e internetit:  
<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/78>

- Marsida Xhaferllari, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 105 – Masat disiplinore”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/105>
- Sokol Berberi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 150 – Regjistri disiplinor”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/150>
- Vendimi nr. 34, datë 10.4.2017 i Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 133 datë 22.11.2021 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 00 – 2021 – 15 (4), datë 18.1.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.6.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2021 – 1435, datë 23.9.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2021 – 1923, datë 2.12.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë:
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 656, datë 11.4.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 2178, datë 6.10.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 6.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

NGRITJA NË DETYRË NË POZICIONIN  
E KRYETARIT TË GJYKATËS



## SHKURTIME

<b>GjK</b>	Gjykata Kushtetuese
<b>GjL</b>	Gjykata e Lartë
<b>GjAA</b>	Gjykata Administrative e Apelit
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>DNJF</b>	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>KL Gj</b>	Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>KLP</b>	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
<b>ILD</b>	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
<b>ShM</b>	Shkolla e Magjistraturës
<b>K.Pr.C.</b>	Kodi i Procedurës Civile
<b>K.Pr.P.</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>OJF</b>	Organizata jofitimprurëse





## Pasqyra e lëndës

SHKURTIME .....	105
HYRJE .....	109
OBJEKTIVAT & REZULTATET QË SYNOHEN TË ARRIHEN .....	111
STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE .....	113
PLANI I TRAJNIMIT.....	115
MODULI I.....	117
KRITERET LIGJORE PËR T'U EMËRUAR SI KRYETAR GJYKATE .....	117
A) Listimi i kriterëve ligjore për emërimin si kryetar gjykate .....	117
a) Përvoja profesionale .....	117
b) Treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese.....	119
c) Afati i largimit nga KLGj-ja .....	121
ç) Kandidimi nga kryetari në detyrë .....	122
d) Verifikimi i pasurisë dhe i figurës.....	123
i) Kriteri i pasurisë.....	123
ii) Kriteri i figurës .....	125
B) Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjore.....	127
a) Kushtet ligjore.....	127
b) Metoda e mbledhjes së të dhënave për kushtet ligjore .....	130
c) Metoda për mbledhjen e të dhënave shtesë .....	132
ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore .....	132
MODULI II	
PROCEDURA E EMËRIMIT TË GJYQTARËVE NË POZICIONIN	
E KRYETARIT TË GJYKATËS .....	135
A) Procedura e zgjedhjes së kryetarit .....	135
a) Rizgjedhja e kryetarit në detyrë.....	135
b) Zgjedhja e kryetarit nga radhët e gjyqtarëve.....	136
c) Verifikimi i pasurisë .....	137
ç) Procedura e verifikimit të figurës.....	141
d) Vlerësimi si gjyqtar.....	142
dh) Vlerësimi si kryetar .....	145
B) Objekti i monitorimit për procedurat .....	147
a) Hapat e procedurës .....	147
b) Metoda e mbledhjes së të dhënave për monitorimin e procedurave.....	148
c) Metoda e mbledhjes së të dhënave shtesë.....	150
ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurat ligjore.....	150

MODULI III	
MËNYRA E RENDITJES SË GJYQTARËVE QË KANË KANDIDUAR PËR KRYETAR	
GJYKATE TË SHKALLËS SË PARË DHE TË DYTË .....	152
MODULI IV	
ANKIMIMI GJYQËSOR.....	157
A) Llojet e ankimit .....	157
B) Monitorimi i indikatorëve të shqyrtimit të ankimeve gjyqësore .....	162
RASTE STUDIMORE .....	163
EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI .....	165
BIBLIOGRAFIA .....	175

## HYRJE

Në vitin 2016 Republika e Shqipërisë ndërmori një reformë të thellë të sistemit të drejtësisë. Në fokusin e kësaj reforme ishte, midis të tjerash, forcimi i meritokracisë në karrierat gjyqësore, që konsiderohet një parakusht për rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të gjyqtarëve.

Në këtë kuadër zhvillimesh të vrullshme ligjore dhe institucionale, Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadrin e programit Shoqëria Civile dhe Media 2021 nën IPA III/2022/441-466, ka zhvilluar, ndër të tjera, një metodologji për matjen e meritokracisë në karrierat gjyqësore.

Manuali i Trajnimit mbi “Ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës” vjen si një vijimësi e Metodologjisë “Meritokracia në karrierat gjyqësore” (“**Metodologji/a**”), synimi i së cilës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile për monitorimin e procedurave që kryhen nga KLGj-ja për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, nëpërmjet:

- Thjeshtëzimit dhe lehtësimit të procesit të monitorimit nga shoqëria civile të këtyre procedurave, duke synuar të identifikojë situata dhe siguruar rekomandime të përshtatshme në funksion të rritjes së meritokracisë në promovimin e gjyqtarëve dhe të përgjegjshmërisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve;
- Ofrimit të një kuadri të përgjithshëm monitorimi për aktorët e shoqërisë civile (*organizatat, mediat, studentët e drejtësisë, etj*), me një përmbajtje efektive, të thjeshtë dhe praktike, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizohen nismat e tyre të monitorimit të procedurave për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve.

Në vijim të treguesve dhe faktorëve të përcaktuar në Metodologji, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet që duhet të zbatohen për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, në procedurën e emërimit në pozicionin e kryetarit të gjykatës, duke u ndalur në tri kategori kryesore:

1. kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me kriteret ligjore;
2. procedurat e emërimit të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me procedurën e emërimit;
3. kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me këto kritere.

Manuali do të ndahet në 4 module, ku tri modulet do të strukturohet me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë tri kategoritë e mësipërme, ndërsa moduli i katërt do të analizojë fazën e ankimeve gjyqësore:

- A. **Moduli i parë** do të përmbajë një analizë të detajuar të kritereve ligjore për emërimin e gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës, duke përfshirë por pa u kufizuar, listimin e kritereve ligjore (*përfshirë identifikimin e dispozivate përkatëse ligjore*), objektivat e monitorimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.
- B. **Moduli i dytë** do të përmbajë një analizë të detajuar të procedurës së emërimit të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës, duke përfshirë por pa u kufizuar, një prezantim të shkurtër mbi elemente të përgjithshme të procedurës së emërimit, objektivat e monitorimit së procedurës së emërimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave mbi procedurën e emërimit;
- C. **Moduli i tretë** do të përmbajë një analizë të detajuar të vlerësimit dhe renditjes të gjyqtarëve që kanë aplikuar në pozicionin e kryetarit të gjykatës, duke përfshirë por pa u kufizuar, listimin e kritereve për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (*përfshirë identifikimin e dispozivate përkatëse ligjore*), objektivat e monitorimit të renditjes së kandidatëve dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave mbi procedurën e emërimit;
- D. **Moduli i katërt** do të përmbajë një analizë të procedurave ankimore që ndiqen në Gjykatën Administrative të Apelit dhe eventualisht në Gjykatën e Lartë, nga gjyqtarët që kanë aplikuar për pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe që kanë pasur ankesa për procesin e ndjekur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

## OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Duke marrë në konsideratë që:

*(i) synimi final i Metodologjisë “Meritokracia në karrierat gjyqësore” është realizimi i një presioni pozitiv mbi KLGj-në, me qëllim që ky i fundit të garantojë inkuadrimin e meritokracisë si një gjendje të qëndrueshme ku gjyqtarët caktohen sistematikisht në pozicionet e karrierës.*

*dhe se*

*(ii) ky synim pritet të arrihet përmes monitorimit të jashtëm, të pavarur dhe profesional të karrierave gjyqësore nga shoqëria civile*

ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit dhe thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, me fokus specifik zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, nëpërmjet aplikimit në pozicionin e kryetarit të gjykatës.

Rrjedhimisht, Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë informacion dhe njohuri mbi kushtet e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit kusht të zgjedhshmërisë dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme;
- Të ofrojë informacion dhe njohuri mbi procedurën e emërimit të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit hap të procedurës së emërimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme;
- Të ofrojë informacion dhe njohuri mbi procedurën e vlerësimit dhe renditjes sipas meritës së gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit kriter të vlerësimit dhe renditjes dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme.

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile do të kenë njohuritë dhe mekanizmat e duhura për të siguruar:

- ❖ informacion, në kohë reale, lidhur me vakancat në pozicionin e kryetarit të gjykatës;
- ❖ monitorim të pavarur të vlerësimeve të KLGj-së lidhur me përmbushjen ose jo të kushteve ligjore nga kandidatët;

- ❖ monitorim të pavarur të procedurave të emërimit të ndjekura nga KLGj-ja për plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës;
- ❖ monitorim të pavarur të vlerësimeve të KLGj-së lidhur me shkallën e përmbushjes së kushteve dhe të zbatimit të kriterëve në vlerësimin dhe renditjen e gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës;

duke përmirësuar thelbësisht aftësinë e tyre për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë, për realizimin e meritokracisë së karrierës në gjyqësor, nëpërmjet analizës së thelluar të standardeve të performancës të parashikuara në ligj dhe duke pasqyruar treguesit e realizimit dhe mënyrat e matjes së tyre faktikisht.

Rezultatet e pritshme nga kryerja e monitorimeve në kuadër të Metodologjisë “*Meritokracia në karrierat gjyqësore*”, do të shërbenin:

- (a) për të kuptuar nëse vendimet e KLGj-së për zhvillimin e karrierës në gjyqësor bazohen thjesht dhe vetëm në meritat e kandidatëve (*siç përcaktohen ato nga ligji*) apo në faktorë të paligjshëm si nepotizmi, korrupsioni etj;
- (b) si një referencë për të gjithë politikëbërësit, politikanët, aktorët e shoqërisë civile dhe donatorët që duan të informohen nëse karriera gjyqësore në Shqipëri zhvillohet në bazë të meritokracisë ose të faktorëve të tjerë (*jo të ligjshëm*);
- (c) si i vetmi burim i të dhënave të qëndrueshme (*cilësore dhe sasimore*) dhe të përshtatura për vlerësimin e cilësisë së politikave dhe praktikës së ndjekur nga KLGj-ja lidhur me karrierën e gjyqtarëve;
- (d) si lëndë e parë në procesin e përpilimit të politikave, si dhe në vendimmarrjen institucionale në fushën e vlerësimit të karrierës gjyqësore.



## STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE

<b>MODULI 1</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË POZICIONIN KRYETAR I GJYKATËS</b></p> <p><i>A. Kriteret ligjore</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Listimi i kriterëve ligjore për emërimin e gjyqtarëve në pozicionin kryetarit të gjykatës;</li> <li>▪ Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjore;</li> <li>▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me kriteret ligjore;</li> <li>▪ Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore.</li> </ul>
<b>MODULI 2</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË POZICIONIN KRYETAR I GJYKATËS</b></p> <p><i>B. Procedura e emërimit të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Prezantim i shkurtër mbi elemente të përgjithshme të procedurës së emërimit;</li> <li>▪ Objektivat e monitorimit në lidhje me procedurën e emërimit;</li> <li>▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me procedurën e emërimit;</li> <li>▪ <i>Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore.</i></li> </ul>
<b>MODULI 3</b>	<p><b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË POZICIONIN KRYETAR I GJYKATËS</b></p> <p><i>C. Procedura e vlerësimit dhe e renditjes së gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Listimi i kriterëve për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (<i>përfshirë identifikimin e dispozitave përkatëse ligjore</i>);</li> <li>▪ Objektivat e monitorimit mbi renditjen e kandidatëve;</li> <li>▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me renditjen e kandidatëve;</li> <li>▪ Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore.</li> </ul>

<b>MODULI 4</b>	<b>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARËVE NË POZICIONIN KRYETAR I GJYKATËS</b>  <i>F. Ankimi gjyqësor</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkaqet dhe afatet e ankimit</li> <li>• Procedura dhe vendimmarrja gjyqësore</li> <li>• Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore</li> </ul>
<b>EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI</b>	
<b>RASTE STUDIMORE</b>	

## PLANI I TRAJNIMIT

**Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 2 orë, sipas tabelës së mëposhtme:**

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës</b> (Moduli 1)</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me kriteret ligjore që duhet të plotësohen nga gjyqtarët që aplikojnë për ngritje në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës, objektivat e monitorimit për çdo kriter dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>0.5 orë</p>
<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës</b> (Moduli 2)</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me elementet e procedurës së emërimit për gjyqtarët që aplikojnë për ngritje në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës, objektivat e monitorimit për çdo element të procedurës dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>0.5 orë</p>

<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës</b> (Moduli 3)</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me elementet e vlerësimit dhe të renditjes së gjyqtarëve që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës, objektivat e monitorimit për renditjen dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>0.5 orë</p>
<p><b>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës</b> (Moduli 4)</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me shkaqet, afatet dhe procedurat e ankimimit gjyqësor, kundër vendimeve për emërimin e kryetarëve të gjykatave, nga ana e gjyqtarëve që kanë ankesa mbi këtë vendimmarrje dhe si mund të ndikojë kjo në procesin e ngritjes në detyrë.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>0.5 orë</p>

# MODULI I

## KRITERET LIGJORE PËR T’U EMËRUAR SI KRYETAR GJYKATE

### **A) Listimi i kritereve ligjore për emërimin si kryetar gjykate**

Legjislacioni në fuqi, veçanërisht ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në nenin 46 § 6 të tij parashikon si ngritje në detyrë edhe emërimin e gjyqtarit në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë (që mund të jenë një nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, gjykata administrative e shkallës së parë ose Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar) ose të gjykatës së apelit (që mund të jete Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar).

Përrjashtim nga ky rregullim, bën kryetari i Gjykatës së Lartë që zgjidhet me një tjetër procedurë, nga vetë anëtarët e Gjykatës së lartë, pra jo nga KLGj-ja. Për këtë arsye, emërimi si kryetar i Gjykatës së Lartë nuk konsiderohet si ngritje në detyrë në kuptim të ligjit dhe për rrjedhojë nuk është pjesë e trajtimit nga ky manual.

Vetë dispozita parashikon tri kritere për t’u zgjedhur si kryetar gjykate. Kjo mundëson zgjedhjen e një drejtuesi të aftë për të administruar gjykatën duke ushtruar me kompetencë dhe aftësi detyrat e tij si organ monokratik (kryetar), por edhe si pjesë e organit kolegjal (këshillit të gjykatës, neni 27 dhe 38 i ligjit nr. 98/2016).<sup>166</sup>

#### **a) Përvoja profesionale**

Kriteri i parë që përmend dispozita është përvoja profesionale. Kështu nëse i referohemi nenit 47 § 6, germa “a” të ligjit nr. 96/2016, rezulton se gjyqtari mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, nëse *ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.*

Ky parashikim, përfshin dy lloje afatesh, ku i pari është përvoja si gjyqtar jo më pak se shtatë vjet. Ky afat fillon të ecë nga momenti që ata marrin emërimin nga KLGj-ja si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë, në vendin ku janë emëruar. Duke qenë se ligji nr. 96/2016, nuk ka parashikime për mënyrën e përllogaritjes së afateve, atëherë u referohemi parashikimeve

166. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 47 – Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/47>

të Kodit të Procedurave Administrative ku neni 56 § 3 parashikon se *Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati*. Për rrjedhojë afati 7-vjeçar në këtë rast, konsiderohet i përmbushur në të njëjtën ditë, të të njëjtit muaj të vitit të shtatë, nga momenti i emërimit të gjyqtarit nga KLGj-ja. Kuptohet që ky afat minimal shërben më shumë për t'u emëruar si kryetar në gjykatën e shkallës së parë, pasi në parim, një gjyqtar i emëruar në apel, për të cilin kërkohet që të ketë pikërisht 7 vjet përvojë si gjyqtar, prezumohet se ky kriter tashmë është plotësuar.

Dispozita parashikon se në këtë përvojë përfshihet edhe përvoja profesionale si gjyqtar i komanduar. Kjo qasje tregon se gjyqtari mbasi ka marrë emërimin e përhershëm nga KLGj-ja, mund të kryejë edhe funksione të tjera sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, pra të komandohet dhe në pozicione të tjera, por nuk e humbet vjetërsinë dhe përvojën. Në këtë rast afati shtatëvjeçar nuk ndërpritet, por vijon të ecë.

Referuar parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 (neni 53 § 2 dhe neni 54 § 7), të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor" (neni 2, germa "dh") si dhe ato të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", i ndryshuar (neni 211 § 1 dhe neni 265 § 1), përvoja si gjyqtar i komanduar përfshin përvojën e veçantë të punës së gjyqtarit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në KLGj-në e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, si edhe në çdo pozicion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për interes publik.

Siç rezulton nga përkufizimi i mësipërm, komandimi i gjyqtarëve mund të bëhet në disa pozicione, si gjyqtar, por i komanduar në pozicione të tjera, në Gjykatën e Lartë në Gjykatën Kushtetuese, pranë ILD-së, në KLGj-në, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit dhe në Shkollën e Magjistraturës. Pra përmenden në 8 institucione në total, por lista mbetet e hapur pasi vetë përkufizimin parashikon edhe komandimin *në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit si edhe në organizata ndërkombëtare*. Megjithatë komandimi në këto raste lejohet nga KLGj-ja vetëm *nëse komandimi është në interes publik dhe nuk cenon afatet dhe ushtrimin në mënyrë efçente të funksioneve*.<sup>167</sup>

Afati tjetër, ai 4-vjeçar, përfshihet brenda periudhës 7-vjeçare. Sipas këtij afati, gjyqtari që kërkon të emërohet si kryetar duhet të ketë qëndruar të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë gjyqësore. Ky parashikim u drejtohet më shumë gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të dyta, pra atyre të apelit, pasi një gjyqtar i shkallës së parë që të emërohet kryetar i asaj gjykate, duhet që të ketë një përvojë pune, të paktën 7-vjeçare. Për rrjedhojë, gjyqtari i shkallës së parë që do të kandidojë për t'u emëruar si kryetar i asaj gjykate vetiu e plotëson këtë kriter. Por që një gjyqtar i shkallës së parë të emërohet si gjyqtar apeli, Neni 47 § 4 e Ligjit nr. 96/2016, kërkon që gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë, përpara se të kenë ushtruar

167. Ligj nr.96/2016, neni 54 § 7.

përvojën e tyre në këtë shkallë gjyqësore për të paktën 7 vjet. Në këtë rast, ligji kërkon që një gjyqtar, që sapo është emëruar në një gjykatë apeli, të ketë dhe një përvojë, të paktën 4-vjeçare në gjykatat e asaj shkalle, me qëllim familjarizimin e tij/saj me këtë institucion. Ky afat fillon nga momenti që gjyqtari ka marrë emërimin nga KLGj-ja si gjyqtar apeli dhe përfundon në të njëjtën ditë, të të njëjtit muaj të vitit të katërt.

### ***b) Treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese***

Kriteri tjetër, i parashikuar nga ligji, neni 47 § 6, germa "b" kërkon që gjyqtari që kandidon për t'u bërë kryetar duhet të *"përmbushë treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese"*. Po sipas vetë dispozitës ligjore, ky kriter përmbushet nëse kandidati ka i) *përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit; ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë; iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Duke i marrë sipas radhës, rezulton se një nga përvojat që shërben është ajo e të qenit zëvendëskryetar, i cili sipas Ligjit nr. 98/2016 *"Për organizimin e pushtetit gjyqësor"*, neni 26 § 3, që një gjyqtar të zgjidhet si zëvendëskryetar duhet të ketë të paktën pesë vjet përvojë profesionale si gjyqtar, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtën shkallë. Zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.

Mundësia e dytë për ta përmbushur këtë kriter është që gjyqtari të ketë qenë kryetar i një seksioni. Krijimi dhe funksionimi i seksioneve pranë gjykatave rregullohet nga Ligji nr. 98/2016 *"Për organizimin e pushtetit gjyqësor"*, ku neni 23 § 1 parashikon se *Për të mundësuar specializimin, gjykata mund të organizohet në seksione kur kjo është e nevojshme, bazuar në kriteret objektive, në veçanti në numrin e gjyqtarëve në gjykatë, llojin dhe numrin e çështjeve në të paktën tri vitet e fundit në atë gjykatë. Seksionet e gjykatave përbëhen nga së paku gjathtë gjyqtarë, ndërsa pika 4 parashikon se Caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues bëhet duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit.* Krijimi i seksioneve dhe caktimi i gjyqtarëve është kompetencë e Këshillit të Gjykatës. Në këtë pikë duhet theksuar se vetë Ligji nr. 98/2016 që parashikon krijimin dhe funksionimin e seksioneve nuk e parashikon pozicionin e kryetarit të seksionit, por ky parashikim rrjedh nga ligji nr. 96/2016. Për rrjedhojë nëse Këshilli i Gjykatës krijon seksione, atëherë prezumohet që çdo seksion duhet që të ketë dhe një kryetar. Pikërisht përvoja si kryetar i një seksioni shërben për të plotësuar kriterin e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese. Në këtë rast dispozita nuk përcakton ndonjë afat apo përvojë si kryetar i seksionit.

Mundësia tjetër për të përmbushur këtë kriter është që gjyqtari të jetë caktuar si magjistrat për shtypin. Sipas Ligjit nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë"*, i ndryshuar, neni 91 § 3, rezulton se *Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli.* Bazuar në këtë parashikim, KLGj-ja ka bërë emërimet



përkatëse për çdo gjykatë.<sup>168</sup>

Një tjetër mundësi për të përmbushur këtë kriter është edhe përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike. Theksojmë se një shtetas që të kandidojë për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës me qëllim që të bëhet gjyqtar duhet që domosdoshmërisht të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi, në disa fusha dhe pozicione, ku përfshihet edhe përvoja në administratën publike.<sup>169</sup> Pasja e një përvoje profesionale aktive në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare, është një risi që i shërben motivimit të kandidaturave për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, pas një eksperience të domosdoshme dhe arritjes së një pjekurie në një moshë që rezulton më e madhe, nga sa ishte më parë, që ndihmon për kryerjen siç duhet të funksionit të magjistratit.<sup>170</sup>

Në rast se një gjyqtar, më parë ka punuar në administratën publike dhe ka pasur pozicione drejtuese, atëherë kjo përvojë shërben për plotësimin e këtij kriteri. Në këtë pikë, Ligji nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, nenet 12-15, si edhe Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, neni 19, ka disa pozicione drejtuese, ku përfshihen kategoria e lartë drejtuese (sekretari i përgjithshëm, drejtor departamenti), kategoria e mesme drejtuese (drejtor drejtorie), si edhe kategoria e ulët drejtuese (përgjegjës sektori). Duke qenë se Ligji nr. 96/2016, në nenin 47 § 6, germa “b”, nën-pika “ii” të sajën nuk e specifikon kategorinë e drejtuesve, por përkundrazi përmend në mënyrë të përgjithshme përvoja në pozicione drejtuese, atëherë të gjitha këto pozicione do të konsiderohen si pjesë përbërëse e këtij kriteri.

Një tjetër mundësi është edhe përvoja në pozicione drejtuese në sistemin e drejtësisë. Në këtë rast ky parashikim të referon në administratën gjyqësore, ku si pozicione drejtuese, janë ato të kancelarit<sup>171</sup> dhe kryesekretari.<sup>172</sup> Pra, nëse më parë në karrierën e tij si jurist, përpara se të bëhet gjyqtar, ka mbajtur dhe ushtruar detyra të tilla, atëherë kjo përvojë shërben për të plotësuar kriterin e parashikuar nga neni 47 § 6, germa “b” të Ligjit nr. 96/2016, për t'u bërë kryetar.

Një tjetër mundësi është përvoja e gjyqtarit si anëtar i KLGj-së. KLGj-ja, si organ kolegjal, ka në përbërjen e tij 6 gjyqtarë që zgjidhjen nga mbledhja e përgjithshme e gjithë gjyqtarëve, për një mandat 5-vjeçar. KLGj-ja është konceptuar si organi më i rëndësishëm i qeverisjes së gjyqësorit dhe që ka si kompetencë të tij, emërimin, ngritjen në detyrë, transferimin, komandimin, delegimin dhe dhënien e masave disiplinore për të gjithë gjyqtarët. Gjithashtu

168. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 101, datë 06.03.2023 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 *“Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”*, i ndryshuar.

169. Ligji nr. 96/2016, neni 28 § 1, “germa “ç”.

170. Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 28 – Kriteret e pranimit në formimin fillestar”*. Marrë nga adresa e internetit:

<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/28>

171. Ligji nr. 98/2016, neni 39.

172. Ligji nr. 98/2016, neni 43.

ky institucion është përgjegjës edhe për buxhetin e pushtetit gjyqësor dhe planifikimin strategjik. Është e kuptueshme që përvoja si anëtar i këtij institucioni menaxhimi të sistemit gjyqësor, shërben për të plotësuar treguesin e aftësive organizative dhe drejtuese.

Një tjetër mundësi për plotësimin e këtij kriteri është edhe njohuria për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit. Kjo skemë rregullohet nga neni 45, i Ligjit nr. 96/2016, sipas së cilës një gjyqtar në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojë për t'u caktuar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në KLGj. Gjyqtari shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet dhe nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t'u caktuar në çdo gjykatë. Këshilli cakton gjyqtarin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate.

Mundësia e fundit për plotësimin e këtij kriteri lidhet me funksionin si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky rast është i veçantë nga rasti i komandimit të gjyqtarit si inspektor pranë ILD-së, që e cituam më sipër. Kjo në këtë rast bën fjalë nëse në karrierën e tij, të mëparshme, përpara se të bëhej gjyqtar, ky shtetas ka punuar si inspektor pranë ILD-së. Sipas Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, neni 209, jo më pak se gjysma e inspektorëve janë magjistratë (gjyqtarë dhe/ose prokurorë) ndërsa pjesa tjetër janë inspektorë që vijnë nga jashtë sistemit të drejtësisë dhe që emërohen nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, sipas një procedure të caktuar nga ligji. Pikërisht ky parashikim bën fjalë për këtë lloj kategorie inspektorësh, ata që nuk janë nga radhët e magjistratëve, por që më pas janë bërë gjyqtarë. Pra, nëse në përvojën e tij të mëparshme, gjyqtari ka pasur edhe këtë eksperiencë, atëherë plotëson treguesin e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese.

### ***c) Afati i largimit nga KLGj-ja***

Kriteri tjetër që parashikohet nga Ligji nr. 96/2016, neni 47 § 6, germa "c" është që gjyqtari që kandidon, nuk ka qenë anëtar i KLGj-së tri vitet e fundit. Më sipër përmendëm avantazhin që kishte qenia anëtar i KLGj-së për të kandiduar për kryetar gjykate. Megjithatë kjo dispozitë parashikon se qenia ish-anëtar i KLGj-së e gjyqtarit në tri vitet e fundit është një kriter ndalues për të kandiduar si kryetar gjykate. Ky ndalim është bërë me qëllim që anëtarët e KLGj-së të mos përdorin pozicionin e tyre për të promovuar veten e tyre. Në momentin që një gjyqtar emërohet në KLGj, ai ka një mandat 5-vjeçar. Trupa e anëtarëve që përbëjnë KLGj-në nuk ndryshon e gjitha menjëherë. Ajo ndryshon me rreth gjysmën e anëtarëve mbas tri viteve dhe pjesa tjetër e anëtarëve ndryshon mbas dy viteve, nga momenti që gjyqtari është emëruar si anëtar i këtij institucioni. Duke vendosur ndalimin për të kandiduar për ngritjen në detyrë për tre vjet mbas mbarimit të mandatit, ligjvënësi është kujdesur që në momentin e aplikimit, asnjë prej anëtarëve të tjerë që kanë qenë njëkohësisht me këtë gjyqtar në KLGj, të jenë përsëri aty.

### **ç) Kandidimi nga kryetari në detyrë**

Një tjetër kriter që rrjedh nga mënyra se si është formuluar ligji, fillimisht ekziston mundësia që për kryetar të një gjykate, të kandidojë kryetari që është në detyrë. Mandati i kryetarëve është tre vjet dhe ata kanë të drejtë të rikandidojnë vetëm një herë. Në këtë rast nëse kryetari në detyrë rikandidon, nuk hapet procedura për kandidime të tjera, por vlerësohet kryetari në detyrë.

Në këtë rast, sipas nenit 52 § 4 të Ligjit nr. 96/2016 kryetari riemërohet për një mandat tjetër nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe gjyqtar, është të paktën *“shumë mirë”*. Pra në këtë rast kemi të bëjmë me dy vlerësime që duhet të marrë kandidati dhe që është kryetar në detyrë.

I pari është vlerësimi si gjyqtar. Sipas Ligjit nr. 96/2016, neni 71, ky proces përfshin vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit, e aftësive organizative, të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale si edhe të aftësive personale dhe angazhimit profesional. Në përfundim të këtij procesi, nivelet e vlerësimit, në bazë të nenit 78 të Ligjit nr. 96/2016, për gjyqtarin janë a) *“Shkëlqyeshëm”*, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta; b) *“Shumë mirë”*, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren; c) *“Mirë”*, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare; ç) *“Mjaftueshëm”*, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren. d) *“I pamjaftueshëm”*, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët. Vlerësimi i përgjithshëm *“shkëlqyeshëm”* jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar *“shkëlqyeshëm”* për të katërta kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm *“shumë mirë”* jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet *“shumë mirë”* për tri kriteret dhe *“mirë”* për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret *“aftësitë profesionale të gjyqtarit”* dhe *“etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”* duhet të jenë vlerësuar *“shumë mirë”*. Referuar kriterit ligjor, kandidati duhet të jetë vlerësuar si gjyqtar të paktën *“shumë mirë”*.

Për sa i përket vlerësimit të dytë, atë si kryetar, neni 79 i Ligjit nr. 96/2016, parashikon se ai bazohet në vlerësimin e kriterëve që kanë të bëjnë me aftësitë drejtuese dhe organizative, si edhe me aftësitë e komunikimit. Në bazë të nenit 83, nivelet e vlerësimit janë a) *“Shumë mirë”*, në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren; b) *“Mirë”*, në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare; c) *“Mjaftueshëm”*, në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare. Vlerësimi i përgjithshëm *“shumë mirë”* jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet *“shumë mirë”* në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm *“mjaftueshëm”* jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet *“mjaftueshëm”*, të paktën në një prej kriterëve. Në rastet e tjera, veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet *“mirë”*. Referuar këtij vlerësimi, rezulton se kryetari në detyrë që të rizgjidhet duhet që të jetë vlerësuar nga KLGj-ja, maksimalisht, në nivelin më të lartë, pra *“shumë mirë”*. Në vlerësimin si kryetar ligji nuk parashikon vlerësimin *“shkëlqyeshëm”*.

#### **d) Verifikimi i pasurisë dhe i figurës**

Si kriter të fundit në këtë rast, sipas nenit 52 § 9 e Ligjit nr. 96/2016, janë vlerësimi i pasurisë dhe i figurës së kandidatëve për kryetar gjykatë.

Në këtë rast kemi të bëjmë me dy elemente të rëndësishme, të cilat ndikojnë në fatin e kandidaturës së gjyqtarit për t'u ngritur në detyrë.

Kontrolli i pasurisë dhe i figurës e shoqërojnë gjyqtarin në pothuaj çdo moment të karrierës së tij. Kështu, neni 136/a § 1 i Kushtetutës parashikon se gjyqtarët duhet që të kryejnë procesin e verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës.

Pavarësisht se personat e emëruar gjyqtarë të gjykatave të shkallëve të para e kanë bërë një verifikim të tillë të këtyre dy elementeve, kjo nuk do të thotë që ata nuk janë përfshirë më pas në veprimtari të tjera të ndaluara. Pikërisht për të ruajtur sistemin e drejtësisë, nga cedime të mëtejshme, ligjvënësi ka parashikuar që verifikimi i pasurisë dhe i figurës të bëhet në çdo procedurë ngritje në detyrë që gjyqtarët aplikojnë.

Me anë të rregullimit, ligjvënësi ka si qëllim kryesor që të promovohen vetëm ata gjyqtarë që përmbushin aftësitë që kërkon Kushtetuta, si në këndvështrimin e formimit të tyre moral, ashtu edhe të formimit profesional. Pra, qëllimi është dhe mbetet që në sistemin e drejtësisë të arrihet të promovohen një kategori e caktuar individësh, të cilët premtojnë për një integritet më të lartë moral e profesional. Nëpërmjet kryerjes me efektivitet të verifikimit të pasurisë dhe të figurës për gjyqtarët për ngritje në detyrë, procesi ligjor që kryhet mbart në vetvete respektimin e parimeve bazë, mbi të cilat mbështetet i gjithë procesi i vlerësimit. Procesi i verifikimit të integritetit realizohet mbi parimet mbi të cilat funksionojnë organet publike, si parimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional, parimi i informimit, i mbrojtjes së të dhënave dhe të konfidencialitetit, parimi i dhënies së ndihmës aktive, i proporcionalitetit dhe i procesit të rregullt ligjor. I gjithë ky proces vlerësimi për gjyqtarët për ngritje në detyrë synohet të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj. Pra, verifikimi i integritetit si i tillë, kryerja e këtij verifikimi në mënyrë të rregullt dhe efektiv, duke i ofruar të gjitha garancitë procedurale gjyqtarit mbetet si qëllimi thelbësor i kësaj dispozite.<sup>173</sup>

#### **i) Kriteri i pasurisë**

Për sa i përket kriterit të pasurisë, problem i parë që shfaqet është çfarë do të kuptojmë me pasuri. Vetë Kushtetuta apo ligji nuk e përkufizojnë së çdo të kuptojmë me kontrollin e verifikimit të pasurisë, në rastet e ngritjes në detyrë, fakt ky i pranuar dhe nga doktrina.<sup>174</sup>

Një përkufizim na vjen në fakt nga shtojca e Kushtetutës, neni D § 3, sipas të cilës: *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të*

173. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 06.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

174. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

*cilat janë paguar detyrimet tatimore.* Pra, sipas këtij parashikimi, KLGj-ja do të duhet që të verifikojë nëse të ardhurat e realizuara nga gjyqtarët janë deklaruar dhe nëse janë paguar tatimet për to.

Por kjo qasje paraqet dy probleme. E para, vetë norma parashikon që ky kuptim për pasurinë e ligjshme vlen vetëm për rastin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. E dyta, ky proces është i përkohshëm dhe si rregull duhet që të përfundojë në vitin 2026. Pra, shtojca përkatëse e Kushtetutës, bie vetiu nga fuqia me kalimin e këtij afati.

Nga ana tjetër, vetë praktika gjyqësore, në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrimin se të ardhurat konsiderohen të ligjshme nëse *nuk ka rezultuar kryerja e veprimtarisë së paligjshme nga të cilat të jenë gjeneruar këto të ardhura.*<sup>175</sup> Pra, në praktikën gjyqësore, janë pranuar si të ligjshme dhe të ardhura të cilat megjithëse nuk janë deklaruar apo paguar tatimet, provohet se nuk janë rezultat i veprimtarive të paligjshme.

Vlerësimi në këto raste duhet bërë bazuar në parimin e proporcionalitetit, sipas së cilit veprimtaria administrative e kryer nga organet publike është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: **a) i nevojshëm** për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës, **b) i përshtatshëm** për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj dhe **c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.** Mbi këtë bazë KLGj-ja në vlerësimin e kriterit të pasurisë, duhet që të mbajë në konsideratë zhvillimi historik dhe situatën ekonomike në vendin tonë.<sup>176</sup>

Lidhur me verifikimin e pasurisë, ligjvënësi ka parashikuar tri shkaqet, vërtetimi i njërit prej tyre e skualifikon kandidatin nga procesi i ngritjes në detyrë të pranimit dhe më konkretisht, kur: “burimet financiare nuk justifikojnë pasuritë e tij”, “nuk ka deklaruar pasuri ose asetë”, ose “ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të asetëve”. Sipas legjislacionit përkatës, tri shkaqet përjashtuese vlerësohen pas një hetimi të thelluar administrativ që kryen Inspektorati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave (në vijim ILDKPKI), nisur nga justifikimi i burimit të ligjshëm të pasurisë, nga mënyra e përpilimit të deklaratës, si edhe nga motivi i subjektit. Në veçanti, motivi i subjektit lidhet me shkakun përjashtues të fshehjes së pasurisë, nëpërmjet mosdeklarimit, ose të paraqitjes së deklaratës në mënyrë të pasaktë. Vërtetimi i motivit se, subjekti me veprimet e kryera ka “fshehur pasurinë” ose ka bërë një “deklarim të rremë” është element përcaktues për të konkluduar ILDKPKI-ja në raportin e vet. Praktika që ndiqet nga ky organ është disavjeçare, por edhe shumë e pasur; për më tepër që jurisprudenca e krijuar nga organet e vetingut që kanë rivlerësuar veprimtarinë e ILDKPKI-së, është bërë tepër e njohur dhe që interpreton të gjitha kriteret mbi të cilat bëhet vlerësimi i pasurisë.<sup>177</sup>

175. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 06.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

176. Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 06.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

177. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>



## ii) Kriteri i figurës

Për sa i përket kontrollit të figurës në rastin e Kushtetutës, është parashikimi në shtojcën e saj, ku sipas nenit DH § 1, e përkufizon si *kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar*. Por ky parashikim ka të njëjtat problematika që u përmendën për kontrollin e pasurisë. E para, vetë norma parashikon që ky kuptim për kontrollin e figurës vlen vetëm për rastin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe e dyta, ky proces është i përkohshëm dhe si rregull duhet që të përfundojë në vitin 2026. Pra, shtojca përkatëse e Kushtetutës, bie vetiu nga fuqia me kalimin e këtij afati.

Megjithatë, Ligji nr. 95/2016 ka një shtojcë të tij, ku jepen deklaratat për kontrollin e figurës. Kjo deklaratë në pjesën 6 të saj, ka disa pyetje, nga të cilat mund të nxirren konkluzionet përkatëse se ku duhet të bazohet kontrolli i figurës. Kështu gjyqtari që aplikon për t'u ngritur në detyrë, dhe/apo familjarët e tij nuk duhet të jenë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar, nuk duhet të jenë hetuar dhe/apo akuzuar për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar gjatë 10 viteve të fundit, vetë gjyqtari të mos ketë qenë ndonjëherë i ndaluar, i arrestuar, i dënuar për shkelje ligjore brenda ose jashtë Shqipërisë, të mos ketë pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një telefonate, telekomunikim, takime, aktiviteti, vakti ose raste të tjera, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës, të mos kenë pasur takime, marrëdhënie ose kontakte të papërshtatshme me persona, të cilët në dijeninë e gjyqtarit, kanë qenë ose janë të arrestuar, të dënuar, apo të akuzuar publikisht për përfshirje në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës të cilat nuk janë në pajtim me ushtrimin e detyrës, të mos ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

Ligjvënësi ka përdorur frazën “lidhje me krimin e organizuar”, por nuk e ka specifikuar llojin e lidhjes. Është e kuptueshme se lidhja me krimin e organizuar duhet të jetë një lidhje e qëllimshme, pra jo e rastësishme dhe që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës. Vlerësimi i anës subjektive është element thelbësor për të bërë një interpretim të plotë dhe për t'i dhënë një kuptim të drejtë kësaj fraze që jep ligji.<sup>178</sup>

Procesi i verifikimit të integritetit realizohet mbi parimet mbi të cilat funksionojnë organet publike, si parimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional, parimi i informimit, i mbrojtjes së të dhënave dhe të konfidencialitetit, parimi i dhënies së ndihmës aktive, i proporcionalitetit dhe i procesit të rregullt ligjor. I gjithë ky proces vlerësimi për kandidatët për magjistratë synohet të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj, “me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm”. Pra, verifikimi i integritetit si i tillë, kryerja e këtij verifikimi në mënyrë të rregullt dhe efektiv, duke i ofruar të gjitha

---

178. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

garancitë procedurale kandidatit, mbetet si qëllimi thelbësor i kësaj dispozite.<sup>179</sup>

Cilësitë që kërkohet të ketë një gjyqtar për magistrat duhet të jenë të kulluara dhe vlerësimi informacioneve në lidhje me sjelljen e gjyqtarit në të shkuarën, shihet në raport me kriterin “verifikim figure” i cili synon të verifikojë cilësitë e nevojshme “morale” të gjyqtarit. Ky nuk është gjykim penal, por administrativ, bazuar në kritere meritokracie, ku futet edhe vlerësimi i cilësive më të larta morale, në ato raste kur gjyqtari nuk gjendet me figurë morale të përshtatshme, sipas standardeve më të mira etike dhe ligjore që duhet të mishërojë jo vetëm një qytetar shembullor, por edhe një jurist i mirë.

Verifikimi i “figurës” sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, shoqërohet me nevojën për të përzgjedhur dhe lejuar që të vazhdojnë rrugën për t’u promovuar vetëm atyre personave që plotësojnë cilësitë më të larta morale në shoqëri. Ndaj, jo vetëm sjellja që personi mban pasi fiton të drejtën për të qenë gjyqtar për magistrat, por edhe ajo e mëparshme, i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit. KLGj-ja nëpërmjet këtij procesi që kryen, vlerëson jo vetëm qenien apo jo i dënuar (si dhe çdo të dhënë që disponojnë organet e ndjekjes penale, pavarësisht fundit të saj procedural), por shkon deri te verifikimi i shkeljeve të mundshme disiplinore në punë që mund të ketë pasur në të shkuarën gjyqtari, të cilat në vetvete mund të duken të shkëputura nga veprimtaria e tij e ardhshme, por që mund të nxjerrin në pah, rrethana që ndikojnë në përshtatshmërinë morale të gjyqtarit për t’u ngritur në detyrë. Ashtu si për magistratët në detyrë, edhe për gjyqtarët për magistratë procesi shtrihet si për sjelljet e mbajtura gjatë ushtrimit të detyrave të ndryshme ashtu edhe jashtë tyre, pasi synimi është të mos përfshihen në organet e drejtësisë persona me të cilët nuk garantohet ruajtja dhe forcimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe profesioni ligjor. Natyrisht KLGj-ja në çdo rast ka për detyrë që në vlerësimin e rasteve individuale të përdorë kujdesin maksimal dhe të mbajë një standard jo vetëm të lartë por edhe të njëjtë vlerësimi, me qëllim që procesi të jetë transparent, i besueshëm dhe shpresësjellës për subjektet e përfshira, por edhe për publikun.<sup>180</sup>

Brenda konceptit të verifikimit të figurës përfshihet edhe kriteri tjetër i parashikuar nga neni 32 për moskualifikimin e kandidatëve kur kanë “*ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit*”. Me parashikimin e një rregulli pengues në një nënparagraf të veçantë (shkronja c), duket sikur ligjvënësi kërkon të bëjë një dallim nga shkaqet përjashtuese të sipërcituara. Përdorimi nga ligjvënësi i termave “tjetër” dhe “të njohur” në formulimin e kësaj fraze, duket se është tej shkaqeve të parashikuara në nenin 28 dhe 32 të ligjit nr. 96/2016. Ky formulim e ka lënë të hapur mundësinë e mospranimit të kandidatit për çdo shkak tjetër ligjor që mund të vërtetohet përpara përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë. Megjithatë, shprehja “të parashikuar sipas ligjit”, nuk i jep diskrecion KLGJ në këtë drejtim. Kjo nënkupton se vërtetimi i çdo shkakut tjetër skualifikues, në kuptim të parashikueshmërisë dhe sigurisë ligjore, do të ketë të bëjë vetëm me shkaqe përjashtuese,

179. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

180. Vendimi nr. 00-2022-4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



që parashikohen nga ligji dhe që janë të lidhura me integritetin.

Nisur nga kjo analizë, nuk përjashtohet mundësia që një nga kriteret, të cilin kandidati e ka përmbushur në momentin e fillimit të procedurës, të vlerësohet më vonë si një shkak përjashtues, në rast se në momentin e pranimit në formimin fillestar, vërtetohet si i tillë. Si p.sh., dënimi me vendim penal të formës së prerë, apo vërtetimi i një dokumenti si i falsifikuar, mund të përfshihen në këtë koncept. Në rast se vërtetohet një nga shkaqet përjashtuese, pas procesit të verifikimit nga KLGj-ja, por përpara miratimit të renditjes së kandidatëve është e kuptueshme që do të vendoset mospranimi i tij/saj.<sup>181</sup>

## **B) Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjore**

### **a) Kushtet ligjore**

Në këtë seksion Metodologjia do të shpjegojë se cilat janë kushtet ligjore që duhet të përmbushin gjyqtarët që konkurrojnë për pozicionin e kryetarit të një gjykate të shkallës së parë ose të apelit (përfshi edhe gjykatat e posaçme) dhe se çfarë konkretisht duhet monitoruar për të kuptuar nëse kandidatët që konkurrojnë i plotësojnë apo jo kushtet e kërkuara nga ligji. Objekti i monitorimit është organizuar sipas 3 skenarëve të promovimit në postin e kryetarit të shpjeguar më lart.

**Skenari 1:** Për plotësimin e vendit vakant të kryetarit në gjykatën e shkallës së parë ose të apelit (përfshi edhe gjykatat e posaçme) përmes rizgjedhjes së kryetarit ekzistues, Ligji kërkon që kandidati të plotësojë 4 (katër) kushtet që tregohen në tabelën e mëposhtme<sup>182</sup>:

**Tabela 39**

<i>Kandidati është kryetar në detyrë</i>	<i>Kandidati rikandidon</i>	<i>Kandidati është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin e fundit</i>	<i>Kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë</i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin (ose jo) të këtyre 4 (katër) kushteve ligjore.

181. Sokol Sadushi, "Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës". Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>

182. Kandidatët që nuk plotësojnë qoftë edhe 1 nga 4 kushtet e treguara në tabelë përjashtohen nga konkurrimi.

**Skenari 2:** Për plotësimin e vendit të kryetarit në gjykatën e shkallës së parë ose të apelit (përfshi edhe gjykatat e posaçme) përmes procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në po këto gjykata, Ligji kërkon që kandidatët të plotësojnë 8 (tetë) kushtet që tregohen në tabelën e mëposhtme<sup>183</sup>:

**Tabela 40**

<i>Kryetari ekzistues nuk kandidon, nuk mund të kandidojë ose nuk lejohet të kandidojë</i>	<i>Kandidati është gjyqtar në gjykatën ku krijohet vakanca</i>	<i>Kandidati ka të paktën 7 vjet përvojë si gjyqtar</i>	<i>Kandidati ka punuar të paktën 4 vjet në një shkallë të gjyqësorit</i>	<i>Kandidati është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit</i>	<i>Kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi</i>	<i>Kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGj-së në 3 vitet e fundit</i>	<i>Kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë</i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin (ose jo) të këtyre 8 (tetë) kushteve ligjore.

**Skenari 3:** Për plotësimin e vendit të kryetarit në gjykatën e shkallës së parë ose të apelit (përfshi edhe gjykatat e posaçme) përmes procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në gjykata të tjera, Ligji kërkon që kandidatët të plotësojnë 10 (dhjetë) kushtet që tregohen në tabelën e mëposhtme<sup>184</sup>:

**Tabela 41**

<i>Kryetari ekzistues nuk kandidon, nuk mund të kandidojë ose nuk lejohet të kandidojë</i>	<i>Në organikën e gjykatës ku hapet vendi i kryetarit ka të paktën 1 vakancë të përherëshme<sup>185</sup></i>	<i>Kandidati është gjyqtar në gjykatën ku krijohet vakanca ose në një gjykatë tjetër</i>	<i>Kandidati ka të paktën 7 vjet përvojë si gjyqtar</i>	<i>Kandidati ka punuar të paktën 4 vjet në një shkallë të gjyqësorit</i>	<i>Kandidati është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në 2 vlerësimet e fundit</i>	<i>Kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi</i>	<i>Kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGJ në 3 vitet e fundit</i>	<i>Kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë</i>	<i>Kandidati nuk është në situatën e papajtuëshmërisë ambientale</i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

183. Kandidatët që nuk plotësojnë qoftë edhe 1 nga 8 kushtet e treguara në tabelë përjashtohen nga konkurrimi.

184. Kandidatët që nuk plotësojnë qoftë edhe 1 nga 10 kushtet e treguara në tabelë përjashtohen nga konkurrimi.

185. Psh. nëse KLGj-ja ka vendosur që në gjykatën X do të punojnë 12 gjyqtarë, por numri real i gjyqtarëve në gjykatën X është 11, kjo do të thotë që në këtë gjykatë ka një vakancë. N.q.s. kjo vakancë zgjat për një periudhë të paktën 5-mujore (nga 2 muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë deri në 3 muaj pas përfundimit të mandatit të tij) ajo do të konsiderohet e përherëshme. Në këtë rast, ligji lejon që për pozicionin e kryetarit të kësaj gjykate të konkurrojnë gjyqtarë nga gjykata të tjera. Në të kundërtën, nëse organika e një gjykate është e plotë, vetëm gjyqtarët e asaj gjykate mund të konkurrojnë për pozicionin e kryetarit.

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin (ose jo) të këtyre 10 (dhjetë) kushteve ligjore

**TË DHËNA SHITESË:** Përveç monitorimit të kushteve të treguara nga 3 tabelat / skenarët e mësipërm, objekti i monitorimit për respektimin (ose jo) e kushteve ligjore për ngritje në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës do të përfshijë edhe aspektet e mëposhtme:

- Periudha e monitorimit (p.sh. 1 janar deri 30 mars 2018);
- Numri i vendeve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;
- Pozicionet konkrete të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;
- Numri i gjyqtarëve të rizgjedhur ose ngritur në detyrë (sipas 3 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e gjyqtarëve që kanë kandiduar për pozicionet e lira;
- Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 3 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e pozicioneve të lira;
- Numri i kandidatëve për çdo pozicion;
- Numri i kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë;
- Numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet);
- Rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave

**Të dhënat shitesë** hidhen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 42**

<i>Periudha e monitorimit</i>	<i>P.sh. 1 janar deri 30 mars 2018</i>
<i>Numri i vendeve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit</i>	<i>P.sh. 23 / 9</i>
<i>Pozicionet konkrete të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;</i>	<i>P.sh. 3 pozicione në apel Tiranë – 1 pozicion në apel Tiranë</i>
<i>Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 4 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e gjyqtarëve që kanë kandiduar për pozicionet e lira;</i>	<i>P.sh. 10 - 50</i>
<i>Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë (sipas 4 skenarëve të treguar më lart) në raport me numrin e pozicioneve të lira;</i>	<i>P.sh. 10 – 10 ose 10 - 8</i>
<i>Numri i kandidatëve për çdo pozicion;</i>	<i>P.sh. 50 për pozicionin në gjykatën e apelit Tiranë</i>
<i>Numri i kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë;</i>	<i>P.sh. 13</i>

<i>Numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet);</i>	<i>P.sh. 3</i>
<i>Rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave</i>	<i>P.sh. 2 vendime rrëzimi, 1 vendim pranimi</i>

### ***b) Metoda e mbledhjes së të dhënave për kushtet ligjore***

Në paragrafët që vijojnë Metodologjia përcakton metodën konkrete që do të përdoret nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse kushtet e kërkuara nga ligji për rizgjedhjen e kryetarëve ose ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të apelit (përfshi edhe gjykatat e posaçme) janë respektuar apo jo nga KLGj-ja.

Në vijim, lënda është organizuar në përputhje me 3 (tre) skenarët e rizgjedhjes / promovimit të parashikuar nga ligji për këtë tip promovimi (*shih* përkufizimin në faqe 70 të Guidës).

#### **Skenari 1 – Gjyqtari që ushtron funksionin e kryetarit në një gjykatë të shkallës së parë ose të apelit<sup>186</sup> rizgjidhet në pozicionin e kryetarit**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 1, Kushti 1** (*kandidati është kryetar në detyrë në atë gjykatë civile, penale, administrative ose të posaçme të shkallës së parë ose të dytë*) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ/ REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 1, Kushti 2** (*kandidati rikandidon*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 1, Kushti 3** (*kandidati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e fundit të performancës si gjyqtar dhe kryetar*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 1, Kushti 4** (*kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ.

#### **Skenari 2 – Gjyqtari që ushtron funksionin në gjykatën në të cilën pozicioni i kryetarit bëhet vakant<sup>187</sup> caktohet (promovohet) në pozicionin e kryetarit të gjykatës**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 1** (*kryetari ekzistues nuk kandidon, nuk mund të kandidojë ose nuk lejohet të kandidojë*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;

186. Fjala është për të gjitha gjykatat (përfshi edhe gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar)

187. Këtu përfshihen edhe gjyqtarët e deleguar pranë kësaj gjykate.

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 2** (*kandidati është gjyqtar në gjykatën ku pozicioni i kryetarit bëhet vakant*) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ/ KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 3** (*kandidati ka të paktën 7 vjet përvojë si gjyqtar*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 2, Kushti 4** (*kandidati ka punuar të paktën 4 vjet në një shkallë të gjyqësorit*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 5** (*kandidati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit të performancës*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 6** (*kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 7** (*kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGj-së në 3 vitet e fundit*) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 2, Kushti 8** (*kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ.

### **Skenari 3 – Gjyqtari që ushtron funksionet në një gjykatë tjetër<sup>188</sup> caktohet (promovohet) në pozicionin e kryetarit të gjykatës**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 1** (*kryetari ekzistues nuk kandidon, nuk mund të kandidojë ose nuk lejohet të kandidojë*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 2** (*në organikën e gjykatës ku hapet vendi i kryetarit ka të paktën një vakancë të përhershme*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 3** (*kandidati është gjyqtar në gjykatën ku krijohet vakanca ose në një gjykatë tjetër*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 4** (*kandidati ka të paktën 7 vjet përvojë si gjyqtar*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;

188. Në këtë kategori futen edhe gjyqtarët e komanduar.

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenarin 3, Kushti 5** (*kandidati ka punuar të paktën 4 vjet në një shkallë të gjyqësorit*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 6** (*kandidati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit të performancës*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 7** (*kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 8** (*kandidati nuk ka qenë anëtar i KLGJ në 3 vitet e fundit*) – KONSULTIM I FAQES ZYRTARE TË KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Skenari 3, Kushti 9** (*kandidati kalon me sukses verifikimin e figurës dhe të pasurisë*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR ILDKPKI DHE KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Situatën 3, Kushti 10** (*kandidati nuk është në situatën e papajtueshmërisë ambientale*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ / REGJISTRI I GJYQTARËVE / FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT.

### **c) Metoda për mbledhjen e të dhënave shtesë:**

Metodat e përdorura nga monitoruesi për mbledhjen e të dhënave shtesë (shih më lart) do të përfshijnë:

- Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së;
- Informacion zyrtar nga KLGj-ja;
- Informacion zyrtar nga gjykata që shqyrton mosmarrëveshjet;
- Intervista eventuale me gjyqtarët që kandidojnë.

### **ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për kriteret ligjore.**

1. Sa është numri i kryetarëve që u ka mbaruar mandati i parë dhe aplikojnë për një mandat të dytë?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

2. Sa prej këtyre kryetarëve në detyrë që aplikojnë për një mandat të dytë, kanë një vlerësim

si të performancës si kryetar?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

3. Sa është numri i kryetarëve që u ka mbaruar mandati i parë dhe që nuk aplikojnë për një mandat të dytë?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

4. Sa është numri i gjyqtarëve që aplikojnë për kryetar gjykatë për çdo gjykatë që është shpallur ky konkurrim?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

5. Ka raste të gjyqtarëve që aplikojnë nga jashtë gjykatës, për të cilën është shpallur pozicioni për kryetar gjykatë?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

6. Sa prej kandidatëve gjyqtarë që aplikojnë për pozicionin e kryetarit të gjykatës, kanë vlerësim të performancës si gjyqtarë?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

7. Sa prej kandidatëve që aplikojnë për ngritje në detyrë, kanë të disa vlerësim të performancës?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

8. Sa prej kandidatëve që kanë aplikuar kanë masa disiplinore në fuqi?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve;*

9. Sa prej kandidatëve që kanë aplikuar kanë masa disiplinore të shuara?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve;*

10. Sa prej kandidatëve kanë qenë në të shkuarën anëtar të KLGj-së?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së/regjistri i gjyqtarëve;*

11. Sa prej kandidatëve kanë kaluar procesin e vlerësimit të pasurisë?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar ILDKPKI dhe KLGj-së;*



12. Sa prej kandidatëve kanë kaluar procesin e vlerësimit të figurës?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së, BKH-së, AKSIK-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme;*

13. Numri pozicioneve të lira për kryetar gjykatë, të shkallës së parë dhe të dytë, në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*

14. Numri i kryetarëve të emëruar në raport me numrin e pozicioneve të lira?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*

15. Numri i kandidatëve për çdo pozicion;

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*

16. Numri i kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë;

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/Vendimet e KLGj-së për periudhën në monitorim.*

17. Numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet);

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/ Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar GjAA-së.*

18. Rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Faqja zyrtare e internetit të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/ Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar GjAA-së.*

## MODULI II

### PROCEDURA E EMËRIMIT TË GJYQTARËVE NË POZICIONIN E KRYETARIT TË GJYKATËS

#### **A) Procedura e zgjedhjes së kryetarit**

Para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 96/2016, kryetarët e gjykatave emëroheshin sipas ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar, i cili në nenet 16 dhe 17 parashikonte kritere në lidhje me emërimin, kohëzgjatjen në detyrë dhe ripërtëritjen e një mandati të dytë të kryetarit të gjykatave të shkallëve të para dhe apeleve. Emërimi i kryetarëve bëhej nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë sipas procedurës së parashikuar në vendimin nr. 227/2 datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në Gjykata”, përmes kritereve të paqarta dhe të pamjaftueshme për të garantuar transparencë dhe objektivitet në përzgjedhjen, si dhe duke mos parashikuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit. Kështu ligji i ri ofron garanci më të shumta në këtë drejtim duke i vlerësuar si pozicione karriere pozicionet për kryetar gjykate.<sup>189</sup>

Legjislacioni në fuqi, parashikon se mundësia për të qenë kryetar gjykate i jepet fillimisht kryetarëve në detyrë, të cilët janë në përfundim të mandatit të parë. Këta gjyqtarë kanë të drejtë të rizgjidhen vetëm një herë për një mandat tjetër trevjeçar. Në rast se kryetari në detyrë nuk shfaq interes për rikandidim, ose nuk përzgjidhet nga KLGj-ja atëherë procedura rihapet për të gjithë gjyqtarët e asaj gjykate që kanë qëllim për t’u bërë kryetar, në atë gjykatë sipas kërkesave ligjore. Në vijim po japim procedurën e zgjedhjes së kryetarit të gjykatës, duke ndjekur këto hapa.

#### **a) Rizgjedhja e kryetarit në detyrë**

Procedura e emërimit të kryetarit të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, qofshin këto të juridiksionit të përgjithshëm, apo të gjykatave të posaçme dhe të specializuara është e dedikuar fillimisht për kryetarët në detyrë, nëse janë në përfundim të mandatit të parë. Në rast se kryetari në detyrë është në përfundim të mandatit të dytë, ai nuk ka më të drejtë që të rizgjedhet dhe procedura është e hapur për kandidatët e tjerë.

Në këtë rast (pra për kryetarin në detyrë, në përfundim të mandatit të parë), neni 52 § 2 e Ligjit nr. 96/2016 parashikon se ai ka të drejtë që të rikandidojë. Në këtë rast procedura fillon

---

189. Manjola Xhaxho, “Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 52 – Emërimi i kryetarëve të tjerë”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/52>

jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë. Nëse kryetari në detyrë nuk e shpreh këtë interes, atëherë ai konsiderohet se është tërhequr nga gara dhe nuk mundet që të rikandojë më, kur KLGj-ja e hap procedurën për gjyqtarët e tjerë.

Në këtë rast, kryetari kur rikandidon i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga KLGj-ja, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në pikat nga 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit nr. 96/2016.

Nëse kryetari në detyrë kalon me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës, si edhe vlerësohet për veprimtarinë si kryetar dhe gjyqtar, të paktën “shumë mirë”. KLGj-ja merr vendim jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit.

Pra, duke qenë se procedura duhet të nisë jo më vonë se 6 muaj para mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë dhe të përfundojë jo më vonë se tre muaj mbas mbarimit të mandatit, rezulton se KLGj-ja ka në total 9 muaj kohë për realizimin e kësaj procedure.

### **b) Zgjedhja e kryetarit nga radhët e gjyqtarëve**

Në rast se kryetari në detyrë është në përfundim të mandatit të dytë, nëse refuzon të riakandidojë në përfundim të mandatit të parë, ose nëse rikandidon por nuk plotëson kriteret (dështon në procesin e verifikimit të pasurisë, apo të figurës, ose nuk vlerësohet të paktën “shumë mirë” për veprimtarinë si kryetar dhe gjyqtar), atëherë KLGj-ja publikon shpalljen për vendin e lirë për pozicionin e kryetarit për kandidatët që i plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë, jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë.

Thirrja për aplikim u drejtohet gjyqtarëve në gjykatën përkatëse. Pra, si rregull, pozicioni për kryetar në atë gjykatë hapet vetëm për gjyqtarët pjesë e asaj gjykate.

Megjithatë, ligji nr. 96/2016, në nenin 52 § 7 të tij parashikon gjithashtu se në rast se në gjykatën, një pozicion bëhet në mënyrë të përhershme i lirë nga dy muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit deri në tre muaj pas mbarimit të tij, thirrja për kandidim i drejtohet çdo magjistrati që plotëson kriteret për kryetar. Pra, në këtë rast magjistrati që kandidon është jashtë gjykatës apo prokurorisë ku shpallet vendi vakant i lirë për magjistrat dhe kryetar njëkohësisht.<sup>190</sup>

Me vijimin e procedurave shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të KLGj-së dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

- a) afatin e aplikimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;
- b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet aplikimit;
- c) procedurën e aplikimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.<sup>191</sup>

190. Manjola Xhaxho, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 52 – Emërimi i kryetarëve të tjerë”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/52>

191. Ligji nr. 96/2016, neni 52 § 8.

Me depozitim e aplikimeve, KLGj-ja vlerëson në rast se kandidati i plotëson kriteret të parashikuara në nenin 47 § 6, si edhe kryen verifikimin e pasurisë dhe figurës, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit nr. 96/2016.

### ***c) Verifikimi i pasurisë***

Në lidhje me verifikimin e pasurisë, duke iu referuar normave ligjore, në mungesë të akteve nënligjore, rezulton se brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, KLGj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, KLGj-ja kërkon informacion shtesë nga këto institucione dhe subjekte.

Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e KLGj-së për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga vetë KLGj-ja në kërkesat e saj.

Në çdo rast KLGj-ja çmon, sipas bindjes së saj, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

KL Gj-ja vendos që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë kur burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Përmendja në mënyrë specifike e ILDKPKI-së, prej të cilave KLGj-ja merr raportet, mbi të cilat vlerësohen çështjet që lidhen me pasurinë, duket sikur i jep një rol vendimtar këtij organi të specializuar gjatë këtij procesi.

Por asnjë organ vendimmarrës nuk mund të jetë i pakontrollueshëm për mënyrën se si e ushtron veprimtarinë hetimore administrative dhe për vlefshmërinë e veprimeve që kryen. I gjithë ky proces që përfundon me vendimmarrjen e KLGj-së është një verifikim, nga e para, që i bëhet pasurisë dhe figurës së gjyqtarit. Për shkak të qenies së këtij procesi verifikues, është e kuptueshme që ILDKPKI-ja merr rol të rëndësishëm mbi verifikimin e pasurisë së gjyqtarit, por vendimmarrja e saj nuk mund të jetë e pavlerësueshme nga KLGj-ja, që është i ngarkuar nga ligji për të vendosur përfundimisht mbi këtë çështje.

KL Gj-ja është organ i parashikuar nga Kushtetuta, i ngarkuar për të hetuar, shqyrtuar dhe për të gjykuar përfundimisht mbi pasurinë e një gjyqtari. Përderisa, KLGj-ja kryen hetimin administrativ për gjyqtarin, kërkon informacion shtesë nga institucionet e specializuara, apo edhe mund të thërrasë një ekspert të fushës, kur lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e gjyqtarit, nga gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga organet e administratës

tatimore dhe doganore, nuk përjashtohet dhënia prej tyre e një vlerësimi të ndryshëm nga konkluzionet e organeve ekzekutive të specializuara.

Ky raport bashkëpunimi ndërinstytucional duket sikur krijon një problematikë, për sa i përket respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve, në aspektin e rrezikut për një ndërhyrje të institucioneve të pushtetit ekzekutiv ndaj organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Por, parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve është i garantuar përderisa KLGj-ja, sipas nenit 32 të ligjit 96/2016, do të kenë kontrollin e plotë të këtij procesi dhe, nëse është e nevojshme, mundësinë të përcaktojnë edhe modalitete të tjera të bashkëpunimit me organet ekzistuese, rast pas rasti. Neni 32 i jep shprehimisht KLGj-së kompetenca të gjera për t'i hetuar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas fjalisë së fundit të pikës 2 të kësaj dispozite ligjore, është KLGj-ja ato që kur e çmojnë të nevojshme, mund *“të kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.”* Edhe detyrimi i organeve ekzekutive për të përmbushur kërkesat e KLGj-së, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 32 është në këtë linjë të arsyetimit se bashkëpunimi institucional mbetet synimi kryesor për përmbushjen e misionit për të cilin janë ngarkuar nga ligji, por pa cenuar vendimmarrjen përfundimtare që i mbetet KLGj-së si organ kushtetuese.

Edhe në procedurën administrative të verifikimit të pasurisë ka një set të gjerë kompetencash që i janë dhënë KLGj-së, në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë për verifikimin e pasurisë së gjyqtarëve që kërkojnë ngritjen në detyrë. Rregullat e parashikuara nga KPA për zhvillimin e procedurës administrative plotësohen në mënyrë harmonike me parashikimet ligjore të ligjit nr. 96/2016, ligjit nr. 115/2016, si dhe të vendimit nr. 75/2019 të KLGj-së. Kështu, neni 97 § 3 i ligjit nr. 115/2016 parashikon se *“Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”*, ndërsa vendimi nr. 75/2016 i KLGj-së, parashikon se ky vendim interpretohet dhe zbatohet në përputhje me KPA. Rëndësia e ndjekjes së standardeve të procesit të rregullt ligjor gjatë veprimtarisë administrative shfaqet që në nenin 1 të KPA-së, ku parashikohet se *“Ky kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.”*

Që në nisjen e procedurës administrative organi publik u kërkon subjekteve të interesuara kryerjen e të gjitha veprimeve të domosdoshme që nevojiten për të garantuar efikasitetin e procesit. Gjatë zhvillimit të procedurës administrative, organi publik ka për detyrë të sigurojë që të gjitha palët e përfshira në proces *“të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”* (neni 10 i KPA).

Me qëllim garantimin e zhvillimit të një hetimi të plotë, në referim të KPA-së, KLGj-ja ka autoritet të plotë në funksion të kërkimit të provës. Neni 80 i KPA-së ka parashikuar se, *“1. Me qëllim përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët; b) të marrë dokumente dhe*

*dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) të vizitohet dhe të kontrollojë mallrat apo vendet e përfshira. 2. Dispozitat e parashikuara për ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. 3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.” Neni 80/2 i KPA-së referon tek ligji nr. 49/2012 për provat dhe mjetet e provës, të lejuara në procedurën administrative dhe, si rrjedhojë, në mënyrë komplementare (në referim të nenit 1 § 2 të ligjit) edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, mbi burimet e provës, për aq sa është e mundur. Në këtë linjë arsyetimi është edhe parashikimi i pikës 12, të kreut IV të vendimit nr. 75/2019 të KLGj-së (siç u theksua më lart), për thirrjen e ekspertit nga ana e KLGj-së, për të dhënë shpjegime në mbledhjen e KLGj-së.*

Në procedurën administrative të verifikimit të pasurisë që ndjek KLGj-ja, raporti i ILDKPKI-së është vetëm një ndër instrumentet ndihmëse të KLGj-së, në funksion të realizimit të procedurës administrative të vlerësimit. ILDKPKI-ja është organ i specializuar, në funksion të kontrollit të pasurisë së funksionarëve publikë, raporti përfundimtar i të cilit vlerësohet nga KLGj-ja së bashku me të gjitha provat e tjera, të marra gjatë procedurës administrative, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, si më sipër. Përfundimet e këtij raporti nuk kanë vlerë të paracaktuar në procesin e të provuarit dhe as prevalencë në raport me provat e tjera, të marra gjatë procedurës administrative nga ana e KLGj-së.

Ligji ka autorizuar një organ kushtetues, KLGj-në, si i vetmi organ përgjegjës, me kapacitetin e duhur profesional dhe me integritetin e nevojshëm, i pajisur me të gjitha mjetet ligjore, në kuadër të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të thelluar të pasurisë për të vlerësuar në mënyrë të drejtë, harmonike, të pavarur dhe diskrecionare të gjitha provat e mbledhura gjatë procedimit administrativ dhe për të konkluduar në mënyrë përfundimtare në funksion të verifikimit të pasurisë së gjyqtarit.<sup>192</sup>

Procedura e mësipërme ngarkon me barrën e provës gjyqtarin që kandidon për ngritje në detyrë, i cili duhet të ketë parasysh parashikimet e ligjit nr. 96/2016, konkretisht neni 32 i tij, mbi kontrollin e pasurisë, ku gjyqtari i nënshtrohet verifikimit të plotë të pasurisë dhe është i detyruar të deklarojë të gjitha veprimet juridike të kryera prej tij që kanë lidhje me pasurinë duke argumentuar çdo transaksion financiar me qëllim fitimi, si dhe burimin e krijimit të të ardhurave që kanë lidhje me këto transaksione, pa asnjë kufizim në kohë.<sup>193</sup>

Megjithëse në procesin e vlerësimit të pasurisë, gjyqtari që ka kandiduar për ngritjen në detyrë ka barrën e provës gjatë procedurave administrative dhe gjyqësore për të provuar pretendimet e saj, nga ana tjetër, KLGj-ja ka detyrimin për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, nëpërmjet kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me synim respektimin e parimit të kontradiktoritetit, parimit të barazisë së mjeteve dhe pasjes

192. Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

193. Vendimi nr. 00-2022-4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



së një arsyetimi për vendimmarrjen.<sup>194</sup>

Pra, rregulli i mësipërm mbi barrën e provës nuk e shmang KLGj-në nga detyrimi për të zhvilluar një hetim të pavarur, në kuadër të vlerësimit të pasurisë, për sa kohë gjyqtari përmbush detyrimet për bashkëpunim me KLGj-në. Ligjvënësi i ka dhënë KLGj-së autoritetin e nevojshëm që në procedurën administrative të verifikimit të pasurisë të kryejë hetime administrative të pavarura, në funksion të verifikimit të plotë të situatës faktike të pasurisë së gjyqtarit, përveç rasteve kur vetë kërkuesi refuzon të plotësojë ose të depozitojë pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaratës së pasurisë ose nëse refuzohet prej tij nënshkrimi dhe depozitimi i autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë. Ligji nr. 96/2016 e ka ngarkuar KLGj-në me detyrimin për të hetuar në mënyrë të plotë dhe të pavarur për provat që paraqiten prej palës kërkuese gjatë procedurës administrative.<sup>195</sup>

Në këtë rast KLGj-ja duhet të marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret mbi kuptimin që ka parimi i proporcionalitetit. Zbatimi i këtij parimi nuk është gjë tjetër veçse një diskrecion (mundësi) që i njihet KLGj-së në marrjen e vendimit përfundimtar për rastin konkret, pa u kufizuar në gjetjet e organeve të specializuara.

Tashmë praktika është konsoliduar në lidhje me këtë parim, sipas së cilit veprimtaria administrative e kryer nga organet publike është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: **a) i nevojshëm** për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës, **b) i përshtatshëm** për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj dhe **c) në përpjesëtim** të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. Në këtë procedurë KLGj-ja duhet të mbajë në konsideratë edhe zhvillimin historik dhe situatën ekonomike në që ka ekzistuar në vendin tonë.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit derivon paligjshmërinë e aktit administrativ referuar përcaktimeve të nenit 109, shkronja “e” të Kodit të Procedurës Administrative që sanksionon se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse... nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.”*<sup>196</sup>

KL Gj-ja vendos që gjyqtari që kandidon nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur:

- burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij;
- nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato;
- në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

194. Vendimi nr.00-2021-1435, datë 23.09.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

195. Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

196. Vendimi nr. 00-2021-1435, datë 23.09.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



### **ç) Procedura e verifikimit të figurës**

Për sa i përket verifikimit të figurës, referuar parashikimeve ligjore, në mungesë të akteve nënligjore, rezulton se brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, KLGj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, KLGj-ja kërkon informacion shtesë nga këto institucione dhe subjekte.

Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e KLGj-së për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga vetë KLGj-ja në kërkesat e saj.

Në çdo rast KLGj-ja çmon, sipas bindjes së saj, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

KL Gj-ja vendos që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të figurës kur:

- kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;
- ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor;
- ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.<sup>197</sup>

Por asnjë organ vendimmarrës nuk mund të jetë i pakontrollueshëm për mënyrën se si e ushtron veprimtarinë hetimore administrative dhe për vlefshmërinë e veprimeve që kryen. I gjithë ky proces që përfundon me vendimmarrjen e KLGj-së është një verifikim, nga e para, që i bëhet figurës së gjyqtarit. Për shkak të qenies së këtij procesi verifikues, është e kuptueshme që organet ekzekutive të specializuara marrin një rol të rëndësishëm mbi verifikimin e pasurisë dhe të figurës së gjyqtarit, por vendimmarrja e tyre nuk mund të jetë e pavlerësueshme nga KLGj-ja, të cilat janë ngarkuar nga ligji për të vendosur përfundimisht mbi këtë çështje.

KL Gj-ja është organ i parashikuar nga Kushtetuta, i ngarkuar për të hetuar, për të shqyrtuar dhe për të gjykuar përfundimisht mbi pasurinë dhe figurën e një gjyqtari. Përderisa, KLGj-ja kryen hetimin administrativ për gjyqtarin, kërkon informacion shtesë nga institucionet e specializuara, apo edhe mund të thërrasin një ekspert të fushës, kur lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e gjyqtarit, nga gjetjet dhe përfundimet e organeve të specializuara, nuk përjashtohet

---

197. Ligj nr. 96/2016, neni 32, pika 4/1.

dhënia prej tyre e një vlerësimi të ndryshëm nga konkluzionet e organeve ekzekutive të specializuara. Pushteti i KLGj-së për të vlerësuar raportet e organeve shtetërore të specializuara si BKH apo ShISh dhe për të vendosur përfundimisht mbi pasurinë dhe figurën e gjyqtarit evidentohet edhe nga vetë rregullimi që gjendet në aktet normative të nxjerra nga KLGj-ja. Pikërisht, marrja në konsideratë e rrethanave të rastit konkret mbi kuptimin që ka parimi i proporcionalitetit, nuk është gjë tjetër veçse një diskrecion që i njihet KLGj-së në marrjen e vendimit përfundimtar për rastin në shqyrtim, pa u kufizuar vetëm në gjetjet e organeve të specializuara.

Ky raport bashkëpunimi ndërinstytucional duket sikur krijon një problematikë, për sa i përket respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve, në aspektin e rrezikut për një ndërhyrje të institucioneve të pushtetit ekzekutiv ndaj organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Parimi i ndarjes dhe i balancimit ndërmjet pushteteve është i garantuar përderisa KLGj-ja, sipas nenit 32 të ligjit 96/2016, do të ketë kontrollin e plotë të këtij procesi dhe, nëse është e nevojshme, mundësinë të përcaktojnë edhe modalitete të tjera të bashkëpunimit me organet ekzistuese, rast pas rasti. Neni 32 i jep shprehimisht KLGj-së kompetenca të gjera për t'i hetuar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas fjalisë së fundit të pikës 2 të kësaj dispozite ligjore, është KLGj-ja ajo që kur e çmon të nevojshme, mund "të kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë." Edhe detyrimi i organeve ekzekutive për të përmbushur kërkesat e KLGj-së, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 32 është në këtë linjë të arsyetimit se, bashkëpunimi institucional mbetet synimi kryesor për përmbushjen e misionit për të cilin janë ngarkuar nga ligji, por pa cenuar vendimmarrjen përfundimtare që i mbetet KLGj-së si organe kushtetuese.<sup>198</sup>

Në rastin e kontrollit të figurës cilësitë që kërkohet të ketë një gjyqtar duhet të jenë të kulluara dhe vlerësimi i informacioneve në lidhje me sjelljen e gjyqtarit në të shkuarën, shihet në raport me kriterin "verifikim figure" sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, i cili synon të verifikojë cilësitë e nevojshme "morale" të gjyqtarit. Ky nuk është gjykim penal, por administrativ, i cili në vetvete nuk i heq ndonjë të drejtë gjyqtarit që kandidon për t'u ngritur në detyrë, por nuk ia jep një të tillë (bazuar në kritere meritokracie, ku futet edhe vlerësimi i cilësive më të larta morale), në ato raste kur gjyqtari nuk gjendet me figurë morale të përshtatshme, sipas standardeve më të mira etike dhe ligjore që duhet të mishërojë jo vetëm një qytetar shembullor, por edhe një jurist i mirë.

Në lidhje më këtë, rezulton se verifikimi i "figurës" sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, shoqërohet me nevojën për të përzgjedhur dhe lejuar që të vazhdojnë rrugën për t'u ngritur në detyrë vetëm atyre personave që plotësojnë cilësitë më të larta morale në shoqëri. Ndaj, jo vetëm sjellja që personi mban pasi fiton të drejtën për t'u ngritur në detyrë, por edhe ajo e mëparshmja, i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit. KLGj-ja nëpërmjet këtij procesi që kryen, vlerëson jo vetëm qenien apo jo i dënuar (si dhe çdo të dhënë që disponojnë organet e ndjekjes penale, pavarësisht fundit të saj procedural), por shkon deri te verifikimi i shkeljeve të mundshme disiplinore në punë që mund të ketë pasur në të shkuarën gjyqtari,

198. Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

të cilat në vetvete mund të duken të shkëputura nga veprimtaria e ardhshme e tij, por që mund të nxjerrin në pah, rrethana që ndikojnë në përshtatshmërinë morale të gjyqtarit që kërkon të ngrihet në detyrë. Ky verifikim shtrihet si për sjelljet e mbajtura gjatë ushtrimit të detyrave të ndryshme ashtu edhe jashtë tyre, pasi synimi është të mos përfshihen në organet e drejtësisë persona me të cilët nuk garantohet ruajtja dhe forcimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe profesioni ligjor. Natyrisht KLGj-ja në çdo rast ka për detyrë që në vlerësimin e rasteve individuale të përdorë kujdesin maksimal dhe të mbajë një standard jo vetëm të lartë, por edhe të njëjtë vlerësimi, me qëllim që procesi të jetë transparent, i besueshëm dhe shpresësjellës për subjektet e përfshira, por edhe për publikun.

Shpeshherë ndaj gjyqtarëve në detyrë bëhen kallëzime penale dhe ankesa pranë ILD-së. Këto veprime në vetvete nuk paragjykojnë pozitën e gjyqtarit, pasi askush nuk mund të kontrollojë veprimet e të tjerëve që mund të zgjedhin të paraqesin kallëzim apo ankesë, porse në kuadër të vlerësimit moral të cilësive të nevojshme për t'u ngritur në detyrë, të lidhura edhe me kriterin e pasurisë, mund ta çojnë KLGj-në që të vlerësojë papërshtatshmërinë e gjyqtarit për t'u ngritur në detyrë. Pra, fakti se këto kallëzime penale janë pushuar (ose vendosur mosfillim) nga prokuroria apo gjykata, apo ankesat janë pushuar nga ILD-ja nuk janë përcaktues për çështjen. Kjo sepse këto materiale shihen në raport me rastet e evidentuara gjatë verifikimit të figurës së gjyqtarit, që lidhen me veprimet e gjyqtarit ndaj të tretëve dhe që mund të konsistojnë në kërcënimet e pretenduara verbale, kërcënime këto të bëra për motive të dobëta dhe aspak të ligjshme, të cilat tregojnë për sjellje në kundërshtim të hapur me normat e moralit shoqëror dhe, aq më tepër, me standardet etike dhe morale të gjyqtarëve.

Në këto raste nuk mund të ngrihen pretendimet se cenohet parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi integriteti dhe morali i gjyqtarit nuk kanë nevojë për vendim penal të formës së prerë, apo procedim disiplinor nga ILD, për t'u provuar, por provohet nga fakte dhe rrethana të cilat kanë ndodhur dhe të cilat në rastin konkrete provohen nga aktet zyrtare të institucioneve.<sup>199</sup>Kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga ligji ose nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.

#### **d) Vlerësimi si gjyqtar**

Siç e kemi përmendur në Modulin 1, ku trajtuam kriteret që një gjyqtar të emërohet si kryetar, duhet që të jetë vlerësuar si i tillë, të paktën *“shumë mirë”*. Për të realizuar këtë vlerësim KLGj-ja mbështetet, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 96/2016, në këto burime:

- a) dosja personale e magjistratit;
- b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji;
- c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara;

199. Vendimi nr. 00-2022-4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- c) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve të hartuara dhe të përzgjedhura prej gjyqtarit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit;
- d) mendimi i kryetarit;
- dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit;
- e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit në veprimtaritë trajnuese;
- ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;
- g) kundërshtimet e gjyqtarit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit.<sup>200</sup>

Të gjitha burimet kanë vlerën dhe peshën e tyre specifike duke qëndruar në krahasim të njëri-tjetrit. Tërësia dhe shumëllojshmëria e burimeve mundëson krijimin e një panorame të qartë dhe objektive për të analizuar të gjitha kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 të Ligjit nr. 96/2016.<sup>201</sup> Parashikimi i mësipërm ligjor synon që të vendosë përballë KLGj-së burime të sakta dhe të matshme për vlerësimin e gjyqtarëve. Për rrjedhojë, vlerësimi duhet të jetë objektiv dhe sa më i paanshëm. Kjo synon që të rrisë dhe besueshmërinë në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, e parë dhe nga këndvështrimi i gjyqtarit, përcaktimi i këtyre burimeve rrit besueshmërinë që vlerësimi i tyre është i unifikuar për të gjithë.

Gjyqtari vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar. Gjyqtari vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.<sup>202</sup>

Neni 97, germa “a”, e ligjit nr. 115/2016 parashikon se KLGj-ja, në ushtrim të funksioneve të saj, nxjerr akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të magjistratëve. Ky akt individual, i emërtuar “vendim”, përmban bazën ligjore të vendimmarrjes dhe dispozitivin, ndërkohë që raporti i vlerësimit i anëtarit relator, i miratuar edhe nga anëtarët

200. Ligji nr. 96/2016, neni 77.

201. Aulona Hazbiu, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 77 – Burimet e vlerësimit”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/77>

202. Ligji nr. 96/2016, neni 84 §§ 1 dhe 2.

e tjerë të Këshillit, është pjesë përbërëse e vendimit, në formën e një dokumenti që i bashkëngjitet vendimit, që përbën edhe pjesën arsyetuese të këtij akti, pavarësisht se përmes një dokumenti më vete. Më konkretisht, sipas nenit 69 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet që aktvlerësimi i magjistratit (raporti i vlerësimit të miratuar), si pjesë përbërëse e vendimit, arsyetohet. Edhe në rastet kur anëtarët e KLGj-së nuk janë dakord, në çdo rast vendimi është i arsyetuar.

Nga ana tjetër, nenet 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 parashikojnë me detaje procedurën e fillimit të vlerësimit të magjistratit dhe ecurinë e këtij procesi lidhur me *përgatitjen e dokumentacionit* (neni 89), *krijimin e dosjes së vlerësimit* (neni 90), *përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim* (neni 91), *informacionin nga institucione të tjera* (neni 92) dhe *projektraportin e vlerësimit nga relatori* (neni 93). Në nenin 94 të këtij ligji parashikohet e drejta e gjyqtarit për të kundërshtuar projektraportin e vlerësimit të hartuar nga relatori dhe një sërë të drejtash lidhur me respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, të cilat përfshijnë njoftimin e gjyqtarit për projektraportin e vlerësimit, informimin për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit, kundërshtimin me shkrim të projektraportit të vlerësimit brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit, paraqitjen e provave të reja dhe dëgjimin gjatë seancës dëgjimore në KLGj. Po ashtu, në nenin 95 § 2, të ligjit nr. 96/2016 parashikohet shtyrja e seancës nga ana e KLGj-së, nëse gjatë shqyrtimit të vlerësimit konstatohen gabime procedurale ose materiale, ose nëse nevojiten prova të tjera. Në pikat 3 dhe 4 të nenit 95 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet edhe vendimi për vlerësimin e KLGj-së, i cili merret pasi shqyrtohet projektraporti i vlerësimit dhe duke u bazuar në përfundimet e seancës dëgjimore. KLGj-ja vendos të miratojë projektraportin e vlerësimit nga anëtari relator dhe në rastet kur anëtarët e tij nuk janë dakord, parashikohet miratimi i këtij projektraporti me ndryshime ose hartimi i një projektraporti të ri nga anëtari relator. Kur KLGj-ja vlerëson gjyqtarin me një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projektraportin e vlerësimit, në ligj parashikohet pasqyrimi i arsyeve përkatëse në vendim.<sup>203</sup>

#### ***dh) Vlerësimi si kryetar***

Një tjetër vlerësim që aplikohet, por që shtrihet vetëm për kryetarët në detyrë që duan të kandidojnë, është edhe vlerësimi tij si kryetar i gjykatës, pozicion për të cilin ai/ajo po rikandidon përsëri. Në këtë rast, sipas nenit 82 të Ligjit nr. 96/2016, burimet e vlerësimit janë:

- a) dosja personale e kryetarit;
- b) vlerësimi i kryer nga kryetari, i cili përmbush, në mënyrë të njëjtë, kriteret e vlerësimit të kryer nga magjistrati;
- c) raportet vjetore të kryetarit, ku pasqyrohen të dhënat e veprimtarisë financiare dhe procesverbalet e mbledhjeve vjetore të analizës së gjykatës, si dhe raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit në këto mbledhje, duke përfshirë edhe regjistrimin audio;
- ç) çdo urdhër ose vendim i kryetarit, i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për

203. Vendimi nr. 133, datë 22.11.2021 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

- organizimin e gjyqtarëve ose të administratës gjyqësore;
- d) të dhëna statistikore për funksionimin e gjykatës ose prokurorisë në pesë vitet e fundit;
- dh) raportet e inspektimit të gjykatës nga institucionet shtetërore;
- e) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të kryetarit me publikun dhe të tretët;
- ë) mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të prokurorisë ku ushtron funksionin kryetari i gjykatës;
- f) informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e kryetarit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e gjykatës;
- g) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj kryetarit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit;
- gj) vendime përfundimtare për masa disiplinore, për shkak të pozicionit të kryetarit, të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- h) kundërshtimet e kryetarit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit.<sup>204</sup>

Neni 82 nëpërmjet renditjes në mënyrë të detajuar të burimeve të vlerësimit synon të përcaktojë burime të qarta për një vlerësim objektiv dhe të paanshëm të veprimtarisë së kryetarëve, sipas parashikimeve në nenet 79 deri 81 të Ligjit për Statusin. Vlera e burimit lidhet me informacionin që përcjell/njofton. Tërësia dhe shumëllojshmëria e burimeve mundëson marrjen e një informacioni të plotë për të krijuar një panoramë të qartë dhe objektive me qëllim analizimin e të gjitha kriterëve të vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit të parashikuara në nenin 79 të Ligjit për Statusin.

Renditja e burimeve ka vlerë të shumëfishtë. Së pari, i vlen kryetarit të gjykatës pasi për herë të parë në ligj (dhe jo në akt nënligjor), burimet e vlerësimit janë të mirëpërcaktuara, të qarta dhe të unifikuara për të gjithë titullarët e gjykatave në sistem. Përcaktimi i burimeve të vlerësimit përbën garanci dhe siguri ç’ka i jep procesit të vlerësimit më shumë besueshmëri. Në të njëjtën kohë, ligjvënësi synon t’i vendosë organit vlerësues kufijtë ligjorë të burimeve të vlerësimit. Vendosja e këtyre kufijve është e rëndësishme për të garantuar respektimin e parimit të pavarësisë së magjistratit (neni 69, shkronja “a”) të Ligjit për Statusin). Seti i burimeve i parashikuar në ligj, rrit besueshmërinë dhe transparencën për sistemin e vlerësimit të titullarëve të gjykatës në tërësi.<sup>205</sup>

204. Ligji nr.96/2016, neni 82.

205. Aulona Hazbiu, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 82 – Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarëve”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/82>



Kryetari vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit si kryetar. Në çdo rast, veprimtaria e kryetarit vlerësohet nga Këshilli të paktën gjashtë muaj para përfundimit të këtij mandati.

## **B) Objekti i monitorimit për procedurat**

### **a) Hapat e procedurës**

Në këtë seksion, Metodologjia do të shpjegojë se cila është procedura e parashikuar nga ligji për ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit dhe se çfarë konkretisht duhet monitoruar për të kuptuar nëse respektohet apo jo procedura e kërkuar nga ligji (dhe nëse kryhen verifikimet e duhura) për plotësimin e vendeve vakante të kryetarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit.

Informacioni është organizuar sipas llojit të procedurës të ndjekur nga KLGj-ja për plotësimin e vendit vakant (shih seksionin II.5.3 më lart)

**Procedura 1:** Për plotësimin e vendeve vakante të kryetarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit përmes procedurës së rizgjedhjes, Ligji kërkon të kryhen 4 (katër) hapat e procedurës dhe verifikimet që tregohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 43**

<i>Jo më vonë se 6 muaj nga mbarimi i mandatit të parë, kryetari në detyrë shpall rikandidimin</i>	<i>KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit brenda 1 jave nga rikandidimi</i>	<i>KL Gj-ja kryen verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit (si dhe të kushteve të tjera) jo më vonë se 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë</i>	<i>KL Gj-ja riemëron kryetarin jo më vonë se 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë</i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për kryerjen (ose jo) të këtyre 4 (katër) hapave proceduralë dhe verifikimeve.

**Procedura 2:** Për plotësimin e vendeve vakante të kryetarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit përmes procedurës së ngritjes në detyrë, Ligji kërkon të kryhen 7 (shtatë) hapat e procedurës dhe verifikimet që tregohen në tabelën e mëposhtme:



**Tabela 44**

<i>Kryetari ekzistues nuk kandidon, nuk mund të kandidojë ose nuk lejohet të kandidojë</i>	<i>KL Gj-ja shpall vakancën jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë</i>	<i>Vakanca shpallet të paktën në faqen zyrtare të KL Gj-së</i>	<i>Shpallja e vakancës përmban informacionin e kërkuar nga ligji<sup>206</sup></i>	<i>Afati për kandidimin është të paktën 2 javë nga data e shpalljes së vakancës</i>	<i>KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga kandidimi</i>	<i>KL Gj-ja verifikon plotësimin e kushteve dhe shpall listën e kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm<sup>207</sup></i>
<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>	<i>PO / JO</i>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për kryerjen (ose jo) të këtyre 7 (shtatë) hapave proceduralë dhe verifikimeve.

**TË DHËNA SHITESË:** Përveç monitorimit të hapave proceduralë dhe verifikimeve të treguara në tabelat nr. 43 dhe 44 (më lart), objekti i monitorimit për kryerjen (ose jo) e hapave proceduralë dhe verifikimeve për ngritje në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës do të përfshijë edhe aspektet e mëposhtme:

- Numri i pozicioneve që plotësohen përmes procedurës së rizgjedhjes;
- Numri i pozicioneve që plotësohen përmes procedurës së ngritjes në detyrë;
- Numri i kandidatëve për çdo pozicion që plotësohet përmes procedurës së ngritjes në detyrë.

#### ***b) Metoda e mbledhjes së të dhënave për monitorimin e procedurave***

Në paragrafët që vijojnë, Metodologjia përcakton metodën konkrete që do të përdoret nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse

206. Neni 43/4 i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve urdhëron që shpallja të përcaktojë qartë: (i) afatin e kandidimit; (ii) dokumentacionin që kandidati duhet t’ia bashkëngjisë aplikimit; (iii) procedurën e kandidimit dhe (iv) vendin ku duhet dorëzuar aplikimi. N.q.s. shpalljes i mungon qoftë edhe një nga këto elemente vlerësimi i monitoruesit për këtë pikë do të jetë negativ.

207. Ligji nuk parashikon shprehimisht një afat brenda të cilit KL Gj-ja duhet të kryejë verifikimin nëse kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore për ngritje në detyrë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se procesi i verifikimit përfshin komunikimin shkresor me ILDKPKIKI-në për verifikimin e pasurisë së kandidatit, me Byronë Kombëtare të Hetimit (ose Shërbimin Informativ Shtetëror) për verifikimin e figurës së kandidatit (shih nenet 48/7 dhe 32/2-7 të ligjit të statusit) dhe çdo organ tjetër që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit në të shkuarën, si dhe duke pasur parasysh se afati maksimal ligjor për plotësimin e pozicionit vakant është 3 muaj nga data e shpalljes së vakancës (shih nenin 48/2 të ligjit të statusit), për qëllimet e kësaj Metodologjie do të konsiderohet afati i arsyeshëm për verifikimin e kushteve të kandidimit 30 ditë nga data e dorëzimit të dosjes së kandidimit.

KL Gj-ja ka kryer procedurat dhe verifikimet e kërkuara nga ligji për zgjedhjen e kryetarëve (qoftë përmes rizgjedhjes, qoftë përmes ngritjes në detyrë). Informacioni është organizuar në përputhje me 2 llojet e procedurës që përdoren nga KL Gj-ja për plotësimin e vendeve vakante të kryetarëve të gjykatave (shih seksionin II.5.3 në faqe 77 të Guidës).

#### *Procedura 1 - Rizgjedhja:*

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 1/Verifikimi 1** (*Jo më vonë se 6 muaj nga mbarimi i mandatit të parë kryetari në detyrë shpall rikandidimin*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KL GJ / KËRKESË PËR INFORMACION ZYRTAR DREJTUAR KL GJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 1 /Verifikimi 2** (*KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga rikandidimi*) – KËRKESË PËR INFORMACION ZYRTAR DREJTUAR KL GJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 1/Verifikimi 3** (*KL Gj-ja kryen verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit (si dhe të kushteve të tjera) jo më vonë se 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë*) – KËRKESË PËR INFORMACION ZYRTAR DREJTUAR KL GJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 1/Verifikimi 4** (*KL Gj-ja riemëron kryetarin jo më vonë se 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KL GJ / KËRKESË PËR INFORMACION ZYRTAR DREJTUAR KL GJ.

#### *Procedura 2 – Ngritja në detyrë:*

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2/Verifikimi 1** (*Kryetari ekzistues nuk kandidon, nuk mund të kandidojë ose nuk lejohet të kandidojë*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KL GJ / KËRKESË PËR INFORMACION ZYRTAR DREJTUAR KL GJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2/Verifikimi 2** (*KL Gj-ja shpall vakancën jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KL GJ / KËRKESË PËR INFORMACION ZYRTAR DREJTUAR KL GJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2/Verifikimi 3** (*vakancat shpallen të paktën në faqen zyrtare të KL Gj-së*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KL GJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2/Verifikimi 4** (*shpallja e vakancës përmban informacionin e kërkuar nga ligji*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KL GJ;

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2/Verifikimi 5** (*kandidatëve ju jepet të paktën 2 javë kohë për të përgatitur aplikimin*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2/Verifikimi 6** (*KL Gj-ja kërkon raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës brenda 1 jave nga kandidimi*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Procedura 2 /Verifikimi 7** (*KL Gj-ja verifikon plotësimin e kushteve nga kandidatët dhe shpall listën e kandidatëve të kualifikuar brenda një afati të arsyeshëm*) – KONSULTIM PERIODIK I FAQES ZYRTARE TË KLGJ DHE KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

### ***c) Metoda e mbledhjes së të dhënave shtesë***

Metodat e përdorura nga monitoruesi për mbledhjen e të dhënave shtesë (shih më lart) do të përfshijnë:

- Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së;
- Informacion zyrtar nga KLGj-ja;

Intervista eventuale me gjyqtarët që kandidojnë.

### ***ç) Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedura ligjore.***

1. Kanë rikandiduar kryetarët në detyrë të gjykatave për një mandat të dytë, jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së.*

2. Është mbyllur procedura deri në tre muaj mbas përfundimit të mandatit të kryetarit të gjykatës që rikandidon?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së/Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së/*

3. Sa pozicione për kryetar janë shpallur për gjyqtarët e tjerë për të gjithë periudhën e monitorimit?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*

4. Janë publikuar shpalljet në faqen zyrtare të Internetit të KLGj-së.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*

5. Janë publikuar shpalljet sipas kërkesave ligjore.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*

6. A ka respektuar shpalljet afati 2-javor, nga momenti i publikimit deri në momentin e mbylljes së afateve të aplikimit?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;*

7. Numri i kandidimeve është i barabartë ose më i madh se numri i vakancave të shpallura.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

8. Ka dërguar KLGj kërkesat për informacion brenda afatit 1-javor nga momenti i mbylljes së aplikimeve për ngritjes në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatave?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

9. Ka verifikuar KLGj-ja plotësimin e kushteve dhe ka shpallur listën e kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së.*

## MODULI III

### MËNYRA E RENDITJES SË GJYQTARËVE QË KANË KANDIDUAR PËR KRYETAR GJYKATE TË SHKALLËS SË PARË DHE TË DYTË

Për kandidatët që kanë përmbushur kriteret, KLGj-ja bën renditjen e tyre. Normalisht, shqyrtimi dhe përzgjedhja e kandidatit nga KLGj-ja bëhet sipas rezultateve të dala nga dy vlerësimet e mëparshme të magjistratit. Pra, në këtë rast dallimi do të bëhet midis vlerësimit “shkëlqyeshëm” dhe “shumë mirë”.

Por në rastet kur ka më shumë kandidatë me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në këtë pikë duhet theksuar se ky këshill ende nuk ka miratuar me akte nënligjore këtë skemë pikësh.

Në rast se edhe pas vlerësimit me sistem pikësh ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, KLGj-ja rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.

Në rast se përsëri ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat.

#### ***A) Objekti i monitorimit për renditjen e kandidatëve***

Për renditjen e kandidatëve ndiqen deri në tri faza, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 52 pika 9, të ligjit për statusin, si dhe të detajuara më poshtë në këtë metodologji.

Faza pasuese e renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të fazës paraardhëse nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

KLGj-ja i rendit kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

- a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme;
- b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 10, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
- c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “b”, të pikës 10, të këtij neni,

ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magistrat.<sup>208</sup>

### Faza 1:

Në fazën e parë, renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Në rastet e më shumë kandidatëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.<sup>209</sup>

**Tabela 45**

<i>Emri</i>	<i>Rezultati i vlerësimit të fundit profesional të kandidatit</i>	<i>Rezultati i vlerësimit të parafundit profesional të kandidatit</i>
<i>Pikët</i>	<i>Shkëlqyeshëm; Shumë mirë<sup>210</sup></i>	<i>Shkëlqyeshëm; Shumë mirë<sup>211</sup></i>

Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave dhe renditjes së tyre sipas kritereve të treguara në tabelën nr. 45, KLGj-ja ngre në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës të shkallës së parë ose të apelit gjyqtarin që ka dy vlerësimet e mëparshme më të larta, ose në rastin e kandidatëve me të njëjtin nivel vlerësimi, gjyqtarin që ka marrë numrin më të madh të pikëve.<sup>212</sup>

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin e kritereve të treguar në tabelën nr. 45, si dhe për saktësinë e pikëzimit të kandidatëve nga KLGj-ja.

**Faza 2:** Në qoftë se në përfundim të fazës së parë të shqyrtimit dhe renditjes së kandidaturave, ka më shumë se një gjyqtar me pikët më të larta (p.sh. 2 gjyqtarët që renditen të parët kanë pikë të barabarta nga 100 secili), KLGj-ja shqyrton dhe rendit më tej kandidaturat sipas kriterit të përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.

**Tabela 46**

<i>Emri</i>	<i>Pikët pas fazës së parë të vlerësimit</i>	<i>Kohëzgjatja (në vite) e përvojës profesionale specifike</i>
<i>Kandidati 1</i>	<i>P.sh. 100</i>	<i>P.sh. 7 vjet</i>
<i>Kandidati 2</i>	<i>P.sh. 100</i>	<i>P.sh. 5 vjet</i>

208. Ligji nr. 96/2016, neni 52, pika 10.

209. Sillet në vëmendje që KLGj-ja nuk ka miratuar rregulla të detajuara për (a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magistratëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për matjen e aftësive organizative dhe drejtuese; c) procedurën që ndiqet në rastin e rezultateve të barabarta, sipas përcaktimit të pikës 12, të nenit 52, të ligjit për statusin.

210. Monitoruesi rrethon/shënon alternativën sipas rastit.

211. Monitoruesi rrethon/shënon alternativën sipas rastit.

212. KLGj-ja do të miratojë rregulla për skemën e pikëve, në rastet e më shumë kandidatëve me të njëjtën nivel vlerësimi brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit.

Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave dhe renditjes së tyre sipas kriterit të përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë (shih tabelën nr. 46 më lart), KLGj-ja ngre në detyrë gjyqtarin që ka marrë numrin më të madh të pikëve (në këtë rast kandidatin 1 që ka përvojë specifike profesionale më të madhe).

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin e kriterit të përvojës profesionale specifike dhe për saktësinë e pikëzimit të kandidatëve nga KLGj-ja.

**Faza 3:** Në qoftë se në përfundim të fazës së dytë të shqyrtimit dhe renditjes së kandidaturave, ka më shumë se një gjyqtar me pikët më të larta (p.sh. 2 gjyqtarët që renditen të parët kanë pikë të barabarta nga 100 secili) KLGj-ja shqyrton dhe rendit më tej kandidaturat sipas kriterit të vjetërsisë si magjistrat sipas tabelës që vijon:

**Tabela 47**

<i>Emri</i>	<i>Pikët pas fazës së dytë të vlerësimit</i>	<i>Vjetërsia (në vite) si magjistrat</i>
<i>Kandidati 1</i>	<i>P.sh. 100</i>	<i>P.sh. 20 vjet</i>
<i>Kandidati 2</i>	<i>P.sh. 100</i>	<i>P.sh. 15 vjet<sup>213</sup></i>

Në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave dhe renditjes së tyre sipas kriterit të vjetërsisë si magjistrat (shih tabelën nr. 47 më lart) KLGj-ja ngre në detyrë gjyqtarin që ka marrë numrin më të madh të pikëve (kandidatin 1).

**KUJDES:** Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin e kriterit të vjetërsisë si magjistrat dhe për saktësinë e pikëzimit të kandidatëve nga KLGj-ja.

**TË DHËNA SHITESË:** Përveç monitorimit të të dhënave (tabelat nr. 45 , 46 dhe 47), objekti i monitorimit për renditjen e kandidatëve në *procedurën e ngritjes në detyrë në postin e kryetarit* do të përfshijë edhe aspektet e mëposhtme:

- Renditja e kandidatit në çdo pozicion që ai ka kandiduar dhe arsytet e diferencës në renditje, nëse ka;<sup>214</sup>
- Arsytet e diferencimit të kandidatëve, të cilët kanë rezultuar me pikë të barabarta, duke përfshirë edhe ndryshime të fundit të akteve nënligjore të Këshillit, nëse ka.

213. KLGj-ja do të miratojë rregulla për pikëzimin e kriterit të vjetësisë si magjistrat.

214. Në bazë të nenit 48/6 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se 3 pozicione të lira. Në këtë rast kandidati bën renditjen e tyre sipas preferencës.



## ***B) Metoda e mbledhjes së të dhënave për renditjen e kandidatëve***

Në paragrafët që vijojnë, Metodologjia përcakton metodën konkrete që do të përdoret nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse KLGj-ja ka zbatuar kriteret e parashikuara nga ligji për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për pozicionin e kryetarit të gjykatës të shkallës së parë dhe të apelit.

Në vijim, lënda është organizuar në përputhje me 3 (tri) fazat e shqyrtimit dhe të renditjes së kandidatëve siç tregohet në tabelat 45, 46 dhe 47 të kësaj Metodologjie.

### **Faza I – KLGj-ja shqyrton dhe rendit kandidaturat sipas kriterëve të përparësisë të sipërpërmendur**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Kriteri 1** (*rezultatet e vlerësimit të fundit të kandidatëve*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ OSE ILD<sup>215</sup>;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 1, Kriteri 2** (*rezultatet e vlerësimit të parafundit të kandidatëve*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ OSE ILD.

### **Faza II – KLGj-ja shqyrton dhe rendit kandidaturat sipas kriterit të përvojës profesionale specifike (treguar në tabelën 46)**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 2, Kriteri 1** (*rezultatet e kandidatëve pas përfundimit të fazës së parë janë të barabarta*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 2, Kriteri 2** (*kohëzgjatja në vite e përvojës profesionale specifike*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ.

### **Faza II – KLGj-ja shqyrton dhe rendit kandidaturat sipas kriterit të vjetërsisë si gjyqtar (treguar në tabelën 47)**

- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 3, Kriteri 1** (*rezultatet e kandidatëve pas përfundimit të fazës së dytë janë të barabarta*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;
- Metoda e mbledhjes së të dhënave për **Fazën 3, Kriteri 2** (*vjetërsia si gjyqtar*) – KËRKESË ZYRTARE PËR INFORMACION DREJTUAR KLGJ;

---

215. Në rast se kandidati është inspektor në ILD.

**C) Monitorimi i indikatorëve të performancës për procedurën e renditjes së kandidatëve.**

1. Në rastin kur konkurrimi për t'u emëruar kryetar gjykatë ka qenë për gjyqtarët, ka pasur kandidatë që në fazën I kanë qenë me pikë të barabarta.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

2. Si janë vlerësuar kandidatët bazuar në vitet e përvojës profesionale specifike?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

3. Ka pasur kandidatë që në fazën III kanë qenë me pikë të barabarta.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;*

4. Si janë vlerësuar kandidatët bazuar në vjetërsinë e tyre si gjyqtar?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave - Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së.*

## MODULI IV

### ANKIMIMI GJYQËSOR

#### **A) Llojet e ankimit**

Në fazat e ndryshme të shqyrtimit të procedurës së ngritjes në detyrë, gjyqtari që mendon se është penalizuar nga vendimmarrja e KLGj-së, ka të drejtë që të ankohet gjyqësisht.

Faza ankimore mund të jetë e ndryshme. Kështu, nëse gjyqtari është skualifikuar nga KLGj-ja për shkak se nuk ka kaluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe/apo të figurës, në bazë të nenit 100 § 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka të drejtë që të ankohet në Gjykatën Administrative të Apelit e cila në këtë rast ka juridiksion fillestar.

Në këtë rast gjen zbatim parashikimi i nenit 32 § 6 të ligjit nr. 96/2016, titulluar, “Verifikimi i pasurisë dhe figurës”, parashikon procedurën që ndjek KLGj-ja dhe të drejtën e ankimi ndaj vendimmarrje së saj. Me ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.05.2021, neni 32 ka ndryshuar në pikën 6 të tij me formulimin se “*Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. **Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë.**”*

Pra, në këtë rast krahas qenies së vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit të formës së prerë, ligjvënësi ka përcaktuar që është dhe përfundimtar. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, më së tepërmi, përafron me një vendim me forcë ekzekutive se sa me një vendim, i cili ka fituar statusin e gjësë së gjykuar. Një vendim gjyqësor i formës së prerë, në çdo rast, është një vendim gjyqësor me fuqi ekzekutive, por jo domosdoshmërisht konsiderohet si një vendim përfundimtar, sepse ligji ka parashikuar formën e prerë të vendimeve të gjykatave të apelit, pavarësisht se ato mund të rekursohen në rrugë të zakonshme ankimi pranë Gjykatës së Lartë, e cila brenda juridiksionit të saj ligjor eventualisht edhe mund të ndryshojë vendimmarrjen, ndonëse tashmë të ekzekutuar. Kjo do të thotë që në këto raste, vendimi përfundimtar (final) është vendimi i kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë (në rastet kur ushtrohet ankimi) dhe jo vendimi i gjykatës së apelit, i cili është bërë i ekzekutueshëm.

I ndryshëm paraqitet rasti kur një vendimi gjyqësor i është dhënë statusi i një vendimi “*përfundimtar dhe të formës së prerë*”. Sidoqoftë, një vendim gjyqësor është final kur ka natyrën e një vendimi përfundimtar dhe, për rrjedhojë, ka fituar fuqinë e *res judicata*, sipas nenit

451/a të KPC. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar këto mjete ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa ushtruar ankim.

Në praktikën gjyqësore është konsoliduar qëndrimi, se një vendim gjyqësor i formës së prerë është menjëherë i ekzekuteshëm, por jo domosdoshmërisht ka efektet e gjësë së gjykuar (*res judicata*). Përkundrazi, në rastet kur një vendim gjyqësor është “i formës së prerë” dhe i shtohet gjithashtu edhe termi “përfundimtar”, kjo do të thotë se ky vendim, jo vetëm është menjëherë i ekzekutueshëm, por se ndaj tij nuk ka asnjë mjet të zakonshëm ankimi, për arsye se natyra e tij finale/përfundimtare pengon gjykimin nga një gjykatë më e lartë, përveç rishikimit të vendimit. Pikërisht, natyra tepër e veçantë e çështjeve apo rasteve, për të cilat ligjvënësi ka parashikuar se “vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë”, është në funksion të shmangies së gjendjes së pasigurisë, e cila nuk mund të vijojë pafundësisht.

Kjo qasje e ligjvënësit lidhet edhe me faktin se veprimtaria administrative e ushtruar nga KLGj-ja është *quasi gjyqësore* dhe ankimi i ushtruar në juridiksion fillestar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda shkaqeve strikte ligjore, si edhe afateve tepër të shkurtra, përmbillet me një vendim final dhe të paankimueshëm në rrugë të zakonshme ankimi gjyqësor. Për rrjedhojë, kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, në këto raste nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.<sup>216</sup>

Afati ankimor në këtë lloj gjykimi është 5-ditor. Pra, brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të KLGj-së, gjyqtari që është skualifikuar për moskalimin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, nëse nuk është dakord duhet të paraqesë padi në Gjykatën Administrative të Apelit. Rregullat procedurale që ndjek Gjykata Administrative e Apelit në këtë rast, janë të njëjta me gjykimin administrativ në shkallë të parë, por çështja shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Ajo që duhet theksuar është se gjyqtari mund të paraqesë prova të tjera edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht se nuk i ka paraqitur ato më parë gjatë procedurës administrative në KLGj. Kjo do të thotë që e drejta e gjyqtarit për të paraqitur prova dokumentare në favorin e tij nuk bien në dekadencë nëse nuk i paraqet gjatë shqyrtimit administrativ. Kjo qasje lidhet me argumentin se vetë KLGj-ja do të duhej të bënte një hetim administrativ më të thelluar dhe të kërkonte vetë nga institucionet publike dhe private çdo informacion të domosdoshëm, me qëllim sqarimin përfundimtar të të gjitha problematikave për të cilat kishte dyshime. Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit.<sup>217</sup>

Në rastin kur gjyqtari që kandidon nuk është dakord me vlerësimin e tij të performancës si gjyqtar, Ligji nr. 96/2016, në nenin 95 § 7 të tij parashikon se *Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit, në gjykatën kompetente, brenda 15-ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.*

216. Vendimi nr. 00 – 2022 – 656, datë 11.04.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

217. Sokol Sadushi, “Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 41 – Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/41>

Pra, gjyqtari që nuk është dakord me vlerësimin e tij, nuk ka të drejtë që të ankohet për thelbin e vlerësimit, por vetëm nëse në procesin e vlerësimit që ka bërë KLGj-ja ka pasur shkelje procedurale.

Ky kufizim i kësaj të drejte lidhet me faktin se neni 147/a i Kushtetutës nuk përmban rregullim ose delegim të shprehur për ligjvënësin lidhur me ushtrimin e kompetencave që ushtron KLGj-ja për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve. Kushtetuta e përcakton vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve si kompetencë ekskluzive të KLGj-së, duke mos e deleguar atë tek asnjë organ tjetër, qoftë edhe ai gjyqësor.

Referuar bazës kushtetuese dhe ligjore, rezulton se KLGj-ja përmbush të gjitha kërkesat që të klasifikohet si një organ *quasi gjyqësor*. Sipas nenit 147 § 2, të Kushtetutës, KLGj-ja përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor, ndërsa 5 i zgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, anëtari i KLGj-së ka statusin e magjistratit, sipas rregullave të parashikuara nga ligji nr. 96/2016 dhe gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Të gjithë anëtarët e KLGj-së u nënshtrohen kriterëve të përzgjedhjes, të përcaktuara në mënyrë të hollësishme në ligjin nr. 115/2016.

Pra, KLGj-ja është organ i parashikuar nga Kushtetuta, që synon të sigurojë pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, ndërkohë që në nenin 147/a të saj, janë përcaktuar kompetencat e këtij organi.

Në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këtyre organeve, sipas Kushtetutës anëtarët e KLGj-së e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhje (*neni 147 § 10, i Kushtetutës*). Në nenet 147/b dhe 147/c të Kushtetutës parashikohen rastet e mbarimit të mandatit të anëtarit të KLGj-së dhe ato të përgjegjësisë disiplinore. Më konkretisht, sipas nenit 147/c të Kushtetutës, anëtarët e KLGj-së shkarkohen nga detyra, në rast të kryerjes së shkeljeve të rënda disiplinore, me vendim të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa në periudhën tranzitore kjo është kompetencë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të (*neni 179 § 7, i Kushtetutës*).

Për rrjedhojë, duke pasur në konsideratë kriteret e emërimit të anëtarëve të KLGj-së, parashikimin e shkaqeve të shkarkimit dhe përcaktimi i procedurës së shkarkimit në Kushtetutë dhe në ligj, si dhe garancitë objektive në ushtrimin e veprimtarisë së tyre me pavarësi të plotë, përforcojnë sigurinë e palëvizshmërisë së tyre gjatë mandatit 5-vjeçar. Pra, qartazi KLGj-ja plotëson standardet e pavarësisë për të ushtruar këtë kompetencë, atë të vlerësimit të gjyqtarëve.

Sa më lart, parimet nga të cilat udhëhiqet procesi i vlerësimit të gjyqtarit, zhvillimi i procedurës së vlerësimit dhe garancitë e hollësishme që i njihen gjyqtarit gjatë kësaj procedure, si mundësia që të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe të mbrohet në respektim të parimit të barazisë së mjeteve dhe kontradiktoritetit, dhe në përfundim të kësaj procedure të ketë të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar, ofrojnë garancitë e nevojshme që kërkon e drejta për proces të rregullt ligjor.

Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme se vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarëve në aspektin substancial është parashikuar nga Kushtetuta në nenin 147/a si kompetencë ekskluzive e KLGj-së dhe se ky organ si *quasi gjyqësor* gjatë këtij procesi ndjek një procedurë *quasi gjyqësore*, rezulton se ushtrimi i kontrollit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve nga gjykata e apelit administrativ vetëm për shkelje të rënda procedurale, është një kufizim i arsyeshëm dhe nuk bie ndesh me dispozitat kushtetuese.<sup>218</sup>

I njëjti kufizim vlen edhe në rastin e vlerësimit të kryetarit në detyrë që kandidon për një mandat tjetër si kryetar i asaj gjykate.

Për sa i përket renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u ngritur në detyrë, në pozicionin e Kryetarit të Gjykatës, Ligji nr. 96/2016, në nenin 52 § 11 të saj parashikon se: *Këshilli cakton në funksionin e kryetarit kandidatin më të mirë të listuar. Rregullat e parashikuara në nenin 41 pikat 2 deri në 4, për caktimin e të emëruarve të rinj në pozicion aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.*

Norma në nenin 41 të ligjit nr. 96/2016 është përcaktuar si "*Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit*" (ndryshuar në vitin 2019) Pika e dytë e në vijim e dispozitës së mësipërme përcakton se, i emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë. Vendimi i Këshillit për caktimin e të emëruarit në pozicion, në përputhje me këtë nen, merr formë të prerë kur: a) nuk është depozituar ankim brenda afateve të ankimit; b) është depozituar ankim sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ose rrëzimin e ankimit; c) është depozituar ankim sipas afateve dhe mbi bazën e tij është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruarit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.<sup>219</sup>

Në thelb neni 41 § 2 dhe 3 i ligjit nr. 96/2016, është një dispozitë "kuadër" që zbatohet për emërimin e gjyqtarëve, procedurat e ngritjes në detyrë, lëvizjeve paralele, si dhe në raste të tjera të parashikuara shprehimisht prej ligjit.

E drejta e ankimit, si pjesë esenciale e një procesi të rregullt ligjor duhet të jetë sanksionuar në mënyrë të shprehur në ligj. Në nenin 41 § 2-4 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet vetëm se vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë dhe jo se është një vendim i formës së prerë dhe i paankimueshëm/i parekursueshëm dhe/ose përfundimtar. Në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile (neni 451 dhe 451/a), si edhe me praktikën e Kolegjit Administrativ (*shih vendimin nr. 00-2022-684, datë 17.03.2022*), kuptimi i përdorimit në ligj të togfjalëshit "formë e prerë" nuk mund të barazohet me vendimin përfundimtar/të parekursueshëm, për sa kohë kufizimi i rekursit nuk rezulton i shprehur qartë në ligj. Nuk

218. Vendimi nr. 133 datë 22.11.2021 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

219. Ligji nr.96/2016, neni 41, pikat 2-4.



mund të interpretohet në mënyrë teologjike dhe pa ekuivok se ligjvënësi ka pasur për qëllim kufizimin e të drejtës së ankimit (rekursit); për rrjedhojë aksesit në juridiksionin e Gjykatës së Lartë për këtë kategori vendimmarrjesh nuk mund të ndalohej. Një interpretim i kundërt i dispozitës, do kufizonte në mënyrë joproporcionale dhe të pacaktuar me ligj të drejtën e rekursit, mbi një mori vendimmarrjesh të tjera që lidhen me statusin e gjyqtarit.<sup>220</sup>

Pra, ndryshe nga rastet e kontrollit të pasurisë dhe figurës, ku vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe përfundimtar, që do të thotë që nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, në rastin e renditjes së gjyqtarëve, kandidatë për kryetar lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë.

Megjithatë në rast ankimi duhet theksuar se gjyqtari që kandidon për t'u bërë si kryetar ka të drejtën të ankohet vetëm për vlerësimin dhe renditjen e tij dhe jo të gjyqtarëve të tjerë që kandidojnë në të njëjtën procedurë.

Kjo do të thotë që për vendimet e KLGj-së ku disponohet skualifikimi i kandidatit për plotësimin e pozicionit të lirë për kryetar gjykatë, legjitimohet të ankohet dhe të ngrëjë padi në gjykatë vetëm gjyqtari ndaj të cilit KLGj-ja ka dhënë vendimin për skualifikimin nga procedura e ngritjes në detyrë. Pra, kandidatët e tjerë në konkurrim, për plotësimin e të njëjtit pozicion të lirë, si në fazën e verifikimit të kandidaturave, ashtu edhe në atë të vlerësimit finalizuar me vendimin për renditjen e kandidatëve të kualifikuar dhe të vlerësuar, nuk legjitimohen të ankohen në gjykatë për vendimet e kualifikimit apo të skualifikimit të kandidatëve të tjerë, apo t'i kërkojnë gjykatës që edhe në procesin e gjykimit të padisë për kundërshtimin e renditjes së kandidatëve, të konstatojë pavlefshmëri të vendimeve për kualifikimin e kandidatëve të tjerë. Padia për kundërshtimin e vendimit të renditjes dhe propozimit të emërimit të njërit prej kandidatëve (i renditur i pari), mund të motivohet si për shkaqe të lidhura me zbatimin e së drejtës procedurale, ashtu edhe materiale. Gjithsesi, meqenëse për fazën e kualifikimit dhe atë të vlerësimit, sikurse arsyetohet më sipër, ligji i posaçëm parashikon mjete dhe procedura të posaçme ankimi, në rastin e kundërshtimit të vendimit të KLGj-së për renditjen e kandidatëve, shkaqet e ankimit dhe të ngritjes së padisë për të cilat secili kandidat i renditur legjitimohet, janë vetëm ato të lidhura me motive që kanë të bëjnë me respektimin ose jo nga pala e paditur KLGj të kriterëve të parashikuara në pikën 10 të nenit 52 të ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, si edhe nga pika 12 e këtij neni, pra edhe për pretendime të lidhura me shkelje të akteve nënligjore normative të KLGj-së mbi kriteret dhe procedurat më të detajuara të renditjes së kandidatëve.

Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, KLGj, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim, bëhen publik në faqen zyrtare të internetit të KLGj-së.

---

220. Vendimi nr. 00-2022-2178, datë 06.10.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



## **B) Monitorimi i indikatorëve të shqyrtimit të ankimeve gjyqësore**

1. Sa ankime janë paraqitur në GjAA, kundër vendimeve të KLGj-së për periudhën e monitorimit?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*

2. I ka shqyrtuar GjAA, ankimet brenda periudhës 2-javore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*

3. Sa prej vendimeve të KLGj-së janë lënë në fuqi, apo janë shfuqizuar nga GjAA-ja?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*

4. Si ka vepruar KLGj-ja për zbatimin e vendimeve të GjAA-së?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*

5. Vendimet e KLGj-së për zbatimin e vendimeve të GjAA-së, janë ankimuar përsëri në gjykatë.

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së;*

6. Si ka vendosur GjAA-ja në rastin e kundërshtimit për së dyti të vendimeve të KLGj-së?

*Metoda e mbledhjes së të dhënave – Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe GjAA-së.*

## RASTE STUDIMORE

### Rasti 1

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 259, datë 17.11.2020, ka shpallur vendet e lira, për kryetar gjykatash, në Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe atyre në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar. Një ndër vendet e shpallura vakant për konkurrim ishte edhe pozicioni i kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë KLGj-së, në përfundim të procesit të verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve, i ka propozuar mbledhjes plenare të KLGj-së, zhvilluar në datën 17.12.2020, miratimin e listës së kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet ligjore. Me vendimin nr. 285, datë 17.12.2020, KLGj-ja ka miratuar listën e kandidatëve.

Kandidatët që plotësonin kushtet ligjore sipas vendimit të KLGj-së ishin gjyqtari A.K dhe gjyqtari A.Z. Pas verifikimeve të figurës dhe pasurisë së gjyqtarëve, KLGj-ja ka vendosur lejimin e gjyqtarëve A.K dhe A.Z.

Në përfundim KLGj-ja ka vendosur të listojë A.Z me *218 pikë* dhe A.K me *178 pikë*.

A.K vendos t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit duke kundërshtuar disa vendimmarrje që lidhen me listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore për të vijuar garën, duke kundërshtuar kualifikimin e kandidatit tjetër, me vlerësimin e tij dhe kundërshtimin e vlerësimit profesional të kandidatit tjetër, me renditjen dhe miratimin e listës së renditjes së kandidatëve.

### Pyetje

1. A legjitimohet A.K që t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit për të kundërshtuar pikëzimin që KLGj-ja i ka bërë A.Z?
2. A lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë ndaj një vendimi pranimi ose rrëzimi të Gjykatës Administrative të Apelit?

## ***Rasti 2***

Gjyqtari S.A ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës dhe është emëruar gjyqtar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastër në vitin 2006. Që prej vitit 2021 S.A ka qenë edhe zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ai e ka ushtruar detyrën e tij deri në shtatorin e vitit 2022, ku pas procedurës ***së ngritjes në detyrë*** ai ka filluar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në janar të vitit 2023 KL Gj-ja hap thirrjen për kryetar për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

### ***Pyetje***

1. A i plotëson kriteret ligjore S.A për të kandiduar për kryetar të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm?

## EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

### *Kushtetuta e Shqipërisë*

#### Neni 135

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.
3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.
4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

#### Neni 138

Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.

Neni 147/a

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;

### ***Ligj nr 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"***

#### **Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës**

1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31 të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast Këshillat çmojnë, sipas bindjes së tyre, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë.

6/1. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor rishikon vendimin në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

#### **Neni 41 – Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit**

2. I emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë.

3. Vendimi i Këshillit për caktimin e të emëruarit në pozicion, në përputhje me këtë nen, merr formë të prerë kur:

a) nuk është depozituar ankim brenda afateve të ankimit;

b) është depozituar ankim sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ose rrëzimin e ankimit;

c) është depozituar ankim sipas afateve dhe mbi bazën e tij është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë.

4. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruarit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

## Neni 47 – Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë

1. “Ngritja në detyrë” është kalimi nga:

a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;

b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;

c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie;

ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale:

a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.



6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse:

a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si:

i) përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit;

ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë;

iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit.

## Neni 52 – Emërimi i kryetarëve të tjerë

1. Mandati i Kryetarit të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Mandati i kryetarit të Prokurorisë së Posaçme është tre vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë. Kur kryetari nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar në fund të mandatit.

3. Kur kryetari në detyrë kandidon për riemërim, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli përkatës, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në pikat nga 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

4. Kryetari riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën “shumë mirë”.

5. Këshilli merr vendim jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit.

6. Në rastin kur kryetari jep dorëheqjen ose kur nuk i pranohet kërkesa për një mandat tjetër, Këshilli publikon shpalljen për vendin e lirë për pozicionin e kryetarit për kandidatët që i plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë, jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë.

7. Thirrja për aplikim u drejtohet magjistratëve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse. Në rast se në gjykatën ose prokurorinë përkatëse, një pozicion bëhet në mënyrë të përhershme i lirë nga dy muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit deri në tre muaj pas mbarimit të

tij, thirrja për kandidim i drejtohet çdo magjistrati që plotëson kriteret për kryetar. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme thirrja për kandidim për kryetar u drejtohet vetëm prokurorëve të kësaj prokurorie.

8. Në zbatim të pikës 7, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:

- a) afatin e aplikimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;
- b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet aplikimit;
- c) procedurën e aplikimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

9. Këshilli përkatës vlerëson në rast se kandidati i plotëson kriteret të parashikuara në pikën 6 të nenit 47. Ai kryen verifikim, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga ligji ose nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.

10. Këshilli shqyrton aplikimet dhe rendit kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

- a) së pari dy vlerësimet e mëparshme. Në rastet e më shumë kandidatëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 10, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
- c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “b”, të pikës 10, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat.

11. Këshilli cakton në funksionin e kryetarit kandidatin më të mirë të listuar. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, për caktimin e të emëruarve të rinj në pozicion aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

12. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

- a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi;
- b) kriteret për matjen e aftësive organizative dhe drejtuese;
- c) procedurën që ndiqet në rastin e rezultateve të barabarta.

## Neni 53 - Parimet e komandimit të magjistratëve

1. "Komandim" është lëvizja e magjistratit në një pozicion jomagjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë ose organizatë ndërkombëtare, pozicioni i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.
2. "Institucioni në të cilin magjistrati komandohet", për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, si dhe organizatat ndërkombëtare.
3. Me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të sapoemëruarve, magjistratët mund të komandohen vetëm me pëlqimin e tyre.
4. Magjistrati i komanduar ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo magjistrat tjetër, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.
5. Magjistrati nuk lejohet të komandohet në ato raste kur:
  - a) është në një pozicion me mandat të kufizuar;
  - b) është i komanduar.
6. Periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj.
7. Magjistrati duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas përfundimit të periudhës së komandimit.
8. Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij.
- 8/1. Magjistrati që komandohet në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në atë organizatë, gëzon të njëjtin status me diplomatët, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.
9. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria e shkallës së parë në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, llogaritet përvojë në profesion në shkallë të parë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria në shkallë të dytë, institucioni në të cilin magjistrati komandohet llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të dytë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magjistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese.
10. Magjistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet

për anëtarët e tjerë të këtij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimi njihen si nivele vlerësimi në kuptim të këtij ligji.

11. Magjistratit, të cilit nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, ka të drejtën të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidat jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim, me qëllim që të konkurrojnë në kushte të njëjta me magjistratët e tjerë për pozicionet e lira.

12. Magjistrati, gjatë komandimit, ka përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes te Këshilli. Në këtë rast Këshilli shqyrton çështjen dhe zbaton procedurën disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji. Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

13. Nëse çështja nuk është referuar në Këshill, institucioni në të cilin është komanduar magjistrati informon Këshillin për çdo vendim të ndërmarrë prej tij ndaj magjistratit të komanduar. Ankimi në gjykatë i vendimit për masë disiplinore të institucionit në të cilin është komanduar magjistrati pezullon zbatimin e vendimit.

#### Neni 77 – **Burimet e vlerësimit**

Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime:

a) dosja personale e magjistratit;

b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji;

c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara;

ç) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet e hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit;

d) mendimi i kryetarit;

dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit;

e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese;

ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë

periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;

f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;

g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;

gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit.

## Neni 78 – Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i magjistratit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) “Shkëlqyeshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;

b) “Shumë mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;

c) “Mirë”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;

ç) “Mjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren.

d) “I pamjaftueshëm”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “mirë” për dy kriteret dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore ose të prokurorisë” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” duhet të vlerësohen të paktën “shumë mirë”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste:

a) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;

b) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera.

## Neni 79 – Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një gjykate ose prokurorie kryhet bazuar në këto kritere:

- a) aftësitë drejtuese dhe organizative;
- b) aftësitë e komunikimit.

## Neni 82 – Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarëve

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit bazohet në këto burime:

- a) dosja personale e kryetarit;
- b) vlerësimi i kryer nga kryetari, i cili përmbush, në mënyrë të njëjtë, kriteret e vlerësimit të kryer nga magjistrati;
- c) raportet vjetore të kryetarit, ku pasqyrohen të dhënat e veprimtarisë financiare dhe proces-verbale të mbledhjeve vjetore të analizës së gjykatës ose prokurorisë, si dhe raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit në këto mbledhje, duke përfshirë edhe regjistrimin audio;
- ç) çdo urdhër ose vendim i kryetarit, i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e gjyqtarëve ose prokurorëve ose të administratës gjyqësore ose të prokurorisë;
- d) të dhëna statistikore për funksionimin e gjykatës ose prokurorisë në pesë vitet e fundit;
- dh) raportet e inspektimit të gjykatës ose prokurorisë nga institucionet shtetërore;
- e) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të kryetarit me publikun dhe të tretët;
- ë) mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të prokurorisë ku ushtron funksionin kryetari i gjykatës ose mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin kryetari i prokurorisë;
- f) informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e kryetarit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e gjykatës apo prokurorisë;
- g) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj kryetarit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit;
- gj) vendime përfundimtare për masa disiplinore, për shkak të pozicionit të kryetarit, të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- h) kundërshtimet e kryetarit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit.

## BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Shqipërisë
- Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*.
- Ligji nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 45/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative”*.
- Ligji nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*.
- Ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*.
- Ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar.
- Ligji nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*.
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 28 – Kriteret e pranimit në formimin fillestar”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/28>
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 41 – Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/41>
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 47 – Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/47>
- Sokol Sadushi, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 32 – Verifikimi i pasurisë dhe i figurës”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/32>
- Manjola Xhaxho, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 52 – Emërimi i kryetarëve të tjerë”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/52>



- Aulona Hazbiu, *“Komentari elektronik për Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 77 – Burimet e vlerësimit”*. Marrë nga adresa e internetit: <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/77>
- Aulona Hazbiu, *“Komentari elektronik për Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” – Neni 82 – Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarëve”*. Marrë nga adresa e internetit:  
<http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2016/96/82>
- Vendimi nr. 133 datë 22.11.2021 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 00 – 2021 – 1229 (88), datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2021 – 1435, datë 23.09.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 656, datë 11.04.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 2178, datë 06.10.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 3674 (416), datë 06.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00 – 2022 – 4094 (448), datë 22.12.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Meritokracia në karrierat gjyqësore : ngritja në detyrë në pozicionin  
e kryetarit të Gjykatës dhe në Gjykatat e Apelit të

juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ : manual

trajnimi për shoqërinë civile / Instituti për Studimet Publike

dhe Ligjore. - Tiranë : Muza, 2024. [Vol.] 1... f. ; ... cm

ISBN 9789928361592

1.Gjykata e Apelit 2.Gjykatës

347.9(496.5)